

## PËRMBAJTJA



3 Leximi i njëanshëm dhe me...



9 Intervistë me Esat Stavilecin



13 Ekonomia pa profil



18 Bota rreth zhvillimeve në...



29 Alarmi nga Kopenhaga

**Portreti i muajit:** Lideri i partisë më të votuar..... 2

**Dr. Milazim Krasniqi:** Leximi i njëanshëm dhe me sherr i votës 3-4

**Avni Avdiu:** Fund rrëmujës politike ..... 4-5

**Muhamet Jahiri:** Kosova e nis mbarë në Hagë, Serbia me avazin e vjetër ..... 6-8

Intervistë me akademik Esat Stavilecin ..... 9-11

**Sufjan Abazi:** Sfidat studentore karshi rrethanave aktuale ..... 12

**Lulzim Ahmeti:** Ekonomia pa profil ..... 13

**Astrit Veliqi:** Shkurorëzimet që nga paslufta në Kosovë janë katërfishuar ..... 14

**Agim Fazliu:** Pezull hapësira e Qendrës Islame .. 15

**Mr. Milazim Mustafa:** Minaret, Zvicra dhe muslimanët..... 16-17

**Mr. Qemajl Morina:** Bota rreth zhvillimeve në Zvicër ..... 18-19

**Shenasi Ramadani:** Opsioni i ri gjeostrategjik i Turqisë ..... 19-20

Ripërtëritja e Perandorisë Osmane..... 21-22

**Mr. Ajni Sinani:** Strategjia e Obamës për Afganistanin ..... 22-23

Gruaja e parë me shami në Shtëpinë e Bardhë.. 24-25

**Mr. Muhamed J. Kajolli:** Bashkësitë religjioze . 25-27

**Prof. dr. Naser Ramadani:** Me makinë drejt Zotit . 28-29

**Agim Avdiu:** Alarmi nga Kopenhaga ..... 29-30

**Flamur Maloku:** Arkifigura në figurë personale.. 31

Poezi ..... 31

**Astrit Veliqi:** Muzika shqipe – ‘fole’ e antivlerave kulturore..... 32

Paradokset e kohës sonë ..... 33

**Fatos Shala:** Me plan kundër AIDS-it ..... 34-35

**Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli:** Vaksina – imunizim aktiv artificial ..... 35-36

**Iljasa Salihu:** Sporti dhe i dituri..... 37

**Alban Bilalli:** Nisin “ethet” e botërorit “Afrika e Jugut 2010”..... 38-39

**Alban Bilalli:** Nuk luan pa shami në kohë ..... 39

Fjalëkryqi ..... 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti IV / Nr. 37

19 dhjetor 2009 - 19 janar 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

**Muhamed Jusufi - KAJOLLI**

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

**Avni AVDIU**

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

**Flamur MALOKU**

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

**Osman D. GASHI**

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

**Mimoza SINANI**

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,  
përballë teatrit Dodona,  
Prishtinë, Kosovë**

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

# Lideri i partisë më të votuar



**N**ë bazë të rezultateve preliminare, të shpallura nga KQZ-ja, PDK-ja ka fituar në Gjilan, Kaçanik, Klinë, Dragash, Mitrovicë, Lipjan, Rahovec, Viti, Vushtrri, Malishevë si dhe në Prizren me vetëm 42 vota më shumë, pa numëruar votat me kusht. LDK-ja ka fituar në komunën e Podujevës, Istogut, Novobërdës, Obiliqit, Kamenicës, ndërsa AAK-ja ka dalë fituese e balotazhit në Pejë, Suharekë dhe Junik. Sipas KQZ-zë,

pjesëmarrja në votime ka qenë 37.87 për qind. Përkundër fushatës së fuqishme të partive të tjera rivale si: LDK, LDD, AAK dhe AKR dhe frontit të përbashkët të tyre në koalicionime për balotazhin e 13 dhjetorit, prapëseprapë PDK-ja shënoi fitore, të ngushtë, por të rëndësishme për këtë parti. Fitorja e PDK-së në shumicën e komunave të Kosovës, mund të kuptohet nga kjo parti si sinjal i mirë se populli është i kënaqur me qeverisjen e mirë të kryeministrit Thaçi. ■


**Hashim Thaçi** - Është

lideri politik me numrin më të madh të votave në Republikën e Kosovës. Ka lindur më 24 prill 1968, në Burojë të Skenderajt. Ishte lider i Lëvizjes Studentore në vitet 1990



– 1993. Në vitin 1991, u zgjodh prorektor student i Universitetit të Prishtinës. Z. Hashim Thaçi, më 1993, përfundon me sukses të lartë studimet në Degën e Historisë, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Është ndër themeluesit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1992). Pas themelimit të UÇK-së, më 1993, policia serbe dështon në përpjekjet e saj për ta burgosur. Gjykata serbe e Prishtinës, më 1997, i gjykoj në mungesë me shumë vite burg z. Hashim Thaçin dhe një grup pjesëtarësh të UÇK-së, në krye me Adem Jasharin,

Në Universitetin e Cyrihut në Zvicër (1996), ndoqi studimet postdiplomike në lëmin e Historisë së Evropës Juglindore dhe shkencave politike, deri në fillim të vitit 1998. Gjatë viteve të luftës, ishte drejtues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjatë Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën, të mbajtur në Rambuje të Francës (6 – 22 shkurt 1999), z. Hashim Thaçi ishte kryesues i delegacionit të Kosovës. Konferenca përfundoi në Paris, më 18 mars 1999, ku pas nënshkrimit të palës shqiptare, iu hap rruga intervenimit ushtarak të NATO-s për Kosovën. Që nga marsi i 1999-ës deri në janar të vitit 2000, z. Hashim Thaçi ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (Qeveria e Unitetit).

Në tetor të vitit 1999 e themeloi Partinë e Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK), ndërsa në Kuvendin e Parë Zgjedhor (2000), z. Hashim Thaçi zgjidhet kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, (PDK). Z. Hashim Thaçi u rizgjedh kryetar i PDK-së edhe në Kuvendin e Dytë (2002) dhe të Tretë Zgjedhor (2005). Gjatë procesit negociator (2005 – 2007), të udhëhequr nga i dërguari i Posaçëm i OKB-së, Presidenti Martti Ahtisaari, z. Hashim Thaçi ishte anëtar i Ekipit të Unitetit.

Pas fitores së Partisë Demokratike të Kosovës, në zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2007, z. Hashim Thaçi, më 9 janar 2008, u zgjedh kryeministër i Qeverisë së Kosovës. Më 17 shkurt 2008, kryeministri Thaçi, në Kuvendin e Kosovës, e shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

Flet gjuhën angleze dhe atë gjermane. Jeton në Prishtinë, me gruan Lumnijën dhe djalin, Endritin.

Zgjedhjet lokale 2009



Dr. Milazim KRASNIQI

# Leximi i njëanshëm dhe me sherr i votës

**PKD-ja as në Prizren nuk ishte një gjigant, por partitë kundërshtare të saj, e zbuluan veten si xhuxhe. Disa prej tyre, si LDD, AKR e AAK, kot së koti e zbuluan dobësinë e vet, të cilën në kushte normale, do të duhej të përpiqeshin ta fshihnin. Zbuluan faktin se: ato nuk arrijnë ta mundin PDK-në, as kur bëhen të gjitha së bashku**

Zgjedhjet lokale në Kosovë përfunduan ashtu si edhe nisën, me festime paralele, me kontestime paralele, me një fitues të qartë e me disa humbës në konfuzion të plotë. Festimet paralele në natën e 13 dhjetorit në qytetin e Prizrenit nga aktivistë të PDK-së dhe të LDK-së, vetëm sa e paralajmëruan enigmën e rezultatit në këtë komunë, i cili e mban në fije të perit jo vetëm fituesin dhe humbësin e garës lokale, po edhe fituesin dhe humbësit e gjithë politikës qendrore të partive kryesore të vendit.

Në fakt, në Prizren gara e balotazhit u zhvillua "për jetë a vdekje" ndërmjet një spektri të tërë politik (LDK, AAK, AKR, LDD, ORA etj) dhe PDK-së, e cila faktikisht u ballafaqua e vetme me to dhe, sipas gjasash, edhe doli triumfuese. Koncentrimi aq i madh i partive në një bllok, tregon se nuk është fjala për afërsi orientimesh programore e ideologjike të djathta (sepse së paku Ora nuk e ka atë orientim) po një inat irracional me PDK-në, së cilës deshën që së paku në komunën e Prizrenit t'ia "tregonin vendin".

Testimi i një "koalicioni me bazë të stërgjerë" në garën për Prizrenin, jashtë afërsisë programore e ideologjike, tregon për një kompleks inferioriteti që i ka kapluar këto parti në raport me PDK-në. Në të vërtetë, PDK-ja as në Prizren nuk ishte një gjigant, por partitë kundërshtare të saj, e zbuluan veten si xhuxhe. Disa prej tyre, si

LDD, AKR e AAK, kot së koti e zbuluan dobësinë e vet, të cilën në kushte normale, do të duhej të përpiqeshin ta fshihnin. Zbuluan faktin se: ato nuk arritën ta mundin PDK-në as kur bëhen të gjitha së bashku. Ky fakt do ta rritë konfuzionin brenda tyre, veçmas brenda LDD-së dhe AKR-së.

Në fakt, ballafaqimi i tyre në Prizren praktikisht ishte me një person. Me liderin e PDK-së, Hashim Thaçin. Nga një situatë e palakmueshme në fillim të fushatës parazgjedhore, kur dega e PDK-së në Prizren rrezikonte të përçahet, Hashim Thaçi e çoi PDK-në në Prizren (si edhe në mbarë Kosovën) drejt fitores. Intonimi prej tij i fushatës në balotazh në komunën e Prizrenit, duke integruar minoritetet dhe duke shpërndarë mesazhe pajtuese, do të mbetet episodi më i bukur i kësaj fushate. Prandaj, festimet e kësaj partie edhe në Prizren (ku rezultati ende nuk është qartësuar krejt) ishte i kuptueshëm dhe i arsyetueshëm.

Po LDK-ja pse festoi në Prizren? Duket se me atë inskenim festiv, strat-

egët e fushatës së LDK-së kanë synuar (dhe synojnë ende, deri sa ky tekst po shkruhet) të përgatisin atmosferën për mospranimin e rezultatit. Në të vërtetë, mospranimi eventual i rezultatit në Prizren, do t'i shërbente atyre si alibi për të fshehur diversionin që ia kanë bërë partisë së tyre në disa komuna (Suharekë, Junik, Gjakovë, Vushtrri e Mitrovicë), duke krijuar hapësira për fitore AAK-së. Presionet mbi degën e LDK-së në Suharekë, që të përkrahët kandidati i AAK-së, të cilat çuan në ndarjen e degës në dysh, mbetet të analizohen në të ardhmen. Por, e sigurt është se fitorja e AAK-së në Suharekë ka qenë e planifikuar nga një pjesë e udhëheqjes qendrore të LDK-së. Shtabi zgjedhor i LDK-së e kanë lënë në baltë në konkurrimin në balotazh edhe kandidatin e vet për Junikun, duke i krijuar mundësinë e fitores kandidatit të AAK-së. Prandaj edhe festimet, e edhe kontestimi në Prizren, janë një maskë mbi fytyrën e shëmtuar të trafikimit me elektoratin e LDK-në në favor të AAK-së. Vetë Lutfi Haziri ka deklaruar se në Suharekë LDK-ja e ka mundur LDK-në. E vërteta është se

"LDK-ja e ka mundur LDK-në" edhe në Gjakovë, ku LDK-ja ka pësuar një katastrofë, që në raundin e parë. Por, edhe në Mitrovicë, në Ferizaj dhe në Vushtrri ka ndodhur pothuajse e njëjta gjë.

Mbetet të shihet a ka qenë kjo një taktikë për eliminimin e disa figurave brenda LDK-së, para se të mbahet Kuvendi zgjedhor i saj. Nuk mund të thuhet



tash për tash se a do të përdoret edhe rasti i Prizrenit, që ngatërresa t'i faturohet Eqrem Kryeziut, për ta dobësuar edhe atë para Kuvendit zgjedhor të partisë, që pritet të mbahet në vitin 2010. Por, nëse është brenda skenarit, edhe kjo do të merret vesh shpejt. Alternimi i festimeve, me kontestimin e rezultatit (edhe rezultatit të shpallur nga KQZ-ja!) mund të plotësohet edhe me kërkimin e përgjegjësive së kryetarit të Degës, i cili personalisht e ka përzgjedhur kandidatin e LDK-së. Nëse do të mbetet aktive hipokrizia e disa prej liderëve të LDK-së, e manifestuar gjatë fushatës parazgjedhore në drejtim të partnerit të koalicionit, PDK-së, atëherë shumë lehtë mund të ndodhin skenarë të tillë edhe brenda vetë LDK-së. Nëse ndiqet kjo politikë, rezulton se do të punohet që të dobësohen kundërshtarët e koalicionit me AAK-në dhe kundërshtarët e bashkimit me LDD-në.

Sa u përket AKR-së dhe LDD-së, ato janë humbëset më të mëdha të këtyre zgjedhjeve. Edhe pse kanë investuar shumë para në reklamë dhe shumë zhurmë në propagandë negative kundër PDK-së, ato nuk kanë arritur të fitojnë as dhe një komunë të vetme. Ndodhi që një kandidat i pavarur, Refki Suma, e fitoi një komunë, ndërsa nuk ndodhi që ta fitonin një komunë të vetme, dy parti të bashkuara, të cilat në zgjedhjet e kaluara parlamentare, kanë qenë të radhitura në vendet 3 dhe 4. Është detyrë e udhëheqësive të këtyre dy partive që të bëjnë analizat dhe të lexojnë drejt rezultatet. Nëse vazhdojnë të fajësojnë të tjerët për humbjet e veta, ato vetëm sa do ta thellojnë krizën e vet në raport me elektoratin. Megjithatë, një gjë është e sigurt: ato nuk do të kërkojnë më zgjedhje të parakohshme, sikundër e patën bërë zakon të përsërisnin disa zyrtarë të tyre. Nëse do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare në vitin 2010, ka rrezik që AKR dhe LDD (nëse garojnë të ndara), të mos e arrijnë as pragun zgjedhor.

Pas shpalljes së rezultateve në raundin e parë më 15 nëntor, pati festime paralele në kryeqytet: LDK-ja festonte fitoren e Prishtinës, ndërsa, PDK-ja fitoren në nivel të vendit. Edhe pas balotazhit pati festime paralele, por kësaj here në kryeqytetin historik të Kosovës. Mirëpo, mesazhi është i njëjtë: një lexim i njëanshëm dhe me sherr i votës. ■

14 dhjetor 2009

# Fund rrëmujës



**Avni AVDIU**

**F**undi i nëntorit.

Datë 23.

Në afërsi të Bujanocit, disa kilometra larg kufirit me Kosovën, u hap baza më e madhe dhe më moderne ushtarake serbe.

Gjashtë ditë më vonë.

shantazhe dhe vazhdon të ecë i lirë. Brenda kuvendit producentët-deputetë shumojnë CD me rrëfime monstruoze dhe në mënyrë spektakulare ua prezantojnë medieve.

Mediat. Disa...e gjetën rastin. Filluan t'u bëjnë propagandë CD-ve famoze.

Rasti kalon në prokurori, në EULEX. Dalin zëra se Bllaca, para se të dalë para kuvendit, ka qenë në Serbi. Atje ka marrë instruksione.

Ç'mund ta kenë mësuar po të jetë ashtu? E qartë. Dil bëhu dëshmitar dhe avokati ynë para se të fillojë procesi i

## Qendra ushtarake në Bujanoc



Rast i pashembullt.

Del në pikë të ditës para kuvendit njëfarë Nazim Bllaca dhe pohon se afër pesë vitesh është marrë me vrasje, rrahje, rrëmbime e

Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, ku shtrohen argumentet pro e kundër pavarësisë. Bllaca doli dhe, për çudi, nuk ishte i vetëm në këtë drejtim.



**Nazim Bllaca**

# politike

shënuar ditën e rinisë, 19 vjetorin e shembjes së diktaturës në Shqipëri. Ka kohë që kur PS dhe PD zihen mes vete në for-



Para selisë së BE-së, protestojnë maqedonasit e revoltuar

7 dhjetor.

Këshilli i Ministrave të BE-s vendosi pezullimin e caktimit të datës për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë në BE. I ashpër ka qenë reagimi maqedonas prej qytetarëve të thjeshtë e deri te presidenti i shtetit Ivanov. Ivanov e ka ashpërsuar tonin e kritikave drejt BE-së. "Shohim mungesë të vizionit. Marrim paralajmërimet për në 2012, 2014, apo për në vitin 2015. Si mendojmë t'i arrijmë ato afate? Me obstrukcione dhe pengesa?" - ka pyetur Ivanov në një takim me ekspertët. Këta të fundit madje e kanë komentuar veprimin e Ivanovit si në hutit. Në hutit edhe më të madhe janë shqiptarët. Nga t'ia mbajnë shqiptarët?! Me liberalizimin e vizave ata mund të ikin diku jashtë, por, prapë, duhet të kthehen të jetojnë në kafazin e quajtur Maqedoni, jashtë Evropës, pa afat.

8 dhjetor.

Sali Berisha i përgjigjet protestave të Edi Ramës me një tubim masiv në sheshin 'Skënderbe' të Tiranës, duke



Sali Berisha

mat më të vrazhda verbale. Madje sharjet kanë eskaluar aq rëndë sa që cenohet



Komitoni Qendror i Zgjedhjeve

etika elementare dhe morali familjar. PS akuzon Berishën për vjedhjen e votave në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kërkon rihapjen e kutive të votimit, kurse



Edi Rama

PD akuzon Ramën për një mori aferash korruptive, duke ngritur së fundmi edhe procedurën hetimore për keqpërdorimet e shumta, si dhe ka kërkuarën shkarkimin e kryebashkiakut të Tiranës. Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë thirrje opozitës në Shqipëri që të hyjë në parlament dhe të kërkojë zgjidhje demokratike për problemet që mbahen pezull.

13 dhjetor.

Balotazhi i zgjedhjeve lokale në Kosovë. Pjesëmarrje e dobët në votimet e balotazhit. S'ka fjalë; popullata ishte terrorizuar e traumatizuar psikikisht për qëllime të caktuara. Mirëpo prapëseprapë e pjekur politikisht; nuk u ndikua nga hororet e inskenuara në vend, në kohë dhe situatë të gabuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rezultatet preliminare, në pjesën dërrmuese të komunave shpalli fituese PDK. Interesante ishte se, si në zgjedhjet e 15 nëntorit, ashtu edhe në ato të 13 dhjetorit (të balotazhit), shtabet zgjedhore të partive shpallnin fitore veç e veç në qytetet e njëjta.

Dita-ditës ky vit po mbaron. Fundi i këtij viti ishte rrëmujë e vërtetë në skenën e politikës shqiptare. Dëshira e qytetarëve shqiptarë është që problemet e shumta të mbesin veçse kujtime të vitit që po lëmë pas, që fundi i vitit të shënojë edhe fundin e rrëmujës politike. Megjithatë, fatkeqësisht, kjo varet në masë të madhe prej politikanëve.

Do të kishte qenë fat i madh që gjithë atë energji negative që është harxhuar për dëmtimin e tjetrit, ta shndërrojmë në energji pozitive për të menduar për të mirën tonë të përbashkët, për një të ardhme sa më të ndritur. ■

Republika e Kosovës dhe Serbia kanë paraqitur qëndrimet e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare të

# Kosova e nis mbarë në Hagë



**Muhamet JAHIRI**

**N**ë paraqitjen e tij të parë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), për mbrojtjen e ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës, ministri i jashtëm i Republikës së Kosovës, Skënder Hyseni, ka deklaruar se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe kështu do të mbetet, pavarësisht se a do ta pranojë këtë realitet shteti serb. Ndërkaq, ka shtuar se, kthimi prapa do të shkaktonte destabilitetet për tërë rajonin.

Këto komente ministri Hyseni i ka bërë në seancën e parë dëgjimore rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së



Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) në Hagë, në të cilën pala kosovare dhe ajo serbe i kanë paraqitur argumentet e tyre për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës.

“Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe kështu do të mbetet, jo vetëm për hir të Kosovës, por edhe për hir të paqes dhe sigurisë së qëndrueshme rajonale, për të cilën pavarësia e Kosovës ka kontribuar aq shumë. Është e paimagjinueshme që ne ta pranojmë thirrjen e Serbisë për ta kthyer orën mbrapa - për të zhvilluar negociatat të mëtejshme, rreth asaj se a do ta pranojë apo jo Serbia Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo do të ishte tepër destabilizuese, madje mund të prodhojë konflikt të ri në rajon”, - ka thënë Hyseni.

Ministri Hyseni ka deklaruar se Republika e Kosovës tashmë është duke e përjetuar paqen mirëpo, sipas tij, populli

i vendit tonë asnjëherë nuk do ta harrojë atë çka i ka ndodhur nga pushtuesi serb, si dhe nuk do ta lejojë më kurrë që të përsëritet një gjë e tillë.



**Wood: Rezoluta 1244 nuk e ndalon deklarimin e pavarësisë**

Përfaqësuesi ligjor i Kosovës, Michael Wood, që në fillim të fjalës së tij para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë ka thënë se nuk ka dyshim se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, përderisa ka hedhur poshtë gjithë rrëfimet e paradites nga përfaqësuesit e Serbisë. Ai ka thënë se populli i Kosovës ka pasur të drejtë në parimin e vetëvendosjes, andaj edhe e ka bërë këtë, përderisa ka mohuar të ketë pasur ndonjë pikë në Rezolutën 1244, që ka ndaluar shpalljen e njëanshme të pavarësisë.

“Asgjë në Rezolutën 1244 nuk ka parandaluar lëshimin e deklaratës së pavarësisë në vitin 2008. Disa shtete janë fokusuar në parimin e vetëvendosjes. Ne i referohemi atij vetëm si alternativë, por vetëm si shtesë dhe mendojmë se nuk duhet të hyjë gjykata në ato. Populli i Kosovës ka pasur të drejtë në parimin e vetëvendosjes dhe e ka bërë këtë”, - ka thënë Wood.

Wood ka thënë se as katastrofa humanitare e viteve '98-'99, e as miratimi i Rezolutës 1244 nuk kanë ardhur nga qielli i hapur.

## Serbët paraqiten në Hagë me avazin e vjetër

Në seancën e parë dëgjimore rreth

ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës, delegacionin e Serbisë e ka udhëhequr ambasadori i këtij vendi në Francë, Dushan Batakoviç. Në argumentimin e tij, Batakoviç ka thënë se organizatat ndërkombëtare, të cilat veçohen për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë, po bëjnë deklaratë unilaterale duke përkrahur shpalljen e pavarësisë së Kosovës, shpallje, e cila, sipas tij, është një sfidë shumë e madhe. Pavarësia e Kosovës sfidon rendin ndërkombëtar dhe parimin e integritetit territorial”, - ka deklaruar ai.

Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të ketë rëndësi fundamentale jo vetëm për zhvillimet në Kosovë, por edhe për rendin ndërkombëtar, - ka vënë në pah Batakoviç.

## Paraqitja e shteteve pro dhe kundër!

Pas paraqitjes së argumenteve të përfaqësuesve të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, kanë vazhduar për disa ditë më radhë paraqitjet e shteteve pro dhe kundër pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

## Shpallja e pavarësisë së Kosovës, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare



## Shqipëria: Kosova shtet në pajtim me të drejtën ndërkombëtare

Shqipëria ishte vendi i parë që u paraqit në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Ambasadori i saj në Holandë, Gazmend Barbullushi, ka folur për suprimimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës në vitin 1989.

ë Drejtësisë (GJND)

# ë, Serbia me avazin e vjetër

“Shqipëria e ka pranuar pavarësinë e Kosovës dhe konsideron se ajo është në tërësi në pajtim me të drejtën ndërkombëtare”, - ka thënë ambasadori i Shqipërisë në Holandë, Gazmend Barbullushi në fillim të ditës së dytë të debatit.

Ambasadori shqiptar, po ashtu, ka thënë se “Kosovës i është marrë autonomia dhe e drejta për vetëvendosje”. Represioni ndaj shqiptarëve të Kosovës ka arritur kulminacionin në vitin 1999, “me fushatën më të madhe të spastrimit etnik pas Luftës së Dytë Botërore”, në të cilën mijëra civilë janë vrarë, kurse 1,5 milion njerëz janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, - ka thënë Barbullushi.

Pas Shqipërisë ka dëshmuar Gjermania, e cila ka mbajtur një qëndrim të fuqishëm në favor të Kosovës. Në emër të shtetit me ndikim të madh në Evropë është paraqitur Suzan Vasum Rainer, e cila ka folur për shkeljen dhe diskriminimin masiv në Kosovë nga ana e autoriteteve serbe.

Në këtë kontekst, ajo ka vlerësuar se “shpallja e pavarësisë ka qenë në harmoni me ligjin dhe të drejtën ndërkombëtare”.

“Gjermania konsideron se pavarësia e Kosovës i ka kontribuar stabilitetit në Ballkan. Shpallja e pavarësisë nuk është bërë nga institucionet e përkohshme, por nga institucionet e zgjedhura në rrugë demokratike, që kanë artikuluar vullnetin e popullit”, - ka thënë Vasum Rainer.

Sipas saj, “Kosova është një rast i veçantë” dhe sa për shpalljen e pavarësisë, ajo ka thënë se “e drejta ndërkombëtare nuk është kompetente të vlerësojë, sepse këtë çështje nuk e ka të sanksionuar”.

Mbështetje pavarësisë së Kosovës i ka ofruar edhe Arabia Saudite, me ç’rast ambasadori i së cilës në Hagë, Abdullah Al Shagrud, ka ftuar GJND-në që ta ketë parasysh faktin se pavarësia e Kosovës i ka kontribuar stabilitetit të vendit dhe të rajonit.

Ndërkaq, përfaqësuesja e Argjentinës, Suzana Ruiz Çeruti, e ka cilësuar deklaratën e pavarësisë së Kosovës në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, duke thënë se

“dokumenti i Rambujesë nuk parasheh të drejtën e pavarësisë të Kosovës”.

## Austria



Edhe Austria e ka mbrojtur fuqishëm pavarësinë e Kosovës, duke e cilësuar atë si akt konform të drejtës ndërkombëtare.

“E drejta ndërkombëtare nuk përmban dispozita që ndalojnë shpalljen e pavarësisë dhe as të secesionit. Deklaratën e kanë miratuar përfaqësuesit e zgjedhur, të cilët e kanë shprehur vullnetin e popullit të Kosovës, kurse e drejta ndërkombëtare nuk e ndalon këtë”, - ka thënë përfaqësuesi ligjor i Austrisë, ambasadori Helmut Tihi.

Tihi ka confirmuar se nga kjo, pavarësia e Kosovës nuk është në kundërshtim as me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ndërsa Bjellorusia dhe Azerbajxhani mendojnë ndryshe. Ato thanë se pavarësia e Kosovës është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

## Bullgaria: Kosova, episodi i fundit i shpërbërjes së Jugosllavisë



Bullgaria para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë ka pohuar se Kosova nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare me deklaratën e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës.

Përfaqësuesi ligjor i Bullgarisë, Dimitrov, ka thënë se e drejta ndërkombëtare nuk e ndalon deklaratën e pavarësisë

dhe as secesionin.

“Deklarata për pavarësinë e Kosovës nuk e ka shkelur asnjë dispozitë të drejtës ndërkombëtare”, - ka vlerësuar Zlatko Dimitrov, i cili një pjesë të madhe të fjalës ia ka kushtuar rrjedhës së krizës së Kosovës.

Për Burundin është paraqitur në seancë përfaqësuesi i këtij vendi, Zhan Dasperrmon, i cili ka thënë se “kualifikimi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës si akt jo i ligjshëm nuk do të kishte asnjë efekt praktik, sepse Kosova do të vazhdonte të ekzistonte si gjendje faktike”.

“Deklarata e pavarësisë është akt i brendshëm dhe jo ndërkombëtar, sepse e drejta ndërkombëtare nuk e ka të rregulluar çështjen e secesionit”, - ka thënë përfaqësuesi i Burundit në fjalimin e tij të balancuar.

Ai ka pohuar se “GJND-ja duhet ta përcaktojë se nuk mund të ketë të drejtë të themelimit të shteteve të reja jashtë procesit të dekolonizimit, ndonëse kjo e dhënë, sipas tij, nuk ndikon në ekzistencën ose jo të Kosovës si shtet”.

Ndërkaq në GJND kundër pavarësisë së Kosovës ishin deklaruar Brazili dhe Bolivia

## Kroacia: Kosova ishte pjesë e barabartë e RSFJ-së



Edhe përfaqësuesja ligjore e Kroacisë, Andreja Metelko-Zgombiq, ka thënë në Pallatin e Paqes në Hagë se deklarata e njëanshme e pavarësisë së Kosovës “nuk e ka cenuar asnjë dispozitë a parim të drejtës ndërkombëtare, e të mos flasim se është e ndaluar”.

Baza ligjore për ligjshmërinë e deklaratës, sipas Kroacisë, rrjedh nga mosuksesi i bisedimeve për statusin e Kosovës dhe jo qëndrueshmërisë së statusit të mëhershëm të Kosovës si krahinë

në kuadër të Serbisë, pasi që autoritetet në Beograd në mënyrën më të vrazhdë kanë shkelur të drejtat e njeriut ndaj shqiptarëve.

Ajo ka thënë se “shpallja e pavarësisë nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244, sepse ajo nuk prejjudikonte epilogun e procesit politik”, në të cilin është kërkuar statusi i ardhshëm i Kosovës. “Një nga rezultatet e mundshme ka qenë edhe pavarësia”, - ka përmendur ajo.

Pas Kroacisë ka folur përfaqësuesi i Danimarkës, Tomas Uinkler, i cili fillimisht ka thënë se “nuk ka dispozitë në të drejtën ndërkombëtare që ndalon shpalljen e pavarësisë”.

Ai ka pohuar se “Rezoluta 1244 nuk është neutrale dhe nuk përjashton pavarësinë si epilog i mundshëm i procesit politik për Kosovën dhe, rrjedhimisht, shpallja e pavarësisë së Kosovës është në harmoni me të”.

Pas Kroacisë dhe Danimarkës, Kina dhe Qiproja kishin dhënë deklaratat e tyre kundër pavarësisë së Kosovës.

### SHBA: Mos e ngucni pavarësinë e Kosovës



Në paraqitjen e saj në seancën dëgjimore mbi ligjshmërinë e Deklaratës mbi Pavarësinë e Kosovës, SHBA-ja ka deklaruar se kjo deklaratë nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

“SHBA-ja fton GJND-në që Deklaratën mbi Pavarësinë e Kosovës ta lërë të qetë, si shprehje e vullnetit të popullit të Kosovës, qoftë duke refuzuar që të deklarohet për ligjshmërinë e saj, qoftë duke konfirmuar se e drejta ndërkombëtare nuk e ndalon deklaratën mbi pavarësinë”, - ka thënë përfaqësuesi i SHBA-së, Harold Hongju Koh, në Pallatin e Paqes në Hagë.

“E drejta ndërkombëtare nuk rregullon çështjet e deklaratave të pavarësisë, ndërsa pavarësia e Kosovës është kaptina e fundit në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë” - ka thënë Harold Koh, duke shtuar më tutje se - “nuk ka inkonsistencë ndërmjet shpalljes paqë-

sore të pavarësisë së Kosovës, të së drejtës ndërkombëtare dhe Rezolutës 1244”.


Pavarësisht Serbisë, e cila “dëshiron të kthehet prapa”, deklarata e pavarësisë së Kosovës e ka përforcuar stabilitetin e rajonit dhe “i ka hapur dyert për ardhmërinë evropiane për të gjitha shtetet” - ka vlerësuar Harold Koh.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka cenuar as parimin e integritetit territorial, sepse ky parim rregullon vetëm raportet ndërshtetërore, ka thënë Koh, për t’iu referuar pastaj Rambujesë dhe “vullnetit të popullit” dhe për të shtuar se dokumentet e këtij tubimi nuk prejjudikojnë dhe as përjashtojnë asnjë epilog të statusit politik të Kosovës.

Në vazhdim të seancës dëgjimore para GJND-së është paraqitur përfaqësuesi i Rusisë, Kiril Gevorgian, i cili ka thënë shpallja e pavarësisë së Kosovës është jolegale, sepse u bë nën një administrim ndërkombëtar.

Mendim për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës ka dhënë edhe Finlanda.

### Franca: Rasti i Kosovës, ‘sui generis’



Përfaqësuesja e Francës, Hedvig Belliar, ka deklaruar se pavarësia e Kosovës nuk ka cenuar as parimin e integritetit territorial, sepse ai ka të bëjë me raportet ndërshtetërore, por jo me vende të caktuara, për të shtuar se rasti i Kosovës është ‘sui generis’, siç është çdo shpallje e pavarësisë.

Në emër të Francës ka folur edhe përfaqësuesi tjetër, Matias Fortju, që ka thënë se rasti i Kosovës nuk ka asgjë të përbashkët me rastet siç janë: Rodezia, Qipro ose Kongo. Fortju, në vazhdim, ka pohuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës, në asnjë formë, nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Edhe përfaqësuesi i Norvegjisë, Rolf Fife, ka mbështetur pa asnjë hezitim pavarësinë e Kosovës. Ai fillimisht ka përsëritur tezën që në Hagë është dëgjuar shumë shpesh, se shpallja e pavarësisë së Kosovës

nuk është çështje që sanksionohet me të drejtën ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, nuk mund të jetë në kundërshtim me të.

“E drejta ndërkombëtare publike nuk e rregullon deklaratën e njëanshme të pavarësisë, e cila është fakt politik...Kjo do të thotë as pranim, as refuzim, as cenim, as inkurajim i secesionit” - ka thënë përfaqësuesi i Norvegjisë Rolf Fife.

### Britania e Madhe: Kosova kurrë nuk do të jetë pjesë e Serbisë



Britania e Madhe, me paraqitjen e saj para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, ka mbrojtur ligjshmërinë e deklaratës së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, duke pohuar se atë nuk e ndalon as e drejta ndërkombëtare, e as Rezoluta 1244 e KS të OKB-së.

“Serbia ka bërë me dije se kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, kurse Kosova se kurrë më nuk dëshiron që të jetë pjesë e Serbisë. Gjykatat nuk ua imponojnë çifteve që të jetojnë bashkë” - ka thënë Bethlehem.

Sipas tij, pavarësia e Kosovës ka stabilizuar rajonin, pas decenies traumatike që kishte filluar me tanke përreth Kuvendit të Kosovës në vitin 1989, kur është rrënuar autonomia e Kosovës dhe që kishte përfunduar me fushatën e dëbimit të shqiptarëve në vitin 1999.

Në anën tjetër përfaqësuesja e Holandës, Lizbet Lajzand, ka thënë se vendi i saj konsideron se shpallja e pavarësisë së Kosovës është në harmoni me të drejtën ndërkombëtare.

Ndërkaq, përfaqësuesi i Rumanisë, Bogdan Areshku, që ka mbrojtur pozicionin e Serbisë, ka pohuar se nuk pajtohet me qëndrimet e atyre që thonë se GJND-ja nuk duhet të deklarohet rreth çështjes së Kosovës.

Me deklaratat e Venezuelas dhe Vietnamit, të cilat kanë deklaruar në favor të qëndrimeve të Serbisë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, kanë përfunduar seancat dëgjimore rreth ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës. GJND-ja pritet që mendimin këshillëdhënës ta japë në pranverën e ardhshme. ■

Intervistë me akademik Esat Stavilecin

# Pavarësia e Kosovës fakt juridik që nuk mund të zhbëhet

Intervistoi: Muhamet JAHIRI

**E**sat Stavileci, një nga personalitetet më të shquar të Kosovës, flet për përballjen e Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ai tregon se si është paraqitur shteti më i ri atje dhe e vlerëson me notë të lartë delegacionin nga Kosova, edhe pse, sipas tij, ka qenë e mundur të flitet edhe më shumë për padrejtësitë historike që i janë bërë popullit shqiptar të Kosovës. Sipas tij, pavarësisht nga kjo, shteti ynë ishte më i përgatitur se ai serb, mirëpo më të përgatitur ishin edhe ata që mbrojtën pavarësinë e Kosovës, sesa ata që dëshmuuan kundër.

Ai tregon për përballjen e dy superfuqive botërore SHBA-ve dhe Rusisë për Kosovën, njëra për ligjshmëri e tjetra kundër. Sipas tij, Shtetet e Bashkuara ishin shumë të përgatitura dhe bënë një mbrojtje të fuqishme të pavarësisë së Kosovës, ndërsa ai rus, sipas tij, më shumë u përqendrua në fjalët, të cilat tashmë ishin dëgjuar nga të tjerët. Ai thotë se pas mbarimit të procesit të GJND-së, Kosovën e presin shumë njohje të reja. Shtetet ndërkombëtare sipas tij do ta shohin me një sy tjetër atë serb, pas vendimit këshillëdhënës të GJND-së, sepse Serbia edhe më tutje nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Përveç kësaj, ai tregon se do të ketë presion edhe mbi pesë shtetet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e shtetit tonë, që ta bëjnë një gjë të tillë. Ai tregon dhe se cili do të mund të jetë vendimi përfundimtar i GJND-së.

Për më shumë flet në një intervistë për revistën "Paqja", profesori me renome botërore, njohësi i çështjeve ndërkombëtare, akademik Esat Stavileci.

**PAQJA: Z. Stavileci, Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë, përfunduan përballjen për ligjshmërinë e shpalljes**



**së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Si e komentoni paraqitjen e Kosovës?**

**STAVILECI:** Gjykuar sipas argumenteve dhe fakteve që prezantoi me gojë, paraqitja ishte e pëlqyeshme. Paraqitja me gojë ishte vetëm njëra anë e dëshmiave. Kosova ka bërë dhe deklaratën me shkrim dhe është përgjigjur në komentet e vendeve të tjera që kanë bërë dëshmitë për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Nuk kam pasur qasje as në deklaratën me shkrim dhe as në përgjigjet e Kosovës në komentet e vendeve të tjera, por duke u bazuar në mënyrën e argumentimit me gojë, përshtypja është e mirë dhe dëshmia e suksesshme, sepse në paraqitjen e ekspertëve ndërkombëtarë, që përfaqësuan Kosovën para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pati një përzgjedhje argumentesh dhe faktesh që provuan se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe përtej kësaj, se pavarësia e Kosovës nuk paraqet akt të secesionit, por shprehje të vullnetit të lirë të popullit të deklaruar prej përfaqësuesve legjitim të tij, në një proces politik të koordinuar me faktorin ndërkombëtar

dhe se nuk paraqet precedent për lëvizjet separatiste në botë, për shkak të karakterit të veçantë të çështjes së Kosovës.

**PAQJA: Atëherë, z. Stavileci, cili është vlerësimi juaj për ekipin e Kosovës. A mendoni se paraqitja e tij ishte në nivelin e duhur?**

**STAVILECI:** Vlerësimi im është pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm me notë të mirë kaluese që është bërë për ekipin e Kosovës edhe për faktin se ai e ka dominuar ekipin serb, i cili nuk tha pothuajse asgjë më shumë nga ajo që prisnim, se në prezantimin e tij pati më shumë retorikë politike, ndërkohë që angazhohej për drejtësi. Ndoshta ekipi i Kosovës ka qenë dashur që ta shfrytëzojë më shumë hapësirën për t'i bërë akoma më të pranishme faktet historike, me padrejtësitë që i janë bërë popullit shqiptar me copëtimin e trungut etnik të tij, me pasojë aneksimin serb të Kosovës, me gjenocidin e ushtruar ndaj popullatës së saj, me rrënimin antikushitetues të autonomisë e tjera që, megjithatë, u theksuan në deklaratat e vendeve të tjera që dëshmuuan në anën e Kosovës, nga ku mund të gjykohej se kishte një koordinim të paraqitjeve të ekspertëve që përfaqësonin Kosovën dhe të ekspertëve të vendeve të tjera që paraqiteshin në favor të saj.

**PAQJA: Z. Stavileci, në GJND janë paraqitur shtetet që janë deklaruar pro pavarësisë së Kosovës dhe ato të cilat kanë paraqitur "argumentet" e tyre kundër. Sipas jush, cilat shtete kanë paraqitur argumente më të fuqishme?**

**STAVILECI:** Dominimi i Kosovës nuk qe vetëm në numrin e shteteve që dëshmuuan për të, por edhe në argumentimin më të fuqishme që paraqitën vendet që u deklaruan pro shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Shtetet që mbështeten Serbinë nuk arritën me asnjë fakt të dëshmojnë se shpallja e pavarësisë ishte në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar. Në mungesë të fakteve me të cilat do të



mund të mbronin tezën e tyre se shpallja e pavarësisë së Kosovës bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, ekspertët që dëshmuuan në favor të Serbisë silleshin rreth Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999) dhe një mbrojtjeje të kontestueshme të një parimi që përbënte preambula e saj në lidhje me integritetin territorial të një shteti që atëbotë ishte zhbërë, pa e vrarë mendjen se ishte vetë Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe dy rezolutat e tij, nr.757- 19991 dhe nr. 777-1992, me të cilat ai vetë kishte deklaruar vdekjen ndërkombëtare të Jugosllavisë dhe se ish-Jugosllavia ishte shpërbërë në ish-përbërësit e saj, ku secili prej tyre kishte të drejtën që të vetëdeklarohet për të ardhmen e tij. Këtë të drejtë e kishte edhe Kosova, si njëri nga tetë konstituentët e ish-Jugosllavisë, mbi bazën e të drejtës për vetëvendosje të popullit shumicë të saj, e drejtë kjo që i takonte qoftë si e drejtë kombëtare, qoftë si e drejtë e një territori të individualizuar, pavarësisht se rezultatet e një referendumi të mbajtur në Kosovë për shtet të pavarur dhe sovran atëbotë ndërkombëtarisht nuk u pranuan.

**PAQJA: Brenda një dite në GJND janë përballur dy shtetet më të fuqishme dhe më me ndikim në botë: SHBA-ja dhe Rusia. Si e komentoni këtë përballje?**

**STAVILECI:** Nëse gjykohet sipas argumenteve që përdorën para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, SHBA për ta mbrojtur shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ndërsa Rusia për ta kontestuar atë, SHBA me paraqitjen e saj para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ishte cilësisht më e fuqishme sesa Rusia, e cila madje, nuk përdori kohën që kishte në dispozicion për ta shprehur mendimin e vet. Edhe në paraqitjen e Ruisë vërehej qartë një shterpësi argumentimi në anën e Serbisë, sepse kishte më shumë përsëritje 'argumentesh' që ishin dëgjuar tashmë, se kishte më shumë verbalizëm sesa meditim dhe se kishte më shumë oportunitizëm me politikën serbe sesa shqyrtim kritik të rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe të shkeljes eventuale të tyre nga ana e Kosovës për të "dëshmuar paligjshmërinë" e shpalljes së pavarësisë.

**PAQJA: Z. Stavileci, a mund të tregoni se sa është i rëndësishëm mendimi i GJND-së për Republikën e Kosovës?**

**STAVILECI:** Nëse keni parasysh mendimin e parë, atëherë sado që ai do të kishte karakterin këshillues, do të mund të ishte shumë i rëndësishëm për Kosovën, sepse shumë shpejt do të mënjanohej embargoni e njohjeve të Kosovës

nga vendet e ndryshme të botës, të vendosur me hapjen e iniciativës serbe dhe miratimin e Rezolutës në Asambleenë e Kombeve të Bashkuara për ta proceduar atë para GJND.

Nëse e keni fjalën për mendimin e kundërt, duhet të keni parasysh se bëhet fjalë vetëm për një mendim këshillues që nuk i detyron shtetet anëtare të OKB-së që ta njohin ose jo pavarësinë e Kosovës. Po të shprehej GJND eventualisht në favor të Serbisë, njohjet nuk do të ndaleshin, por do të ngadalësohej ritmi i tyre dhe rumbullakimi i shtetbërjes së Kosovës.

**PAQJA: Nëse GJND nuk do të shprehë mendimin e vet, por do ta lë të padefinuar çështjen e Kosovës, cilat do të mund të ishin pasojat për Kosovën?**

**STAVILECI:** Natyrisht se pasojat do të ishin më lehtë të përballueshme sesa GJND të deklarohet në favor të Serbisë. Gjithë flasin se kështu edhe do të ndodhë dhe nëse do të ndodhë që GJND "të heshtë", një numër i madh i shteteve që kanë hezituar ta njohin pavarësinë e Kosovës, do ta bënin këtë me pretekstin se nuk ka një mendim të GJND që shpreh paligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës të 17 shkurtit 2008 dhe kjo do t'u shërbente si një "mbulesë e mjaftueshme" për t'u deklaruar në anën e Kosovës.

**PAQJA: Shtruarja e rastit të pavarësisë së Kosovës në GJND, ka ndikuar shumë në mosnjohjet e pavarësisë së Kosovës. Sa do të ndikojë "fjala e Gjykatës" në njohjet e reja?**

**STAVILECI:** Duhet pritur "fjala e Gjykatës" shtrohet pyetja, për atë që do të deklaronte eventualisht ligjshmërinë ose për atë që do të shprehte eventualisht paligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Në të dyja rastet bëhet fjalë për mendim këshillues të GJND dhe jo për një vendim detyrues të saj që do t'i obligonte vendet anëtare të OKB-së që të njohnin ose të mos e njohnin pavarësinë e Kosovës. Mendoj se njohje të reja do të ketë, pavarësisht nga mendimi i GJND. Natyrisht se nëse "fjala e Gjykatës", si po e quani ju, do të "legjitimonte shpalljen e pavarësisë", do të kishte një ndikim në rritjen e numrit të njohjeve dhe do të kishte njohje më të përshpejtuara sesa në gjysmëvitin e dytë të 2009-it.

**PAQJA: Z. Stavileci, në cilat shtete do të mund të ketë ndikim më të madh mendimi i GJND-ja për ta njohur Republikën e Kosovës?**

**STAVILECI:** Së pari, do të ketë ndikim tek ato shtete që të thuash, janë vetëm në pritje të një mendimi të GJND. Së dyti, do të ketë ndikim tek ato shtete që kanë hezituar ta njohin pavarësinë e Kosovës. Së treti, do të ketë ndikim edhe tek ato shtete në të cilat Serbia ka bërë trysni të madhe që të mos e njohin pavarësinë e Kosovës, deri te një mendim i GJND.

**PAQJA: Një problem tjetër është edhe mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian. A duhet që, pas vendimit të GJND-së, Republika e Kosovës të shtojë presionin te këto shtete për ta bërë një gjë të tillë?**

**STAVILECI:** Natyrisht se po. Unë mendoj se këtë presion nuk do ta bëjë vetëm Kosova, por edhe ato vende që nga fillimi e kanë mbështetur fuqishëm pavarësinë e Kosovës dhe se rezultatet nuk do të mungojnë, edhe pse nuk mendoj se njohja nga ato vende do të mund të ndodhte menjëherë. Mos harroni se Serbia, me gjithë mendimin e GJND, do të vazhdojë me trysnitë e veta, pikërisht tek ato shtete, sepse ato do t'i ngelin "atutë e fundit". Në një fjalë të urtë thuhet: "Mbaju edhe për fije të kashtës nëse ajo të mban".

**PAQJA: Z. Stavileci, në GJND Serbia është paraqitur me disa shtete të tjera kundër pavarësisë. Si i komentoni paraqitjet e tyre dhe faktet e tyre?**

**STAVILECI:** Si Serbia, po edhe shtetet që "mbrojtën" pikëpamjet për "paligjshmërinë" e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, silleshin rreth disa 'argumenteve' lehtësisht të rrëzueshme.

**E para,** se shpallja e pavarësisë është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, pa dhënë asnjë shembull se me cilën normë konkretisht Kosova nuk e paskësh pasur këtë të drejtë.

**E dyta,** se shpallja e pavarësisë është në kundërshtim me Rezolutën 1244, e cila paskësh deklaruar ruajtjen e integritetit territorial të Jugosllavisë, ndërkohë që Jugosllavia ishte shpërbërë dhe se Serbia nuk mund të ishte trashëgimtare legjitime e saj.

**E treta,** se shpalljen e pavarësisë e paskan deklaruar institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, pa e vrarë mendjen se atë e kanë bërë përfaqësuesit legjitimë të popullit, madje se edhe nëse do të kualifikoheshin si institucione të përkohshme të vetëqeverisjes, nuk e kishin shkelur ligjin ndërkombëtar, duke u deklaruar në fund të një procesi politik që sugjeronte edhe vetë Rezoluta 1244.

**E katërta,** se Kosova paskësh deklaruar pavarësinë pa marrë "pëlqimin e Serbisë", edhe pse ky kusht nuk ishte përmendur në asnjë dokument, madje pa e vrarë mendjen se po të kërkohej pëlqimi i Serbisë, sot nuk do të ishin të pavarura as Kroacia dhe as Sllovenia, as Mal i Zi dhe as Maqedonia, e lëre më Kosova.

**E pesta,** se Kosova paskësh qenë "pjesë e pandashme" e shtetit serb dhe se shqiptarët paskan qenë pakicë kombëtare pa të drejtën për vetëvendosje, pa gjykuar drejt se Kosova ishte, në të vërtetë, njësi federale e ish- Jugosllavisë, me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, bashkë me republikat, në marrëdhëniet në Federatë, se shqiptarët nuk ishin pakicë kombëtare, as në raport me Shqipërinë dhe as me Serbinë, por ishin popull, me territor dhe qeverisje, madje popull me numër më të madh sesa disa popuj sllavë që realizuan shtetësinë e vet dhe, si i tillë, populli shumicë i Kosovës gëzonte të drejtën për vetëvendosje që iu kontestua gjatë historisë, në emër të një "të drejte të deklaruar serbe" të sovranitetit mbi Kosovën të cilën, në të vërtetë, Serbia e mbajti për gati një shekull, në mënyrë

ilegjitime, duke e pushtuar Kosovën, nga 1912-ta, 1918-ta, 1945-ta dhe 1989-ta.

**PAQJA: A mendoni se shteti serb do ta ndërrojë qasjen politike ndaj Kosovës pas "fjalës përfundimtare" të GJND-së?**

**STAVILECI:** Është vështirë të mendosh se shteti serb do të ndryshojë qasjen politike ndaj Kosovës, qoftë edhe pas një "fjalë përfundimtare" nëse edhe eventualisht do të ishte në favor të Kosovës, e lëre më nëse nuk do të kishte fare një mendim të GJND.

Edhe pse i quajtur "demokrat", regjimi serb dhe Beogradi zyrtar nuk kanë dëshmuar me asnjë veprim, por kanë paralajmëruar të kundërtën: se kurrë nuk do ta njohin pavarësinë e Kosovës, duke e konsideruar atë edhe më tutje si "djep të shtetit serb". Ajo që do të mund të pritej do të mund të ishte ndryshimi i qasjes së politikës ndërkombëtare karshi Serbisë në lidhje me Kosovën, edhe pse nuk duhet të jemi shumë optimist se kjo do të mund të ndodhte menjëherë.

**PAQJA: Z. Stavileci, si mendoni se do të jetë vlerësimi përfundimtar i GJND-së?**

**STAVILECI:** Janë të mundshme katër vlerësime dhe unë njërin prej tyre e përjashtoj menjëherë.

Nuk mund të ndodhë që GJND të deklarojë "paligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës".

Mund të ndodhë që GJND, në një përshkrim të gjatë, të ndalet te procesi politik që ka çuar deri te shpallja e pavarësisë, duke "u pozicionuar" në nuanca për procesin ose vetëm duke e përshkruar thjesht atë.

Përfundimisht, mund të ndodhë që GJND "të deklarojë" inkompetencën e vet në lidhje me përgjigjen ndaj pyetjes së shtruar, duke heshtur.

Duke anuar më shumë nga "pozicioni neutral" i GJND karshi pyetjes dhe karshi vetë çështjes së shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kam parasysh faktin se GJND për herë të parë në historinë e saj është ballafaquar me një pyetje të një natyre të tillë që, sado qoftë e formuluar për të marrë një mendim juridik, është e kryqëzuar me politikën dhe është produkt i saj dhe se asaj "mund t'i pëlqejë" më shumë qoftë një përshkrim i procesit, qoftë dhe një heshtje e deklarimit. ■



# Sfidat studentore karshi rrethanave aktuale

**Sufjan ABAZI**

**D**uke pasur parasysh rolin dhe qasjen e tyre konstruktive në të kaluarën historike, studentët përfaqësojnë grupin më të rëndësishëm të shoqërisë në Kosovë. Prej tyre kanë buruar kërkesat më madhore kombëtare për vetëvendosje të shqiptarëve. Ata janë bartësit e proceseve dhe ngjarjeve të para me karakter demokratik. Studentët ishin ata që u ngritën në demonstratat e vitit 1968, 1981 dhe 1997 kundër regjimit serb, që diskriminonte shqiptarët në të gjitha poret e jetës. Shumë studentë u radhitën edhe në UÇK duke u bërë gjeneratorë të lirisë me gjithë potencialin dhe elanin e tyre fizik e mendor. Angazhimi i tyre zgjoi vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare për të kuptuar më mirë thelbin e problemit të Kosovës. Pas pavarësimit të Kosovës, studentët konsiderohen bartës të proceseve për ndryshime pozitive e integruese në jetën shoqërore në Kosovë. Të përfshirë në shumë drejtime, ata do të mund të jenë një bazë e shëndoshë e ndryshimeve nga të gjitha anët. Andaj për këtë shkak lypset që zhvillimit të lëndëve të formimit të përgjithshëm t'i kushtohet një kujdes i veçantë. Vetëm duke shfrytëzuar literaturën adekuate shkencore dhe zbatimin e dijes teorike në praktikën profesionale, mund të shpresohet për një cilësi të studimeve universitare. Te ne, puna praktika sikur

është anashkaluar paksa dhe kjo mund t'i ketë pasojat e veta. Mu për këtë, asaj duhet t'i kushtohet një vëmendje më e veçantë, sepse përmes saj mund të aplikohen në praktikë njohuritë, shkathësitë dhe aftësitë profesionale të fituara gjatë kohës së studimeve. Megjithatë është arritur diçka, prapëseprapë akoma ka mbetur pa u bërë gjithë ajo që është e nevojshme për të intensifikuar raportin, lidhjen dhe bashkëpunimin jo vetëm studentë e profesorë, por edhe prindër, me qëllim që baza e marrëdhënieve shkencore të shoqërohet edhe me shtyën motivuese. Reformimi i sistemit arsimor nënkupton një marrëdhënie më aktive akademike. Kjo do të bëhet në interes të formimit të studentëve me shpirt inventiv, kreativ dhe me logjikë konstruktive të përgjegjësive, në drejtim të eliminimit të mangësive dhe përgatitjes së rrugës që shpie drejt ndryshimit. Një aspekt tjetër që ka rëndësi të veçantë është edhe fakti se për të pasur efikasitet më të lartë në procesin arsimor duhet të bëhen investime për mundësimin e zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, duke inkurajuar punën në grupe, ligjëratat interaktive, kualifikimin e stafit akademik, pjesëmarrjen në diskutime gjatë ligjëratave dhe prezantimin e shpjegimit përmes metodës vizuale. Pra, nevojitet reformimi i sistemit arsimor në përputhje me përvojat e avancuara perëndimore. Në këtë sens, institucionet e arsimit, e në veçanti universiteti, duhet të gjenerojë vlera të

njëmendta akademike, vlera këto me të cilat do të mburrej shoqëria kosovare. Perspektiva e studentëve përballet akoma me tranzicionin që, në këtë rrafsh, ka impakt më tepër në sistemin vleror, në kulturë dhe identitet. Duke pasur parasysh këtë, studentët duhet të kenë qasje më të madhe në media. Ata duhet t'i shfrytëzojnë mediat për zënë hapësirën mediatike, për t'i sensibilizuar problemet e tyre tek opinioni i gjerë. Studentët duhet t'i artikulojnë të drejtat e tyre përmes mediave elektronike dhe të shkruara, në përpjekje për t'i përmirësuar kushtet e tyre të studimit. Vetëm duke qenë më të zëshëm, studentët mund ta ndërjegjësojnë opinionin, profesorët, stafin drejtues të universitetit, por, para së gjithash, edhe veten për rolin e tyre të rëndësishëm në shoqëri. Duke qenë vetëm mekanikë në ndjekjen e ligjëratave, mësimi përmendsh dhe përshtatjes së një rendi që nuk u konvenon në zhvillimin normal akademik, ata do të vetëmargjinalizohen si faktor në ecjen drejt formësimit adekuat në një shoqëri të hapur, plurale e multidimensionale.

Studentët duhet të kujtojnë rolin e mëparshëm historik që kanë luajtur para-rendësit e tyre, gjeneratat e para. Duke u kthyer në retrospektivë, ata duhet të kujtojnë se brezi i kaluar e luajti rolin e vet të pazëvendësueshëm në gjenerimin e progresit shoqëror, në veçanti në lirinë e atdheut. Tashmë kur kjo është arritur, roli i studentëve duhet të dimensionohet në çështje të tjera, me theks të veçantë të ndërtimit të shtetit. Pra, krahas formësimit të tyre, ata duhet të kontribuojnë edhe në ndërtimin e shtetit. Hapi i parë në këtë drejtim do të ishte që ata të përipien qysh tani t'i vënë në jetë dijet e tyre. Ata duhet të iniciojnë debate, tribuna dhe diskutime të ndryshme publike në opinion ose përmes mediave, për të bërë qoftë programe ose shkrime me tematikë nga kultura, politika, ekonomia, etj. Pastaj, pikërisht këto, më pas, do të shërbenin për të prodhuar ide e iniciativa për përmirësimin e kushteve në të gjitha drejtimet. ■

15 nëntor 2009





Lulzim AHMETI

# Ekonomia pa profil

Sektorë të rëndësishëm potencialë për investime konsiderohen: sektori i agrobiznesit, sektori i përpunimit të drurit, ai i xehetarisë dhe metalurgjisë, por ka edhe sektorë të tjerë

**R**ritja e ngadaltë ekonomike, mos hapja e vendeve të reja të punës, si dhe përbërja e ekonomisë kryesisht nga tregtia, janë disa nga shembujt që dëshmojnë se ekonomisë kosovare nuk mund t'i jepet një profil i caktuar.

Zyrtarë të qeverisë kanë thënë se ekonomia e Kosovës po e merr veten dhe, falë fuqisë punëtore dhe disa sektorëve atraktivë për investime, ajo mund të jetë konkurrenente me ekonomitë e vendeve të tjera.

Edhe pse nuk kemi rritje ekonomike, që është planifikuar rreth 4 për qind ose më shumë, ajo mund të jetë "konkurrenente", me ekonomitë e vendeve të rajonit.

## Fuqia punëtore

Përveç fuqisë punëtore që posedon Republika e Kosovës, e cila është një ndër faktorët kyç për rritjen ekonomike të një vendit në tranzicion, janë edhe disa sektorë që konsiderohen si të volitshëm për investime, si dhe që mund të gjenerojnë vende të reja të punës.

Sektorë të rëndësishëm potencialë për investime konsiderohen: sektori i agrobiznesit, sektori i përpunimit të drurit, ai i xehetarisë dhe metalurgjisë, por ka edhe sektorë të tjerë.

Përparësia e Kosovës, në raport me vendet e rajonit, është se Kosova posedon fuqi të re punëtore, e cila mundëson zhvillimin e industrisë së lehtë.

Pjesa më e madhe e ekonomisë së Kosovës përbëhet nga aktivitetet tregtare. Tregtia në ekonominë e vendit zë një vend të rëndësishëm, rreth 15-17 për qind i takon industrisë, kurse rreth 25 për qind i takon sektorit të bujqësisë.

Sektori i bujqësisë, nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, është cilësuar si "motor" shtytës edhe për zhvillimin ekonomik, si dhe për hapjen e vendeve të reja të punës.

## Konkurrenca

Por se sa është ekonomia e Kosovës konkurrenente me ekonomitë e tjera, siç



janë ekonomitë e vendeve të rajonit dhe më gjerë, për këtë duhet bërë një shikim i shifrave të eksportit. Nënkuptohej se institucionet e Republikës së Kosovës kanë ende shumë punë për të bërë.

Sipas të dhënave, Kosova ka aktualisht një nivel të ulët të eksportit dhe kjo tregon një nivel të ulët konkurrimi

të ekonomisë sonë, në krahasim me ekonomitë e vendeve të tjera.

Por ka ekspertë që mendojnë se ekonomia e Kosovës është më shumë individuale, sepse kryesisht ka biznese të vogla familjare, në të cilat kryesisht punësojnë njerëz të familjeve të tyre.

## Struktura ekonomike

Prandaj, në bazë të zhvillimit ekonomik dhe në bazë të strukturës ekonomike duhet të bëhet edhe planifikimi i kuadrove. Te

ne, për fat të keq, nuk ekziston strategjia e zhvillimit ekonomik, e as strategjia e planifikimit të kuadrove.

Prandaj duhet të bëhet një orientim dhe studim nga Ministria e Arsimit për tregun e punës, sepse përndryshe këtë profil të "keq" të ekonomisë së Kosovës nuk do të mund ta nderojmë edhe për një kohë. ■

## FOTOLAJM



Një dritë e jashtëzakonshme në formë spiralore ka lënë gojëhapur më tetë dhjetor banorët e një zone në Norvegji. Askush, madje as qeveria, apo specialistët, nuk i ka dhënë shpjegim fenomenit misterioz, i cili ka zgjatur disa minuta dhe ka ndriçuar gjithë qiellin.

Shkurorëzimet në Kosovë në rritje të vazhdueshme

# Shkurorëzimet që nga paslufta në Kosovë janë katërfishuar



**Astrit VELIPI**

**N**umri i shkurorëzimeve në Kosovë, gjithnjë e më shumë, po shkon drejt rritjes. Duke pasur parasysh statistikën që janë bërë viteve të fundit dhe vitin që po lëmë pas, shohim se ky fenomen po rritet me përmasa të jashtëzakonshme.

Shumë çifte te ne, sot, nuk mund të jetojnë së bashku. Arsyet janë të shumta dhe lidhen ngushtë me faktorët socialë, psikologjikë, etikë, familjarë etj.

## Evropa më la pa burrë

Siç dihet sot gjendja ekonomike-sociale në Kosovë paraqitet e brishtë, por edhe disharmonia e çifteve nga kjo gjendje është në krizë të vazhdueshme.

M. Bajrami, 29 vjeçare nga Prishtina ka 5 muaj që është ndarë nga i shoqi. Ajo ndihet shumë keq ngase jeta e saj bashkëshortore e cila zgjati vetëm 3 vjet ka marrë fund.

“Burri im u nda nga unë ngase u martua me një vajzë në perëndim për rregullimin e letrave” - shprehet e zhgënjyer M. Bajrami e cila ka mbeti e vetme me dy fëmijët e saj.

Fatin e saj e kanë shumë femra e burra në Kosovë. Statistikat tregojnë se në nivel Kosove, shkurorëzimet kanë shënuar rritje të vazhdueshme gjithnjë e më shumë.

## ESK-ja: 1026 shkurorëzime për vitin 2008

Enti i Statistikave të Popullsisë në Kosovë ka bërë regjistrimin e numrit të divorceve që nga viti 1985 deri më 2008 në Kosovë. Në vitin 2004 në Kosovë janë bërë 1293 shkurorëzime, më 2005 numri i tyre ka qenë 1445, më 2006 ka qenë 1480, ndërsa gjatë vitit 2007 janë regjistruar rreth 17 mijë kurorëzime dhe mbi 1500 mijë shkurorëzime. Në vitin

2008 janë regjistruar gjithsej 1026 shkurorëzime në nivel Kosove, e për vitin 2009 ky ent ende nuk posedon shifra zyrtare.

Kadri Sojeva, drejtor i Departamentit të Entit të Statistikave të Popullsisë në Kosovë, thekson se “numri i shkurorëzimeve për vitin 2008 është më i vogël krahasuar me shifrën e shkurorëzimeve të vitit 2007, ngase në vitin 2008 Gjykata e Qarkut në Veri të Mitrovicës nuk ka punuar dhe në mungesë të kësaj ne nuk kemi statistika nga pjesa veriore e Kosovës”

Ndërkohë, sipas raportit që ka nxjerrë Enti i Statistikave të Kosovës “statistikat e kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve në Kosovë 2007”, janë regjistruar mbi 16824 kurorëzime dhe 1558 shkurorëzime. Numri i shkurorëzimeve, krahasuar me periudhën e paraluftës, është katërfishuar” - thekson ndër të tjera Sojeva, duke shtuar se nëse tërheqim një paralele në shifra mes vitit 1985, ku në 1000 kurorëzime janë divorcuar 26.6 çifte, dallimi në rritje është i madh. Tani për shembull, në 1000 kurorëzime, sa ka pasur në vitin 2006, prej tyre janë shënuar 94 çifte të divorcuara, çka do të thotë se në krahasim me vitin 1985, në vitin 2006 numri i divorceve është rritur 4 herë e gjysmë”, - përfundon Kadri Sojeva drejtor në Departamentin e Entit të Statistikave.

## Komuna e Prishtinës: 1 janar - 8 dhjetor 2009, janë 65 shkurorëzime

Po ashtu, edhe në komunën e Prishtinës, ku popullsia pas lufte është rritur dukshëm, statistikën e shkurorëzimeve tregojnë se ka pasur rritje të vazhdueshme. Shefqet Buqaj, shef i sektorit

të gjendjes civile në Komunën e Prishtinës, thotë se që nga viti 2003 është bërë evidentimi i shifrave në vite të divorceve në komunën e Prishtinës. Ai thotë se në vitin 2003 në komunën e Prishtinës kanë qenë 32 shkurorëzime, më 2004 kanë qenë 38 raste, më 2005 kanë qenë 75 raste, më 2006 kanë qenë 117 raste, më 2007 gjithsej kanë qenë 127 raste, ndërsa më 2008 në komunën e Prishtinës ka pasur 1494 kurorëzime, prej të cilave janë shënuar 112 raste të shkurorëzimeve.

Sipas Buqajt, prej 1 janarit deri më 8 dhjetor të vitit 2009, në komunën e Prishtinës janë regjistruar gjithsej 65 shkurorëzime, kurse deri më 4 dhjetor të vitit 2009 në Prishtinë janë regjistruar 1505 kurorëzime.

## Sociologët: Ekonomia e brishtë godet harmoninë e të rinjve

Ndërkohë, këtë rritje të numrit të divorceve ndër vite, sociologët e komentojnë në forma të ndryshme.

Shaip Hasani, sociolog, thotë se ekzistojnë shumë faktorë që lidhen drejtpërdrejt me disharmoninë mes të çifteve, ku nga kjo mosbaraspeshë sociale, familja e humbet shumë lehtë kuptimin e ekzistimit të saj.

“Shkaqet e rritjes së shkurorëzimeve janë të shumta dhe lidhen direkt me problemet sociale. Ekonomia po bie gjithnjë e më shumë dhe kjo rënie reflektohet tek prishja e ekuilibrit që sjell çrregullime mes jetesës së të rinjve”, - thekson sociologu Hasani.

Sipas tij, pikërisht divorcet rrezikojnë qenien e familjes së shëndoshë, ku sipas traditës ekzistenca e saj ka qenë gjithnjë e shenjtë.

Të gjitha këto statistika flasin qartë se dukuria e divorceve është duke u rritur vazhdimisht dhe si e tillë në një të ardhme të afërt kjo rritje do ta rrezikojë edhe ekzistimin e familjes së shëndoshë te ne. Siç dihet, në shoqërinë tonë, familja është respektuar tradicionalisht dhe është konsideruar gjithnjë si institucion i shenjtë dhe i paprekshëm. ■



Statusi i pazgjidhur i ish-Tjegullores lë në pikëpyetje caktimin e lokacionit të objektit të madh islam

# Pezull hapësira e Qendrës Islame

Lokacioni "ideal" i Qendrës Islame në Prishtinë është vënë në pikëpyetje për shkak të moszgjidhjes së statusit të ish-Tjegullores. Është vlerësuar se kjo hapësirë i plotëson kushtet e kërkuara nga Bashkësia Islame e Kosovës



Agim FAZLIU

**P**rishtinë, dhjetor – Shtyrja e zgjidhjes së statusit të ish-Tjegullores në Prishtinë e ka vënë në pikëpyetje caktimin e lokacionit të Qendrës Islame. Zyrtarët e Komunës së Prishtinës kanë vlerësuar se kjo hapësirë është më e përshtatshme për plotësimin e shumicës së kushteve të kërkuara nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK).

Udhëheqësi i Drejtorisë së Pronës në Komunën e Prishtinës, Ujup Krasniqi, tha se janë zënë pisk për shkak se nuk kanë planifikuar një vend tjetër për Qendrën Islame. "Ne negociojmë me zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të sqaruar çështjet e debatueshme. Derisa të zgjidhet statusi i kësaj ndërmarrje, nuk pritet të caktohet ndonjë vend tjetër". Krasniqi, tha se kanë menduar që hapësirën e ish-Tjegullores ta dedikojnë për nevojat e Qendrës Islame, ndërsa si kompensim të caktojnë një hapësirë tjetër, pronë e Komunës së Prishtinës. Statusi i ish-Tjegullores së Prishtinës është ende duke u negociuar. Kjo ndërmarrje shtetërore ka mbetur e pazgjidhur, ndërkohë që objektet u janë dhënë me qira ndërmarrjeve të ndryshme private.

Ndërkohë, besimtarët muslimanë

luten që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt. Zyrtarët e Bashkësisë Islame të Kosovës vazhdimisht kanë thënë se ndërtimi i një Qendre Islame është shumë i nevojshëm, për shkak të mungesës së hapësirës për kryerjen e riteve fetare. Kjo kërkesë është ripërsëritur shumë herë në vitet pas luftës së vitit 1999, por deri tash nuk është caktuar ndonjë lokacion.

Sipas kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Prishtinë, Bahri Sejdiu, zyrtarët duhet të shfaqin më shumë transparencë ndaj kërkesave të tyre për dhënie e lejeve për ndërtimin e Qendrës Islame dhe xhamive në kryeqytet. "Qendra Islame do të zbuste nevojat e besimtarëve për t'u falur. Kudo, nëpër lagjet qendrore të Prishtinës, besimtarët kanë kërkuar që të ndërtohen xhami, sepse ka nevoja për më shumë hapësirë për t'i kryer obligimet fetare. Deri tash, zyrtarët nuk kanë treguar përkushtimin e duhur", - ka thënë Bahri Sejdiu.

Sipas zëdhënësit të Komunës së Prishtinës, Muhamet Gashi, gjatë përpilimit të planeve rregulluese u kushtohet rëndësi objekteve publike, siç janë shkollat, kopshtet për fëmijë e objektet fetare. "Gjatë caktimit të prioriteteve për objektet e tilla, merren edhe rekomandimet e qytetarëve", - tha zëdhënësi Gashi.

Por, kërkesat e besimtarëve muslimanë shpeshherë kanë rënë në vesh të shurdhër nga ana e zyrtarëve. Zakonisht ata "dëgjojnë", pas presioneve të shumta të qytetarëve.

Gjatë planit rregullues të lagjes "Dardania" në Prishtinë, është duke u diskutuar për caktimin e një objekti fetar për besimtarët muslimanë. Kjo është arritur pasi dhjetëra qytetarë të kësaj lagjeje kanë nënshkruar një peticion duke kërkuar ndërtimin e një xhamie në këtë lagje qendrore të kryeqytetit.

Këshilltari i Partisë së Drejtësisë, gjatë mandatit të kaluar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Amir Ahmeti ka përfaqësuar zërin e këtyre qytetarëve. Në debatin për planin rregullues të mbajtur në fund të muajit prill, ai pati diskutuar për këtë çështje, duke i bindur zyrtarët komunalë, ndër ta edhe kryetarin e Prishtinës, Isa Mustafën, që të caktohet një lokacion për një objekt fetar islam. "Kemi arritur që të marrim pëlqimin e 65 për qind të banorëve të 'Dardanisë' për të ndërtuar një xhami këtu. Për fat të mirë kjo kërkesë është miratuar dhe shpresojmë që të realizohet. Besojmë se zyrtarët do të jenë transparentë edhe në rastet e kërkesave të tjera të ngjashme", - u shpreh Amir Ahmeti.

Vlerësohet se ndërtimi i një qendre të madhe islame do të plotësonte sado pak nevojat e shumta të besimtarëve muslimanë për kryerjen e obligimeve fetare. Pas luftës në Prishtinë, e sidomos në lagjet periferike, janë ndërtuar xhami të reja, por kërkesat për më shumë objekte fetare kanë qenë të vazhdueshme. Në shumë raste, besimtarëve u është dashur t'i shtrojnë palltot në rrugë për shkak se nuk ka pasur vend as në oborret e xhamive. ■



# Minaret, Zvicra dhe muslim



Mr. Milazim MUSTAFA

**Z**vicra njihet si shtet neutral që aplikon demokracinë e drejt-përdrejtë, që d.m.th nje referendumin si formë të zakonshme për marrjen e vendimeve demokratike. Është një konfederatë kushtetuese, preambula e së cilës fillon me "Në emër të Zotit të Plotfuqishëm", por me marrëdhënie të ndara jo qartë mes të kishës dhe shtetit, duke e lënë këtë si çështje të hapur kantonale.

Më 29 nëntor të këtij viti, Zvicra doli në referendum në nivel federal. Në këtë referendum ishin të parapara tri pyetje, për të cilat duhej të vendosnin qytetarët e këtij vendi. Dy prej këtyre kaluan, kurse njëra ra. Prej atyre që kaluan ishte edhe pjesa më e diskutueshme e këtij referendumi, ajo e ndalesës për ndërtim të minareve në xhamitë e muslimanëve. Ky referendum ishte i iniciuar nga një grup i vogël qytetarësh dhe i përkrahur vetëm nga një parti djathtiste, Partia Popullore e Zvicrës (SVP), parti kjo që ishte bartësja kryesore e kampanjës për kalimin e referendumit, me qëllimin e ndaljes së "islamizimit" të Zvicrës. Sipas rezultateve zyrtare, 57,5% votuan pro propozimit për ndalimin e minareve, ndërsa në nivel kantonale, vetëm katër prej njëzet e gjashtë kantoneve votuan kundër këtij propozimi (respektivisht 3

½, duke e ditur se kantoni Bâle-Ville, posedon vetëm gjysmë vote).

Sipas deklaratave të zyrtarëve që ishin përkrahës të referendumit, qëllimi i inicimit të këtij referendumi nuk ishte vetëm ndalimi i ndërtimit të minareve, por edhe 'vënia e një vije të kuqe për të drejtën e shariatit dhe islamit politik që në njëfarë mënyre ka filluar të jetohej' (lideri i grupit iniciues Walter Wobmann prej partisë SVP, në këtë shtet evropian).

Qeveria e Zvicrës, shumica e partive politike, bile edhe kishat si dhe bashkësia e biznesit në Zvicër, ishin kundër daljes në referendum. Rasti tjetër plotësues ishte se të gjitha anketat paraprake flitnin për një dështim të këtij referendumi, duke u bazuar në faktin se i cenon të drejtat dhe liritë elementare të njeriut, konkretisht, të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit. Me këtë hap, shumica e analistëve deklarojnë se ky referendum do të kontribuojë në rritjen e ekstremizmit në Zvicër, por edhe dëmtimin e imazhit të Zvicrës në botë, sidomos në vendet muslimane, por në masë të madhe edhe dëmtimin e ekonomisë së Zvicrës, fakt ky që vërtetohet me disa iniciativa të filluara për bojkotim të produkteve zvicerane, si tërheqjen e parave nga bankat e Zvicrës, e kështu me radhë.

Edhe pse në Zvicër deri më tani nuk ka pasur probleme ndërjetare, sipas shumicës së analistëve shkak kryesor i kalamit të këtij referendumi janë imamët radikalë, çështja e femrës muslimane, kryesisht të drejtat e femrës dhe veshja e saj (ferexheja). Po ashtu edhe kam-

panja shumë e nxehtë që u zhvillua nga bartësit e këtij referendumi, duke i paraqitur minaret si raketa të zeza që mbijnë mbi flamurin e Zvicrës, por edhe një femër të mbuluar me ferexhe të zeza, që vërtet ishte një provokim i rëndë, hap ky që u dënua si akt racist nga organizatat joqeveritare dhe bashkësia ndërkombëtare.

## Muslimanët në Zvicër

Në Zvicër, momentalisht, jetojnë diku mbi 400.000 muslimanë. Kryesisht vijnë nga vendet e Ballkanit (pjesa më e madhe e tyre shqiptarë, më së shumti nga Kosova, Maqedonia dhe Lugina e Preshevës, por edhe turq e boshnjakë). Në Zvicër ekzistojnë mbi 200 faltore muslimane, ku vetëm katër prej tyre janë xhami me minare. Kryesisht këto faltore të muslimanëve janë larg vendeve urbane, konkretisht, në zonat industriale, nëpër fabrika të lëshuara, nëpër bodrume të ndryshme, e kështu me radhë.

Sa i përket integritit të muslimanëve në shoqërinë zvicerane, kemi një shkallë të ulët integriti (nëse flasim për integritim me vlera islame). Edhe përkundër imamëve të shumtë dhe goxha të përgatitur në aspektin fetar, një numër shumë i vogël prej tyre e njeh mirë gjuhën e vendit dhe është i aftë t'i prezantojë, respektivisht t'i mbrojë tezat dhe qëndrimet islame në publik (si pasojë e mosnjohjes së gjuhës). Përveç kësaj, shkak tjetër i rëndësishëm është edhe mungesa e një institucioni të fuqishëm që do t'i përfaqësonte interesat e muslimanëve në nivel shtetëror. Zakonisht, bashkësitë muslimane janë të ndara në aspekt nacional, kështu që kemi bashkësi islame të shqiptarëve, turqve, boshnjakëve, arabëve, pastaj, bashkësitë shqiptare ndahen në ato të Kosovës, shqiptarëve të Maqedonisë e të luginës së Preshevës. Akoma më katastrofale është se këto ndarje vazhdojnë edhe në nënndarje të tjera në nivel lokal, si për shembull, xhamia e prishtinasve, tetovarëve, kumanovasve, mëhallës së epërme e mëhallës së poshtme. Krejt këto ndarje të dëmshme bëhen për interesa të cekëta. Pas krejt kësaj, shumica e hoxhallarëve që shërbejnë në Zvicër, gjatë kampanjës së referendumit, janë



Protestat e zviceranëve kundër Islamit

# slimanët

marrë me organizimin e haxhit, respektivisht me çështjet materiale të këtij obligimi fetar.

Përveç këtyre faktorëve hasim edhe frikën që ekziston në këtë vend, se në rast të ngritjes së zërit për reagim, ose kërkim të ndonjë të drejte të caktuar, mund të pasojë dëbimi nga Zvicra, pasi pjesa e madhe, diku mbi 80% e popullatës muslimane nuk kanë shtetësi, por vetëm status të rezidentit në Konfederatën e Zvicrës.

Më parë, muslimanët në Zvicër organizoheshin nëpër klube, tash më tepër organizohen nëpër xhamitë lokale, duke mos ekzistuar ndonjë organizatë serioze joqeveritare, që do ta ngrinte zërin e muslimanëve nëpërmjet sektorit civil. Ky duhet të jetë një mësim për bashkëfetarët tanë në Zvicër, sepse në një vend demokratik, siç është Zvicra, zëri i sektorit civil, ka goxha peshë të madhe. Andaj, duhet një angazhim më i madh dhe pjesëmarrje më aktive në sektorin civil, duke u bërë pjesë përbërëse e këtij sektori me peshë. Gjithashtu, duhet edhe një lidhje e të drejtpërdrejtë dhe përkrahje aktive e partive politike, të cilat kanë qëndrim më liberal në lidhje me fenë, por edhe me çështjen e imigracionit, me ç'rast mundësia e përkrahjes nga subjektet e tilla, në rastet që kanë të bëjnë me interesat tona të përgjithshme fetare dhe kombëtare, do të jetë më e madhe.

## Dëm i madh për imazhin dhe të ardhmen e Evropës

Si rezultat i mosgjetjes së formës përfundimtare të organizimit juridiko-politik të Evropës (BE-së), kohëve të fundit nëpër shumë vende evropiane, po lansohen projekte dhe ide të ndryshme. Jehonë të madhe po marrin projektet që bartin me vete kryesisht provokime fetare. Të gjitha këto e pengojnë më së shumti Evropën dhe BE-në si një projekt që si parim themelor parasheh integritetin, të drejtat e njeriut, ushtrimin e lirë së fesë, profesionit e kështu me radhë.


Shembulli i Zvicrës nuk është problemi i izoluar i këtij vendi, por i gjithë Evropës dhe botës perëndimore. Me kalimin e referendumit në Zvicër, i njëjti ka gjasa të kërkohet nga forcat që janë kundër imigrimit edhe në vendet të tjera,

si p.sh. në Holandë, Danimarkë e gjetiu. Në Francë menjëherë filluan të bëhen anketime në lidhje me çështjet e ngjashme, ku vërehet disponim i ngjashëm sikurse ai i popullit zviceran, hapa këto që e çojnë Evropën drejt shkeljes së parimeve dhe akteve të saj bazë, si p.sh. Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e shumë e shumë akte të tjera bazë, të cilat garantojnë të drejtat themelore të njeriut, e me këto edhe të drejtën e ushtrimit të lirë të fesë.

Shpresojmë që këto probleme ndërkomunitare dhe ndërkonfesionale në Evropë të evitohen me akte juridike supranacionale. Krerët e shteteve evropiane e dinë më mirë se ne disponimin e popujve të Evropës, andaj, veprimet e tilla ku cenohen të drejtat e komunitetit mysliman në Evropë fshehin pas vete racizëm, ksenofobi, por edhe urrejtje ndërfitare.

## A ka fat në fatkeqësinë pas përfundimit të këtij referendumit?

Për dallim nga rasti i karikaturave të Muhamedit a.s. në Danimarkë, ku reagimet ishin të ndara duke u arsytuar se "liria e të shprehurit nuk kufizohet", pastaj, ndalesa e shamisë në Francë, kinse si ndalesë për të gjitha simbolet fetare, sepse Franca mbron karakterin sekularist, në rastin e Zvicrës, të gjitha reagimet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe organeve kompetente të BE-së ishin të qëndrimit se ky referendum nuk duhej të lejohej ngase njëra nga pyetjet bazë të tij ku duhej të deklarohet popullata e Zvicrës, është në kundërshtim me aktet bazë në të cilat është e ndërtuar e drejta pozitive



evropiane, ku nënshkruese është edhe Zvicra. Gëzon fakti se në këtë rast, të gjithë e drejtuan gishtin nga Strasburgu, respektivisht Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Fakt tjetër që na gëzon në këtë fatkeqësi dhe këtë turp të ri të Evropës, është edhe reagimi i moderuar dhe i përmbytur i muslimanëve, në Zvicër dhe në vendet e tjera të Evropës. Muslimanët, në këtë rast, dëshmuar nivelin dhe pjekurinë e tyre demokratike dhe civilizuese, duke shprehur revoltën e tyre në mënyrë paqësore dhe me forma demokratike. Po ashtu edhe porositë e faktorëve relevantë në botën islame thërrisnin për përmbajtje, ruajtje të gjakftohtësisë dhe veprim me mjete juridike.

Shpresojmë që rezultatet e këtij referendumit të bien sa më shpejt ose nga Gjykata Kushtetuese e Zvicrës, ose nga Gjyqi i Strasburgut, por më së shumti kishim dashur që të bien nga zemrat e banorëve të Zvicrës dhe pjesës më të madhe të Evropës, të cilët fatkeqësisht akoma nuk janë shëruar nga sëmundja e nazizmit dhe ksenofobisë. ■

# Bota rreth zhvillimeve n



**Mr. Qemajl MORINA**

**V**ota, pa dyshim, që do ta ndryshojë imazhin e Zvicrës jashtë vendit. Vendi alpin, që është prezantuar deri më sot si neutral dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut nuk do të krenohet më me këtë cilësi, tashmë të njollosur. Zvicra është vendi i Kryqit të Kuq dhe i Konventës së të Drejtave të Njeriut të Gjenevës, por tanimë modeli i supozuar i demokracisë ka dhunuar të drejtat e njeriut dhe larinë e fesë dhe ka mbështetur diskriminimin ndaj një grupi të caktuar, vetëm mbi bazën e fesë. Vota do të ketë pasoja serioze. Fakti se qytetarët zviceranë janë shndërruar në diskriminues të një feje të caktuar, në një mënyrë që dhunon të drejtat e njeriut, është një dëm shumë i madh ndaj reputacionit të vendit. Sipas statistikave, në Zvicër ekzistojnë 160 xhami, por numri i xhamive me minare janë vetëm katër: e Zyrihut, Gjenevës, Winterthur dhe Wangen bei Olten. Ky fakt tregon se marrja e lejes për minare edhe deri më tash ka qenë e vështirësuar. Këto minare nuk do të preken nga ndryshimi i ligjit. Me gjithë ligjin e ri, minaret ka shanse që të vazhdojnë të ndërtohen në Zvicër. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, sipas të gjitha gjasave do të marrë çështjen për shqyrtim dhe ka të ngjarë që të verë re një shkelle të të drejtave të njeriut në vendimin e Zvicrës. Por sido që të shkojë puna e minareve, dëmi tashmë është bërë. Shqiptarët kanë afër 60 xhami, ose qendra kulturore islame shqiptare, ashtu siç ata emërtojnë. Në të shumtën e rasteve, ato janë depo të adaptuara për kryerjen e obligimeve fetare. Por, viteve të fundit, janë ndërtuar ca xhami të reja, në ato vende ku kanë hasur në mirëkuptim nga ana e organeve komunale dhe aty ku shqiptarët janë të koncentruar më shumë.

Sipas disa anketave paraprake, shihet se populli zviceran mbi 53% është kundër ndalimit të minareve, ndërkohë që 35% janë për ndalimin e tyre, kurse

12% nuk janë deklaruar. Mirëpo, vlen të theksohet se qeveria zvicerane, si në nivelin federal dhe atë të kantoneve, është kundër kësaj iniciative. Kjo iniciativë ka ngjallur indignatë të thellë edhe në mesin e organizatave fetare, si në atë të Kongresit të priftërinjve katolikë të Zvicrës, Organizatave të Komunitetit Hebraik të Zvicrës, Dhomës së Senatit dhe Parlamentit zviceran, si dhe të Këshillit zviceran të feve.

Që në momentin që është marrë vesh rezultati i referendumit në Zvicër, reagemet kanë qenë të menjëhershme. Sipas Erdoganit, vota e Zvicrës është "shenjë e rritjes së racizmit dhe qëndrimit fashist në Evropë". Sipas tij, islamofobia është një "krim kundër njerëzimit", ashtu si dhe antisemitizmi. Edhe Presidenti Abdullah Gul e kritikoi referendumin, në të cilin pjesa më e madhe e qytetarëve e mbështeti ndryshimin kushtetues duke e quajtur votën "fatkeqësi" për popullin e Zvicrës. Sipas tij, një votë e tillë tregonte se sa larg ka shkuar islamofobia në botën perëndimore. Rezultati u dënua edhe nga komisionari i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay, i cili në një deklaratë tha se ndalimi ishte "diskriminues, tepër përçarës dhe mbi të gjitha një hap i gabuar i Zvicrës që mund të bjerë ndesh me detyrimet e vendit ndaj të drejtave të njeriut". Ndërsa ministrja e Jashtme zvicerane, Micheline Calmy-Rey, tha se ndalimi paraqiste një



kërcënim për sigurinë e vendit. Sipas saj, tashmë ekzistonte rreziku i përgjigjes së provokimit me një tjetër provokim dhe kjo mund të sillte lindjen e ekstremizmit.

Edhe media evropiane ka qenë e ashpër ndaj rezultatit të referendumit në Zvicër. Frika më e madhe, sipas saj, është kundërpërgjigja ndaj një mase të tillë që do ta fuste situatën në një rreth vicioz pa rrugëdalje. Referendumi ishte një sinjal i gabuar që i çohet botës islame dhe çka është më e rrezikshme është krijimi i një precedenti në Evropë.



Ja disa nga reagimet për referendumin:

## "Sueddeutsche Zeitung"

"Referendumi ishte shkatërrimtar për Zvicrën. Një ndryshim i tillë kushtetues nuk ekziston askund tjetër në Evropë. Në 6 fjalët e amendamentit: "ndalohet ndërtimi i minareve me Kushtetutë" dhunohet liria e fesë dhe ndalimi i diskriminimit. Njëherazi është dhunuar edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

## "Frankfurter Allgemeine Zeitung"

Zvicra është një vend demokratik, tolerant dhe kozmopolitan, por me votën e fundit kanë dalë në pah tipare të tjera të vendit që dëshmojnë frikë, fanatizëm dhe dëshirë për t'u vetizuar.

# në Zvicër



## "Spiegel"

Vota do të dëmtojë kredibilitetin e Zvicrës, si ndërmjetës në sytë e vendeve muslimane dhe, mbi të gjitha do të shkaktojë një dëm të madh në marrëdhëniet e Zvicrës me muslimanët që jetojnë në këtë vend, pasi ky amendament promovon izolimin nga pjesa tjetër e shoqërisë.

## "Politiken"

Sinjali është dërguar. Tashmë ekziston një vend në Evropë që shpreh hapur se nuk dëshiron që të tolerojë simbolet e një feje të madhe.

## "Milliyet"

Kjo është një shenjë e shndërrimit të masave në masa autoritare dhe një shembull se sa shpejt një demokraci mund të shndërrohet në autoritarizëm.

## "El Pais"

"Reziku aktual është manipulimi i një shqetësimi njerëzor nga ana e partive të ekstremist të djathtë. Gjuha e tyre e helmët nuk ka të bëjë fare as me integrimin, as me demokracinë.

## "Neue Zürcher Zeitung"

Minaret janë simbol për situatën kërcënuese në të cilën ndodhet identiteti ynë edhe ndalimi i ndërimit të tyre nuk është shenjë e mirë. Dëmi që i bëhet reputacionit të Zvicrës është i pashmangshëm.

# Opsioni i ri gjeo-strategjik i Turqisë

Shenasi RAMADANI

**N**ë dhjetëvjetëshin e fundit Turqia është duke bërë politikë të matur e të moderuar. Duke i harmonizuar ligjet e saj me ato të Bashkimit Evropian, ajo po ndërton një rol të ri, me profil properëndimor, pa anashkalluar lidhjet me Lindjen e Mesme. Turqia po përpiket të çojë përpara profilin e saj si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje. Ajo po e bën këtë, në radhë të parë, duke e vlerësuar më shumë pasurinë e vet politiko-kulturore, duke qenë e gatshme të koeporojë me të gjithë vendet, madje edhe me ato që duken të papëlqyeshme për Perëndimin. Këtë e bën që t'i ulë konfliktet me disa vende të rajonit. Siria, ndonëse ka probleme të vjetra me Turqinë, rreth qytetit Aleksandretë (ish-territor sirian i shndërruar turk, në fund të viteve '30), prapëseprapë është duke u sjellë si një partner i çmuar politik. Armenia, e cila akoma i mban në kujtesë persekutimet turke të Luftës së Parë Botërore, e ka prituri si mik në kryeqytetin e vet presidentin turk Abdullah Gyl. Po ashtu, ka firmosur me Ankaranë edhe një marrëveshje për hapjen e kufijve dhe nisjen e marrëdhënies tregtare.

Disa analistë perëndimorë i komentojnë këto lëvizje si një tentativë të Turqisë për t'u orientuar drejt Lindjes në kurriz të Perëndimit.

Nga ana tjetër, edhe pse minoritetit kurd i ka ndaluar çdo autonomi, qeveria turke vitet e fundit ka bërë disa lëshime

kulturore ndaj këtij komuniteti (duke i garantuar përdorimin e gjuhës kurde, e cila më parë ishte e ndaluar) dhe ka garantuar një amnisti për grupet militante të PKK-së (Partisë secesioniste të Abdullah Oçalanit), të cilat i kanë bazat e tyre përgjatë kufirit më Irakun. Edhe pse shpeshherë e ka denoncuar mbështetjen e Kurdistanit irakian për gueriljen kurde brenda kufijve të Turqisë si dhe dhënien e azilit politik për shumë eksponentë të lëvizjes, ministri i jashtëm turk bëri para pak kohësh një vizitë në qytetin e Erbilit – thujse një kryeqytet ekonomik i rajonit – ku deklaroi edhe hapjen e një konsullate.

Këto sinjale drejt botës islamike janë bërë më të qarta, që kur Turqia, edhe pse ka një prani amerikane në territorin e vet, refuzoi të bëhej bashkëpunëtorë në luftën amerikane kundër Irakut (të Sadam Hyseinit). Ky spektër i ri gjeopolitik ka gëzuar mbështetjen e opinionit publik turk, në veçanti pasi kryeministri i vendit, Rexhep Taip Erdogan, bëri një protestë kundër luftës në qytetin e Gazës në Palestinë, gjatë një tryezë ekonomike në Davos, në të cilën merrte pjesë edhe presidenti izraelit Shimon Peres. Por kjo hapje ndaj botës islame, nuk e ka penguar politikën e jashtme të Ankarasë të vijojë marrëdhëniet ekonomike me partnerin italian (njëri nga furnizuesit më të mëdhenj me armatime), me BE-në, si dhe me Rusinë.

Shumë në Turqi pyesin veten nëse kryeministri Erdogan dhe partia e tij (AKP), duan ta kthejnë shtetin laik të krijuar nga Qemal Ataturku, në një



Rexhep Taip Erdogan

republikë islamike? Pasi u kontestua seriozisht nga establishment-i ushtarak, Erdogan mundi t'i fitonte zgjedhjet, të impononte kandidaturën e Gylit në krye të shtetit dhe bile kundërsulmoi, muaj më parë, me një hetim prokurorie (çështjen Ergenekon), që rrezikoi të nxirrte në dritë një komplot laiko-nacionalist, që synonte të nxirrte të jashtëligjshme, edhe njëherë tjetër, mazhorancën qeverisëse si një parti islamike.

Shumë mendojnë se kjo Turqi e re, muslimane dhe demokratike, mund të bëhet për botën që e rrethon, një nga modelet më të mira dhe për BE-në, një partner fort i rëndësishëm. Megjithatë kjo, herë-herë, has në rezistencë. Ish-kryetari i Bashkimit Evropian, Van Rompej, pati deklaruar se "Turqia asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë pjesë e Evropës." Zaten kjo ngjan të jetë edhe nyja që BE-së do t'i duhet ta zgjidhë, kur në vitet në vijim do të jetë e kushtëzuar të përballojë - kësaj herë pa ambiguitet - problemin e zgjerimit të vet edhe me Turqinë. Administrata e AKP duhet parë si administrata më realiste që Turqia ka pasur ndonjëherë. Sa u përket marrëdhënieve të jashtme, AKP nganjëherë shfaqet si qeveria më liberale dhe më e fokusuar në përfundim në historinë e Turqisë.

Ministri i Jashtëm Ahmet Davutoglu, si një aktor kryesor, beson se Turqia ka mjaft mjete në raftin e saj për ta luajtur këtë rol. Historia e saj, ekonomia në rritje, popullsia relativisht e gjerë, vendosja gjeografike me avantazhet dhe ndërlikimet e saj, identiteti fetar si dhe e kaluara laike, i jep Turqisë favore të bëhet fuqi rajonale.

Ministri i Jashtëm është një njeri në përgjithësi i qetë dhe i kthjellët. Kur erdhi në krye të diplomacisë, Davutoglu nuk ishte i panjohur në arenën politike të vendit të tij. Për disa kohë kishte shërbyer si këshilltar për politikën e jashtme në partinë që sot e ka pushtetin. Megjithatë, nuk ishte në listën e politikanëve të njohur, të atyre që kanë zotëruar skenën politike të këtyre dhjetë viteve. Por me të marrë në dorë "çelësat" e diplomacisë, ai vendosi që të ndryshojë mënyrën e të

parit të marrëdhënieve të jashtme të Turqisë, veçanërisht marrëdhënieve me fqinjët dhe vendet e rajonit, duke filluar me Lindjen e Mesme, Ballkanin dhe Kaukazin. "Pozicioni Ndërkombëtar i Turqisë" është libri që e ka bërë të famshëm në të gjithë botën, në të cilin ai parashtron të gjitha konceptet dhe linjat e politikës së jashtme. Është një njeri që i pëlqen veprimi dhe diplomacia dhe aspak të qenit një politikan tradicional. Për këtë arsye, në vitin 2002 kur partia e tij AKP fitoi zgjedhjet, ai u tërhoq nga politika për të vazhduar studimet dhe mësimdhënien në universitet. E vetmja lidhje që pati me politikën ishin konsultat e herëpashershme që bënte me Kryeministrin Erdogan. Pesë vjet më pas ai ishte në prag të "përqaftimit" të plotë të jetës akademike, kur rebelët e Kurdistanit sulmuan një postë turke,



Ahmed Dautollu

duke marrë jetën e 13 ushtarëve. Në këtë moment ai vendosi që të mos largohej nga politika përfundimisht dhe vendosi që të pranonte postin e ministrit të jashtëm dhe të ndihmonte në lehtësimin dhe përfundimin e marrëveshjeve të fundit me kurdët, të cilat u kanë ofruar atyre më shumë të drejta për vetëvendosje, duke i dhënë fund edhe gjendjes së luftës 20-vjeçare. Një nga pikat e forta të diplomacisë së tij është takimi personal me krerët e diplomacisë së vendeve me të cilat ai kërkon përmirësim të marrëdhënieve. Vetëm gjatë muajit tetor, ministri vizitoi 13 vende, duke krijuar një profil shumë të lartë diplomatik për vendin e tij. Për mënyrën e shikimit dhe të parashtrimit të çështjeve të ndryshme, Davutoglu ka fituar simpatinë e mediave arabe dhe ka pasur kërkesa që ministri të merrret edhe

me zgjidhjen e çështjeve të Libanit. Sipas një editorialisti të një gazete të Lindjes së Mesme, ministri turk "mbart ide, zgjidhje, aspirata në valixhen e tij diplomatike. Davutoglu njihet si një njeri me temperament të qetë, por shpesh e humb durimin me elitën politike të vendit të tij dhe mënyrën se si ajo e ka konsideruar deri pak kohë më parë politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me fqinjët. "Elita nuk e ndërmerr kurrë nismën dhe nuk del kurrë në front në momentet vendimtare", - ka shkruar ministri së fundi në shtyp. Sipas tij, elita mendon se politika e pasivitetit dhe e mosmarrjes së rreziqeve është më e sigurt. Nga ana tjetër, ministri njihet edhe për etikën e punës dhe vetëdisiplinën. Një mik i tij tha disa ditë më parë për një revistë turke se kur Davutoglu punonte për librin e tij, ai ishte aq i përqendruar në atë që po bënte, sa qëllonte shpesh që të kalonte dy ose tri ditë të tëra pa u çuar fare nga tryeza e punës. Ai e konsideron gjumin si një humbje kohe. Nuk kemi të drejtë që të flemë shumë, sepse kemi shumë për të bërë", - u tha njëherë studentëve të tij. Davutoglu ka qenë një njeri me ide të qarta që hershëm, që në kohën kur studioje në një nga kolegjet më të famshëm e më të mirë të vendit. Ai lexonte shumë dhe mbi të gjitha vepra filozofike dhe shkencore. Këtë bagazh ai e mbledhte duke e ditur se një

ditë në të ardhmen do t'i kishte vlejtur shumë. Ndërsa shokët e tij luanin, apo dilnin me të dashurat, Davutoglu i kalonte orët e lira mes librave. Një nga pasionet e tij është futbolli, i vetmi sport të cilin e luan herë pas here për të mbajtur trupin dhe mendjen në formë. I pasionuar pas gjuhëve të huaja, pas gjermanishtes që e mësoi në shkollë të mesme, bëri edhe shumë programe shkollimi në anglisht dhe studioi ekonomi. Teza e doktoratës ishte një analizë krahasuese mes teorive politike të Perëndimit dhe Islamit, e cila u botua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1993. Ndërkohë, ai vazhdoi edhe me studime të tjera. Ai është shumë i aftë në të shkruar dhe, po aq, edhe në të folur. Oratoria është një nga armët e forta me të cilat ai arrin të shtjellojë idetë e tij dhe të bëjë për vete audiencën. ■

# Ripërtëritja e Perandorisë Osmane

**Sondazhet e fundit tregojnë se 49 për qind e evropianëve janë kundër, kurse 32 për qind janë për hyrjen e Turqisë në BE. Me këtë rast, gjithçka tregon se numri i muslimanëve në Evropë rritet. Çështja nëse Evropa është e frikësuar nga Islami dhe Turqia ishte një nga çështjet kryesore në konferencë e paradokohshme në Uashington, për statusin e tanishëm dhe të ardhshëm të Islamit në Evropë**

Sipas prononcimeve të ekspertëve, të cilat i ka paraqitur gazeta "Daily Telegraph", në vendet e Bashkimit Evropian, deri në gjysmën e këtij shekulli, rreth 20 për qind e popullsisë do të jenë muslimanë.

Numri në rritje i emigrantëve nga vendet muslimane, i kombinuar me natalitetin e ulët të popullsisë vendase të Evropës, janë arsye kryesore për çka në katër dekadat e ardhshme pritet rritja e madhe e numrit të muslimanëve në Evropë - përmendin ekspertët e statistikave, nga vendet e BE-së për këtë gazetë.

## Ankaraja dhe BE-ja

Përpyekjet e Turqisë për të hyrë në Bashkimin Evropian morën hov të ri, pasi Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësim me Ankaranë. Në këtë kuptim, Ankaraja ka filluar një sërë reformash themelore. Përpyekjet e Turqisë për t'iu afruar Evropës kanë filluar në vitin 1953, kur Turqia nënshkroi marrëveshjen me paraardhësin e Bashkimit Evropian. Megjithatë, vetëm kur u bë kandidatë zyrtarë në vitin 1999, Turqia ka filluar të punojë me ritëm ambicioz për hyrjen në Bashkimin Evropian, duke zbatuar një sërë reformash: nga ndalimi i dënim-it me vdekje, e deri te harmonizimi i ligjeve me ligjet e Bashkimit Evropian.

Në videoklipin që u shfaq në "You-

tube", që ishte motiv për komentet e ekspertëve të statistikës në "Daily Telegraph", vendi që shumë shpejt do të bëhet me shumicë muslimane është Holanda. Në këtë vend, pohohet, se tani për tani 50 për qind e foshnjave të sapolindura janë të fesë muslimane, që do të thotë se për 15 vjet ata do të përbëjnë gjysmën e popullsisë së përgjithshme. Sipas të njëjtit burim, në Francë, 30 për qind e popullsisë, që janë më të rinj se 20, vjet janë muslimanë. Pohimi mbështetet në të dhënat se familja mesatare franceze ka 1,8 fëmijë, ndërsa për familjen muslimane përmendet shifra mesatare 8,1. Në bazë të lindshmërisë 4,5 herë më të madhe arrihet në përfundimin se Franca për 39 vjet do të bëhet republikë islamike. Për Gjermaninë parashikohet që për 50 vite të bëhet një vend me shumicë muslimane, ndërsa për Rusinë tregohet e dhëna se 40 për qind e ushtrisë të saj, për disa vite, do të përbëhet prej muslimanëve.

Demografët, të cilët e komentuan videon në "Youtube", thonë se këto të dhëna nuk mbështeten në fakte, sepse në disa vende nuk ka evidencë për religjionin. Megjithatë, ata thonë se të dhëna të sakta do të ketë vetëm pas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011.

Sidoqoftë, krejt kjo tregon se numri i muslimanëve në Evropë po rritet. Po, a është Evropa e frikësuar nga islamizimi?!

Turqia, pikërisht për këtë ka probleme me pranimin në BE, veçanërisht nëse merret parasysh se në rast të pranimit, do të ishte një prej shteteve anëtare më të mëdha të kontinentit të vjetër. Kjo ka qenë një nga temat e diskutuara në një konferencë në Uashington, në lidhje me statusin e tanishëm dhe të ardhshëm të Islamit në Evropë.

Pjesëmarrësi i tubimit, Daniel Pipes, drejtor i Forumit për Lindjen e Mesme, shprehu mendimin se popullsia muslimane është inkurajuar nga shkalla e lartë e natalitetit dhe mundësive për të marrë shtetësinë e plotë.


- Popullsia muslimane, në rritje në Evropë, po bëhet edhe forcë e fuqishme politike. Ky elektorat i ri musliman ose do të miratojë traditën evropiane të demokracisë liberale, ose bastioni historik i krishterë në Evropë do të lëshojë pe para doktrinës së Islamit. Në radhë të parë, feja në mënyrë dramatike ka marrë tatëpjetën në Evropë. Evropa në mënyrë ekstreme bëhet e shekullarizuar, veçanërisht në shtresat më të larta shoqërore. Ndërsa krishterimi dobësohet, Islami është i fuqishëm, i depërtueshëm dhe ambicioz - vlerësoi Pirs.

## Turqia në Ballkan

Kolegu i tij Kemal Silaj, profesor në Universitetin e Indianës, pohoi se format fundamentaliste të Islamit radikal nuk janë kompatible me asnjë lloj të shoqërisë shekullare.

- Turqia është shtet shekullar. Dhe në qoftë se një vend tradicionalisht musliman nuk mund të lejojë që të inkuadrojë ose të paktën të tolerojë Islamin, atëherë cilat shtete nga Evropa apo Amerika mund të presin që të jenë të obliguara për të përmbushur kërkesat apo pritjet e fundamentalistëve? - pyeti ai, duke shtuar se nuk duhet përzier ekstremizmin islamik me fenë islame.

- "Nëse islamizmi nuk ndahet përfundimisht nga Islami, atëherë nuk ka shpresë për atë që ne e quajmë proces të integritimit efektiv të muslimanëve në



shoqërinë perëndimore”, - shtoi ai.

Së bashku me historinw rreth islamizimit të Evropës, në Serbi dhe Ballkan është ngjallur, megjithëse nga një pjesë e vogël e aktorëve politikë në rajon, edhe teza e njohur që nga lufta në Bosnje se muslimanët duan shtetin e tyre në Evropë, madje duke pasur për qëllim ripërtëritjen e ish-Perandorisë Osmane. Përkrahësit e kësaj teze e gjejnë konfirmimin e kësaj ideje në fjalët e ministrit të jashtëm turk Ahmet Davutoglu, në fjalimin e mbajtur në mes të tetorit të këtij viti, në Sarajevë, në hapjen e konferencës "Trashëgimia osmane dhe komunitetet muslimane të Ballkanit sot", në të cilën ai rikujtoi të drejtat historike të Turqisë në Ballkan. Një pjesë e analistëve, të cilët merren me ngjarjet në Bosnjë kujtojnë se ky fjalim pasoi menjëherë pas negociatave të dështuara në Butmir dhe kërkesave gjithnjë e më të zëshme nga pala boshnjake për entitet të posaçëm në Bosnje. Po këta i referohen edhe përmbajtjes së librit të botuar para ca kohëve, që përmban shënimet e Bill Clinton-it, ish-president i SHBA-ve, ku thuhet se gjatë luftës në Bosnje, evropianët ishin të frikësuar nga krijimi i një shteti musliman në këtë republikë ish-jugosllave dhe se ata ndërprejnë çdo formë të përkrahjes, që rezultoi me krijimin e Bosnjës së sotme.

### Turqia dhe Serbia

Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet midis Serbisë dhe Turqisë shkojnë e përmirësohen. Turqia do të ndihmojë rimëkëmbjen ekonomike të Sanxhakut, pjesë e Serbisë ku jetojnë shumica e qytetarëve, të cilët deklarohen si muslimanë ose boshnjakë. Turqia do të financojë një pjesë të rrugës Korridori 10...

Dragan Paniq, profesor i historisë nacionale në Universitetin serb të Mitrovicës, mendon se ideja e islamizimit të Ballkanit është bërë paksa bajate.

- "Fillimisht ishte ide e një rrethi të gjeopolitikanëve, të cilët besonin se mund të kontrollonin faktorin islam. Megjithatë, kjo pikëpamje pësoi ndryshime, pasi u nënvlerësua fuqia e Iranit dhe ndikimi i Rusisë në botën islame dhe kjo çoi deri te mëvetësimi i Turqisë. Pozicioni i Turqisë është i dykuptimshëm. Nga njëra anë, në një farë mënyre i afrohet Rusisë, kurse, nga ana tjetër, dëshiron të jetë e pranishme në Ballkan

në mënyrë të pavarur nga BE-ja dhe kjo strategji nuk është ende plotësisht e qartë”, - thotë Paniq.

Përkrahësit e tezës mbi ripërtëritjen e Perandorisë Osmane në Serbi gjithnjë e më shumë kujtojnë referendumin e mbajtur në vitet nëntëdhjetë në Sanxhak, për t'iu bashkuar amës në Sarajevë, duke thënë se problemi me Sanxhakun mund të plasë në qoftë se Serbia e shfrytëzon Republikën Serbe në Bosnje si atu kundër pavarësisë së Kosovës. Disa mendojnë se, në këtë rast, pritjet që Sanxhaku të jetë si atu e të shfaqet si një kartë e fortë në duart e Sarajevës. Shikuar realisht, secesionizmi në Sanxhak, në qoftë se ka ekzistuar ndonjëherë, ishte qetësuar vitet e mëparshme. Konfliktet e dy partive boshnjake, të udhëhequr nga Sulejman Ugljann dhe Rasim Lajiqi, janë minimizuar.

Profesor Paniqi mendon se ekziston një farë lloj rreziku, por se nuk duhet bërë panik.

- Asgjë nuk është e drejtpërdrejtë, por potencialisht është diçka që duhet të mendohet dhe të eliminohet me një strategji specifike. Sepse në qoftë se këto shqyrtohen nga persona shumë më të fuqishëm se ne, atëherë as ne nuk duhet të jemi indiferentë. Sigurisht, nuk duhet të bëjmë panik, sepse kjo mund të shfrytëzohet nga lojtarë shumë më të mëdhenj, më të rrezikshëm për interesat tona, si për shembull, ata që na e rrëmbyen Kosovën - shpjegon ai, duke shtuar se Serbia është e nevojshme të ketë marrëdhënie të mira me Turqinë.

Ata të cilët merren seriozisht me gjeopolitikë besojnë se Turqia ka qëllime strategjike që me krijimin e marrëdhënieve të mira me Serbinë, të ndërmytesojë bashkërisht në "zbutjen" e gjendjes së tensionuar ndërmjet Republikës Serbe dhe Federatës Boshnjako-Kroate, në arritjen e zgjidhjeve të kompromisit, të cilat çojnë në ndryshimet etapore të kushtetutës.

Nga ana tjetër, sondazhet e fundit tregojnë se 49 për qind e evropianëve janë kundër, kurse 32 për qind janë për hyrjen e Turqisë në BE. Vëzhguesit theksojnë, gjithashtu, se Ankaraja duhet t'i bindë vendet anëtare që, për shkak të popullsisë së saj të shumtë, nuk do ta prishë ekuilibrin ekzistues në Parlamentin Evropian. ■

Përktheu nga gjuha serbe:  
**Agim Abazi, 7 Dhjetor 2009**

# Strategjia



**Mr. Ajni SINANI**

**Q**ë sonte po njoftoj, se 30 mijë trupa shtesë do të dislokoohen, me shpejtësi sa më të madhe, në pjesën e parë të vitit 2010, ashtu që të mund t'i vënë në shënjestër kryengritësit dhe t'i sigurojnë qendrat kryesore” - ka thënë Barak Obama.

Ligjvënësit amerikanë kanë reaguar në mënyrë të ndryshme ndaj strategjisë së re të presidentit Obama për Afganistanin. Disa, përfshirë edhe anëtarë të Partisë Demokratike, kanë shprehur shqetësim rreth vendimit të tij për të dërguar më shumë trupa në Afganistan. Në seancën e dhomës së përfaqësuesve, demokrati nga Teksasi, Llojd Dogget, ka thënë se presidenti po e fut konfliktin në një fazë më të gjatë. Demokrati nga Ohajo, Denis Kucinich, thotë se njerëzit në Afganistan dëshirojnë që trupat amerikane të jenë jashtë vendit të tyre.

*“Ne kemi punuar me të gjitha palët në Afganistan dhe të gjithë ata duan që ne të ikim prej atje. Ata nuk e duan praninë tonë, nuk e duan kontrollin tonë, trupat tona, aeroplanët tanë pa pilotë, ose stilin tonë të jetës. Ne po bëjmë një luftë të gabuar në vend të gabuar dhe në kohë të gabuar.”*

Obama, për të qartësuar çdo skeptik për këmbënguljen e SHBA për të përfunduar këtë mision, ka thënë: “Nuk kemi të bëjmë vetëm me numrin e trupave, por me strategjinë. Dhe strategjia jonë është shumë e qartë: të transferojmë sa më shpejt përgjegjësinë tek afganët, në mënyrë që të jenë ata që do ta drejtojnë totalisht vendin e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne duam që ky tranzicion të bëhet realitet sa më shpejt dhe afganët të marrin drejtimin...”

Ai është shprehur se 18 muaj janë të mjaftueshëm për të rritur numrin e mjaftueshëm të ushtrisë afgane, policisë dhe qeverisë qendrore. Kjo do të vinte si pasojë e dyfishimit të numrit të ushtarëve afganë brenda një viti. Presidenti Obama ka thënë se misioni në Afganistan nuk është një mision pa afat.

# e Obamas për Afganistanin

Obama ka thënë në fjalim se: "trupat shtesë amerikane dhe ndërkombëtare, së bashku, do të na lejojnë ta shpejtojmë kalimin e përgjegjësive te forcat afgane dhe do të na mundësojnë fillimin e largimit të trupave amerikane nga Afganistani, në korrik të vitit 2011."

Mirëpo, shumë ekspertë vlerësojnë se një vit, që u mbetet ushtarëve për operacionin e tyre, është kohë e shkurtër për të shkatërruar El Kaidën dhe në të njëjtën kohë për të përgatitur ushtrinë afgane. Prandaj, stërvitja e trupave vendase do të jetë një sfidë e madhe për NATO-n. THE GUARDIAN citon një komandant britanik se kjo sfidë është 'njësoj sikur të ndërrosh rrotat e një autobusi kur ai është në lëvizje'. Madje sipas kësaj gazete do të duhen 8-10 vjet që në Afganistan të krijohet një forcë sigurie profesioniste.

Ligjvënësit republikanë, si senatori Xhon Mekejn dhe përfaqësuesja Ilena Ros-Lehtinen, të cilët përshëndetën rritjen e numrit të trupave, thanë se presidenti ka bërë gabim që ka caktuar një afat për tërheqjen e trupave. John McCain mendon se plani do të ketë sukses, por Obama nuk duhet të vendosë afate për tërheqjen nga Afganistani. Analisti i çështjeve të sigurisë, David Livingston, në qendrën kërkimore Chatham House në Londër, thotë se afatet e ngurta kohore sjellin probleme.

Ambasadori amerikan Louis Susman, në Britani, ka thënë se afati i përcaktuar nga presidenti Obama për fillimin e tërheqjes së trupave amerikane nga Afganistani është keqkuptuar dhe do të konfirmohet pas një studimi që do të kryhet në shtator të vitit të ardhshëm. Sipas Sekretarit të Jashtëm britanik, David Milliband, qeveria afgane do të mund të binte brenda disa javësh, nëse NATO do të tërhiqej tani.

Obama u ka kërkuar vendeve aleate që të kontribuojnë me më shumë trupa për të luftuar në Afganistan dhe ai ka shprehur besimin se ato do ta bëjnë këtë.

Sekretari i Përgjithshëm i Natos, Rasmusen, e ka mirëpritur njoftimin e Presidentit Obama:

"Mendoj se është vendimi i duhur për Afganistanin dhe NATO-n. Ky nuk është vetëm një mision amerikan. Janë 43 vende të tjera në terren, nën komandën

e NATO-s dhe kam besim se aleatët dhe partnerët tanë do të angazhohen për një rritje të ndjeshme të trupave të tyre."

Por udhëheqësit evropianë kanë nguruar të bëjnë zotime të reja konkrete. Britania ka rreth 9500 trupa në Afganistan, përfshirë Forcat Speciale dhe Brown ka premtuar të dërgojë edhe 500 trupa shtesë. Turqia ka thënë se një gjë të tillë e ka bërë më parë, prandaj nuk do t'i shtojë trupat e saj. Erdogan ka deklaruar "Turqia e ka bërë atë që i takon, duke dërguar 1.750 trupa nga rreth 700 të kërkuar".

Në Britani ka pasur debate të hapura që vënë në pikëpyetje aftësinë për sukses dhe për t'u tërhequr nga Afganistani. Të shumtë kanë qenë ata që e kanë mirëpritur njoftimin se trupat amerikane do të fillojnë tërheqjen nga Afganistani nga mesi i vitit 2011.

Obama ka mbajtur fjalimin ndërkohë që mbështetja amerikane për luftën vazhdon të bjerë. Një anketë e re e organizatës Gallup tregon se vetëm 35 për qind e amerikanëve të anketuar e mbështesin kursin e Presidentit Obama në Afganistan, ndërsa 55 për qind janë kundër. Ekspertët theksojnë se është e domosdoshme që luftës t'i jepet fund nga vetë afganët, me një kombinim të eliminimit të talebanëve dhe vendstrehimeve të tyre. Një ish-operativ për operacionet speciale të KGB-së në Afganistan thotë se gabimi kryesor i NATO-s qëndron në faktin se nuk po i kushton vëmendje siç duhet ekuilibrin mes fiseve afgane, sidomos atyre pashtunë, që përbëjnë edhe gjysmën e popullsisë.

## Të vrarët

Lufta në Afganistan ka pasur një kosto të konsiderueshme. Më shumë se 1 mijë e 500 trupa të huaja janë vrarë në Afganistan, që kur filloi lufta në vitin 2001, ku më shumë se 900 prej tyre ishin amerikanë. Në gusht, numri i amerikanëve që humbën jetën brenda një muaji ishte më i larti që nga viti 2001.

## Sfida

Infrastruktura për të mbështetur operacionet ushtarake të Shteteve të Bashkuara në Afganistan është e mbingarkuar dhe përbën sfidë serioze për këtë numër të madh trupash.

Sfidat logjistike janë të pranishme

në bazën Bagram, jashtë Kabulit. Kjo ish-bazë sovjetike është qendra kryesore e furnizimeve amerikane të luftës, e personelit dhe e mjekimeve. Terminalët e udhëtarëve dhe të transportit të mallrave janë të mbushura në kapacitet të plotë - thotë nënkoloneli Dan Krall, një nga strategët që punojnë nën komandën e gjeneralit Kwast: "Çdo ditë në transportojmë rreth 4 mijë udhëtarë dhe 400 ton mallra".

Infrastruktura mjekësore përbën një tjetër problem. Me shtimin e numrit të të plagosurve, spitali ushtarak në Bagram, më i madhi në Afganistan, po punon edhe jashtë orarit. Komandanti i spitalit, koloneli Joe Chozinski, thotë se rastet e urgjencës janë pesëfishuar në krahasim me vitin e kaluar "Çdo muaj vizitojmë 3 deri në 4 mijë njerëz. Duke pasur parasysh numrin e pacientëve, të operacioneve kirurgjike dhe duke pasur parasysh se sa kritike janë ato, ne barazohemi me qendrën që trajton pjesën më të madhe të traumave në gjithë Shtetet e Bashkuara". Për t'iu përgjigjur kërkesës, spitali në Bagram ka shtuar një çadër për të sistemuar pacientët që dërgohen me avion në spitalet amerikane.

## Kostoja

Një milionë dollarë kushton stacionimi i secilit ushtar çdo vit. Obama ka thënë se strategjia e re në Afganistan do t'i kushtojë Amerikës rreth 30 miliard dollarë vitin që vjen dhe se ai do të punojë nga afër me Kongresin për të zgjidhur problemin e koston, ndërkohë që administrata përpiqet të rimëkëmbë ekonominë e përfshirë nga recesioni. Ligjvënësit republikanë dhe demokratë janë shprehur se elektorati i tyre po shtron pyetje lidhur me shtimin e trupave të përfshira në Afganistan, kur ka një numër çështjesh të brendshme që kërkojnë zgjidhje. ■



Barak Obama

# Gruaja e parë me shami në Shtëpi

**D**alia Mogahed është gruaja e parë me shami që ka hyrë në Shtëpinë e Bardhë. “Nuk mund të them se ndihem e ofenduar kur më cilësojnë në këtë mënyrë, por do të preferoja që vëmendja të përqendrohej më shumë te kërkimet e mia, mbi motivet që më shtynë të punoja për Presidentin dhe jo te shamia. Megjithatë, jam mësuar ta pranoj faktin që të gjithë e shikojnë, madje mediat, sidomos ato arabe, më kanë bërë simbolin e ri të Shtëpisë së Bardhë, që përfshin dhe nuk përjashton. Nuk dua të jem një simbol, por kam kuptuar se mund ta përdor këtë gjë për t’i bërë njerëzit të kuptojnë se kush jam unë dhe se çfarë bëjnë muslimanët në Amerikë”. Dalia ka një buzëqeshje të sigurtë, aftësinë për të qenë e qetë dhe nuk emocionohet lehtë. As kur dëgjoi Presidentin që i drejtohej botës arabe me fjalimin e tij, duke ndjekur këshillat që ajo i kishte dhënë, pikërisht nga Egjipti, vendi nga i cili ajo ishte larguar që fëmijë, për të ndjekur aventurën që do ta shpinte drejt Shtëpisë së Bardhë. Kjo është Dalia Mogahed, 36 vjeçe, këshilltare e Presidentit amerikan, Barak Obama, për marrëdhëniet me botën muslimane dhe autore e

“Who speaks for Islam?”. Libri, vitin e kaluar, në SHBA, monopolizoi për shumë javë me radhë vëmendjen e gazetave dhe televizioneve vendase. Në Shtëpinë e Bardhë, Mogahed erdhi drejt e nga “Gallup”, një nga qendrat e kërkimeve më prestigjioze në Amerikë. Duke nisur nga viti 2001 ka punuar për pesë vjet me kolegun John Esposito, për studimin më të madh të bërë ndonjëherë për muslimanët në botë. “Në këto kohë tensionesh ekstreme dhe armiqësie në rritje, pak libra do të mund të dilnin në kohën e duhur” - u shpreh fituesi i çmimit “Nobel” për paqen Desmond Tutu, kur rezultatet e kërkimeve të tyre u publikuan në SHBA. “Qëllimi ynë ishte të zhvendosnim debatin për muslimanët në një drejtim më konstruktiv. Për

një kohë të gjatë është thënë se konflikti mes shoqërive me shumicë muslimane dhe Perëndimit, në veçanti SHBA-së, ishte i pashmangshëm. Përkundrazi, libri tregon që nuk është kështu. Këtë e bën duke nxitur që të flasë mazhoranca e heshtur e muslimanëve, ajo që nuk arrin të nxjerrë zë, sepse dëbohet nga qeveritë represive, nga mediat që nuk i konsiderojnë aq interesante sa duhet, ose nga ekstremistët. Po ashtu, aty tregohet se pikat e “ngrirjes” mes botës muslimane dhe Perëndimit përqendrohen në politikën tranzitore, jo mbi parimet themelore. Aty thuhet se gjëja që muslimanët adhurojnë më shumë nga Perëndimi është liria politike dhe ajo e shprehjes dhe se pjesa më e madhe e të intervistuarve, përfshi 73 për qind të sauditëve dhe 89

kishte lexuar apo jo. Por, pas disa kohësh, një person që kishte qenë në studion e tij në Senat, më tha se libri ishte aty, në vend të dukshëm. M’u duk një shenjë inkurajuese dhe u kënaqa shumë” - kujton Mogahed. E në të vërtetë, aq shumë e kishte tërhequr ai libër senatorin amerikan, sa kur u zgjodh Presidenti i parë me ngjyrë në historinë e SHBA-së, pak muaj më vonë, e thirri Dalia Mogahedin të ishte pjesë e “Advisory Council on Faith-based and neighborhood partnership”, për të mbajtur një vend të rëndësishëm, atë të këshilltares për marrëdhëniet me botën muslimane: një nga pikat kyçe ku luhet suksesi i Presidencës Obama. “U befasova shumë kur më thirrën. Natyrisht u ndjeva e nderuar. Fakti që mbaj shami nuk ka ndikuar fare në zgjedhjen e tij. Ajo që Presidenti kërkon është të dëgjojë zërat e muslimanëve, të dijë se çfarë mendojnë vërtet, në mënyrë që t’i kuptojë dhe t’i përfshijë muslimanët amerikanë në jetën normale. Përshtypja e menjëhershme ishte se idetë e mia, ashtu si ato të gjithë atyre që punojnë në këshill, do të merreshin shumë seriozisht”. Detyra më delikate e këshilltares, deri më tani, ka qenë hartimi i linjave të guidës, për fjalimin e Kajros, me të cilin Obama u përpoq të zvogëlonte



Dalia Mogahed

për qind të iranianëve, mendojnë se gratë duhet të kenë të njëjta të drejta si burrat. Gjithashtu, në libër tregohet qartë se në vendet me shumicë muslimane, pjesa më e madhe e njerëzve i dënojnë ngjarjet e 11 shtatorit të vitit 2001 dhe se ajo pjesë e vogël që i justifikon dhe ka një mendim negativ për SHBA-në (7 për qind) nuk është më shumë besimtare se pjesa tjetër e popullsisë. Ide që diheshin, mund të thuhet sot, por kur nisën të qarkullonin në Amerikën e Bushit, dukeshin vërtet revolucionare, aq sa tërhoqën edhe vëmendjen e senatorit të atëhershëm të Illinoisit, Barak Obamës. “Kur doli libri, i dërguam nga një kopje të gjithë anëtarëve të Kongresit, përfshi edhe Obamën, që na u përgjigj me një kartolinë falënderimi. Nuk e njihim fare dhe nuk e kishim idenë nëse e

te hendekun e ndarjes që kishin krijuar tetë vitet e Bushit mes SHBA-së dhe botës arabe. “U përpoqa të mendoja se çfarë qëndronte në zemër të konfliktit dhe e kuptova se duhej të flisnim për respekt. Por edhe për zgjedhjet politike të Amerikës që nuk u pëlqejnë muslimanëve. Nuk duhej të shisnim idealet e Amerikës, sepse njerëzit i njohin dhe i adhurojnë tashmë, siç tregon kërkimi i ‘Gallup’. Ajo që duhej, ishte ndryshimi i kursit, të njihnim rëndësinë, jo të qytetërimin tonë, por atij të muslimanëve. Njerëzit e botës arabe nuk kishin nevojë t’u bëje lajka, por të pranoheshin. Të shihnin se pikëpamjet e tyre pranoheshin në shoqëri dhe nuk injoroheshin. Ia kalova idetë e mia atij që shkruan fjalimet me Presidentin. U gëzova kur pashë se ato u mirëpritën”. Pas lavdisë,

# në e Bardhë Bashkësitë religjioze

janë rritur polemikat. E kritikuar në momentin e emërimit të saj, Mogahed është vënë në shënjestër në atdheun e saj për faktin se u shfaq në një program televiziv bashkë me një anëtar të "Hizbullah Tahrir", një grup i konsideruar ekstremist, si dhe për mbrojtjen që i bëri Ligjit të Sheriatit. "Ishte një përvojë që më ka mësuar shumë. Unë flisja për rezultatet e kërkimit, ndërsa ai i injoronte për të shfrytëzuar vetëm gjërat që i duheshin për idetë e tij. Në fillim u sulmova nga ai, pastaj nga ata që më kanë akuzuar për bashkëpunim me ekstremistët, gjë që tregon se sa i fortë është refuzimi i një dialogu të vërtetë, të bazuar te faktet", - thotë ajo tani. Ndërkaq, zhgënjimi që ndiejnë shumë arabë nga Obama, si fajtor që nuk e zhblokoi procesin e paqes në Lindjen e Mesme dhe zgjedhjes për të dërguar trupa shtesë në Afganistan, ka rënduar edhe mbi të. "E kuptoj zhgënjimin. Por kur u zgjodh Obama, pritisshmëritë ishin shumë të mëdha dhe të arrije t'i kënaqje të gjithë ishte thujtë e pamundur. Vazhdoj të besoj se pas ca kohësh, kur ta lëmë pas këtë moment, do ta shohim ende si një fazë përmirësimi". Megjithatë, ajo vazhdon ta bëjë pjesën e saj. Në SHBA, "Who speaks for Islam" është bërë një film, që pasi u shfaq në mënyrë të rezervuar politikanëve dhe artistëve në Departamentin e Shtetit në Uashington, po qarkullon me sukses nëpër kinema dhe, shumë shpejt, do të mbërrijë në televizion. Në të njëjtën kohë, libri i saj ka mbërritur në Evropë. "Mendoj se është pozitive që ky libër të dalë në Evropë, pikërisht tani. Referendumi në Zvicër mund të ketë efekt edhe në pjesën tjetër të kontinentit dhe mendoj se është diçka e mirë që ka të dhëna shkencore në dispozicion për të rrëzuar mite të pabaza, si ai i kontinentit të vjetër që po dëbon arabët. Ideja e "Euroabisë" nuk e reflekton evidencën empirike. Ndërkaq, Evropa ka nevojë për forcë pune për të rritur ekonominë: dhe është fakt që kjo forcë pune sot përbëhet nga një pjesë e mirë qytetarësh apo emigrantësh, origjina e të cilëve është nga vendet muslimane. Të qenit një vend i hapur ndaj talenteve dhe punës, e ka bërë SHBA-në vendin më të rëndësishëm në botë. Duhet të mendoheni".

**Përktheu: Arsim JONUZI**

**Do të ishte më mirë sikur institucionet shtetërore të merreshin me distribimin e taksave e të mos kishim dublifikimin e tyre. Kështu do të kishim një mbikëqyrje më efikase dhe me më pak kokëdhembje nga të dy palët. Shpërndarja do të bëhej në mënyrë institucionale, gjë kjo që nënkupton veprim të kënaqshëm dhe legal. Pastaj populli do t'ia linte përgjegjësinë të zgjedhurve të vet në institucionet e tij. Mosdalja në zgjedhje është treguesi më i mirë, i cili po sfidon seriozisht shtetet demokratike**



**Muhamed J. KAJOLLI**

**S**'do mend se feja ndikon dukshëm te masat e gjera popullore, për shkak të takimeve ditore, javore apo mujore, që mbahen në mjediset e objekteve të kultit, ose në takime të tjera vjetore që janë të përmahësive haxhi në Vatikan, eve në lumin është fjala e e riprodhuar që të kthehet Përditshësë ritualeve bërë që rimos ju organizimi daj "feja lidhje të fortë grupit më të Këta faktorë

save më të mëdha, në Mekë, pashkët pastrimi i mëkat-Gang, etj. Por, kur religjionit, kujtesa ndër shekuj, bëri në identitet fetar. mëria e kryerjes obligative, ka ligjiozëve të mungojë orformal, pranpërfaqëson një mes individit dhe gjerë shoqëror. përbëjnë bazën

e bashkimit dhe janë shprehje e kuptimeve kolektive."

## Sistem i ndarë ose i përzier

Askush nuk mund të thotë se religjioni nuk është prezent në jetën e përditshme dhe nëpër institucionet e të gjithë qeverive të botës. Nëse jo drejtpërdrejt, ai së paku paraqitet në sfond. Religjioni shpeshherë ka fjalën e fundit dhe është vendimtar në diplomaci, si dhe në bërjen e politikave të rëndësishme së veçantë në botë. Kush kishte për të besuar se evropianët, brenda këtij shekulli, do të kishin marrë vendim në dëm ose në dobi të një shteti tjetër dhe shkaktar të ishte përbërja religjioze e atij shteti?! Turqia e deklaruar me kushtetutë si një shtet laik, nuk po pranohet tash e gjysmë shekulli në BE, vetëm e vetëm se është shtet, sfondi i së cilës është me përbërje religjioze të kundërt me shtetet e BE-së. Është e vështirë të thuhet e të përcaktohet se sa mund të jetë funksionale ose sa do të ishte e dobishme për popujt ndarja e shtetit me bashkësitë religjioze. "Parimi i ndarjes së shtetit dhe kishës kërkon nga institucionet shtetërore





paanshmëri të rreptë në interaksion me bashkësitë fetare. Parlamentet dhe gjykatat, qeveria dhe administrata shtetërore e cenojnë ligjin moral të neutralitetit botëkuptimor, kur ata e privilegjojnë njërenë anë në llogari të tjetrës.”

### Veprimtaria e bashkësive fetare

Është për t'u habitur kur analistët e fushave të ndryshme bëjnë akoma pyetje rreth formës dhe veprimit të bashkësive religjioze. Kjo vjen ose si rezultat i mosnjohjes së konceptit dhe paraqitjeve të religjioneve, ose si rezultat i hulumtimit të gjetjes së formës për manipulim me to. “Ndërsa sa i përket bashkësive fetare, doemos duhet që të bindemi se si veprojnë këto grupe, cila është literatura e tyre dhe cili është preokupimi i tyre ndaj fqinjët dhe të huajve. Politika, kultura dhe veprimet fetare duhet të kombinohen aq mirë sa të mos përsëritet rasti i Bosnjës.”

Ajo çfarë ndodhi në Bosnje, gjegjësisht në Srebrenicë, ishte vrasje e ndërgegjegjes evropiane. Evropa sot po përballet edhe me një komunitet tjetër të madh në kontinentin e vet. Muslimanët, që i përkasin fesë së dytë në Evropë, janë gjithnjë e më të dukshëm në publik. Sjelljet dhe veprimtaritë e tyre ndryshojnë dukshëm krahasuar me veprimet e të

krishterëve, si në dukje të jashtme, në veshje, ashtu edhe brenda shtëpive të tyre. Muslimanët kanë një sistem tjetër të jetesës në përditshmërinë ditore dhe atë e organizojnë në saje të obligimeve që kanë brenda një dite. Evropianët, detyrimisht, duhet të gjejnë forma të integritit të tyre që edhe këta të bëhen pjesë e zhvillimit dhe jetës normale në këtë kontinent. “Nëse të shpërngulurit integrohen në këtë mënyrë, Bashkësia Islame në Evropë do të bëhet urë midis Evropës dhe shteteve prej të cilëve janë të shpërngulurit. “Euro-muslimanët” do të jenë në gjendje të shërbejnë në transferimin e principeve demokratike në politikë, si dhe do të bartin idetë liberale dhe reformat në shtetet e tyre.”

### Dublifikimi i buxhetit rëndon shoqërinë

Religjiozët janë prezent kudo. Ky është një realitet. Ata punojnë, paguajnë taksat dhe janë aktivë në të gjitha fushat e jetës së përditshme. Funksionojnë njëllë siç funksionojnë individët joreligjiozë. Këta jo vetëm që janë prezent, por luajnë edhe një rol të rëndësishëm në shoqëri. Pak rëndësi ka se si trajtohen në vendet e tyre, dallimi qëndron te mënyra e veprimit me ta. Në disa shtete,

religjiozët janë fare të parëndësishëm për shkak të neglizhencës dhe injorancës së pushtetarëve të tyre. Në disa shtete të tjera, roli i tyre është i nivelit të dytë, ndërsa në disa shtete të tjera, ata kanë rolin vendimmarrës.

Nuk mund t'i iket religjionit, aq më tepër kur kemi të bëjmë me religjionet e mëdha, aty ku grupe të mëdha njerëzish, fisesh ose edhe popujsh bashkëjetojnë me të. Në thelb ato janë bashkësi, të cilët e ruajnë kujtesën kolektive dhe jetojnë dhe veprojnë në saje të vazhdimësisë së kësaj kujtese. Kujtesa përthith në vete përvojën fetare, e cila është zhvilluar gjatë ritualeve të përbashkëta, që nga moshë e hershme dhe këto përvoja të ritualeve riprodhojnë energji dhe gjenerata të reja.

Kështu përfitohet ndjenja e të menduarit dhe vepruarit në kolektiv brez pas brezi, deri te formimi i identitetit. Të marrim shembullin e popullit shqiptar në Ballkan. Për disa shekuj me radhë, ky popull ka jetuar me përvojën e muslimanit. Pas një periudhe të gjatë të pushtimit sllav, kujtesa e përvojës së fituar nuk iu zhduk. Ky popull jetoi në saje të kësaj kujtese, bile kjo kujtesë fetare ishte gjeneratori kryesor i ruajtjes së identitetit të tij kombëtar.

Ky popull e ruajti dhe e kultivoi fenë e tij, duke iu falënderuar fillimisht parimeve bazë të fesë së tij dhe tani po e plotëson atë në saje të master politikës amerikane. “Befasues është revitalizimi politik i religjionit në brendinë e SHBA-ve, pra të shoqërisë perëndimore, ku dinamika modernizuese shpalolet më me sukses. Sigurisht se ne në Evropë, edhe atë qysh në kohërat e Revolucionit Francez, e njohim fuqinë e një tradicionalizmi fetar, të kuptuar si kundërrivolucionar. Mirëpo, me këtë kujtesë të religjionit si një fuqi e traditës del në pah edhe dyshimi brejtës në vitalitetin e thyer të trashëguarës. Nga ana tjetër, zgjimi politik i një vetëbesimi të fuqishëm fetar në SHBA duket të jetë i paprekur nga dyshimi në një fuqi, tashmë të futur në pasiguri nëpërmjet refleksionit.”

Këto bashkësi janë prezente, prandaj kur bëhet fjalë për Islamin dhe Krishterimin, ato nuk duhen trajtuar si organizma shoqatash të vogla. Shtetet demokratike, duke u munduar ta ruajnë laicitetin e tyre, kanë hapur zyra për regjistrimin e organizatave joqeveritare, por kjo nuk do të ishte e përshtatshme dhe nuk do t'i kënaqte bashkësitë e mëdha fetare.

Askush nuk e mohon faktin se këto bashkësi fetare ekzistojnë në saje të donacioneve, të cilat i grumbullojnë në mënyra të ndryshme. Secila bashkësi religjioze ka formën e vet të vjeljeve të anëtarësive dhe donacioneve, por nëse kjo do të bëhej në mënyrë institucionale, do të tingëllonte më harmonishëm dhe do të kishte një siguri më të mirë. BE-ja dhe SHBA-të, si dy vende laike, sikur janë më afër gjetjes së modulit të mosdublikimit financiar, por akoma ky sistem duhet të plotësohet. Njerëzimi paguan për ndjenjat e tij religjioze. Ai ndërton objekte të kultit, ndërton shkolla religjioze etj. Ai, gjithashtu, bën skulptura ose vepra të ndryshme arti. Të gjitha këto tregojnë për grumbullim parash. Të gjitha këto objekte ngrihen në saje të donacioneve të drejtpërdrejta nga religjiozët, pa ndihmën e buxhetit të shtetit.

Do të ishte më mirë sikur institucionet shtetërore të merreshin me distribuimin e taksave e të mos kishim dublikimin e tyre. Kështu do të kishim një mbikëqyrje më efikase dhe me më pak kokëdhembje nga dy palët. Shpërndarja do të bëhej në mënyrë institucionale, gjë kjo që nënkupton veprim të kënaqshëm dhe legal. Pastaj populli do t'ia linte përgjegjësinë të zgjedhurve të vet në institucionet e tij. Mosdalja në zgjedhje është treguesi më i mirë, i cili po sfidon seriozisht shtetet demokratike.

Vjelja e taksave nga institucionet qeveritare, në njërën anë dhe vjelja e donacioneve nga besimtarët, në anën tjetër, nënkuptojnë dublikimin në qeverisje. Kur një popull ndodhet përpara këtij fenomeni është më pranë një sistemi anarkik, se sa një sistemi që pretendon të jetë i organizuar. Mosarritja e themelimit të një sistemi të organizuar, do të rrezikonte sistemet e shoqërive. "...shteti liberal qëndron para problemit, që qytetarët besimtarë dhe sekularë mund ta fitojnë këtë pikëpamje vetëm në 'proceset komplementare mësimore' nga të cilët është e diskutueshme, nëse bëhet fjalë për procese mësimore dhe, mbi të cilët (mbi të drejtën dhe politikën) ai ashtu-ashtu nuk mund të ketë ndikim."

Ky rrezik do të ishte akoma më i madh sidomos tek ata popuj që në përbërjen e tyre kanë më shumë se një religjion.

Disa qeveri të shteteve në kabinetin e tyre kanë zyrtarë nga ministria e fesë. Disa të tjerë, sa për t'u justifikuar para masës, kanë vetëm 'departamen-



tin' e religjionit, në kuadër të kryeministrit ose ministrit të kulturës. Me të mëtojnë vetëm në vjeljen e taksave nga religjiozët, ndërsa nuk bëjnë asgjë në mënyrë institucionale për ta. Po ashtu, në botë kemi edhe shtete që nuk i përfillojnë fare religjionet, duke i injoruar ato, thuajse janë inekzistente.

Injorimi ose dublikimi i sistemit në disa vende ka mundur lindjen e grupeve religjioze radikale. Rritja e tyre, do të shkaktonte turbulenca, të cilat askush nuk do t'i dëshironte. Përgjegjësia për destabilizim do t'i adresohet hartuesit të makro-politikave kombëtare, të cilët lejuan dublikimin e buxhetit të shtetit. "Grupet fundamentaliste kanë pasur arritje të mira në disa pak zgjedhje, që janë bërë në vendet muslimane dhe do të kishin ardhur në pushtet në shkallë kombëtare në Algjeri, nëse ushtarakët nuk do t'i kishin anuluar zgjedhjet në vitin 1992. Në Indi, gara për mbështetje zgjedhore, pa dyshim, i ka nxitur thirrjet

e bashkësive fetare dhe dhunën e bashkësive fetare." Ndërhyrja ushtarake në Algjeri, në Indi, si dhe në shumë shtete të botës nuk do të ndodhte kurrë, sikur qeveritë e mëhershme të ishin angazhuar në mënyrë aktive dhe sikur t'i kishin hapur dyert e bashkëpunimit ose bashkëqeverisjes.

Në shtetet demokratike votuesit zgjedhin përfaqësuesit e tyre, prandaj do të duhej të bashkëveprohej, ose thënë ndryshe do të duhej të veprohej si një tërësi e vetme, ku nuk do të kishte dallim në përkatësinë e asnjërit individ. "...Në SHBA, të gjitha të dhënat anketuese dëshmojnë se numri i qytetarëve aktivë besimtarë në këto gjashtë dekadat e fundit ka mbetur konstant. Edhe më i rëndësishëm është fakti se e djathta e ditës së sotme në SHBA nuk është një lëvizje tradicionale. Pikërisht ngaqë ajo çliron energji spontane zgjimi, shkakton irritime gjymtuese te kundërshtarët e vet sekularë."

Pyetjet që shtrun dhe vizionin që paraqet z. Habermas në librat e tij "Perëndimi i përçarë" dhe në "Midis natyralizmit dhe religjionit" na bëjnë të hapim debate më të gjera për të mirën e përgjithshme. Ato duhen rishikuar për të dhënë përgjigje konkrete. Ajo që më së shumti bie në sy janë "dobësitë e liberalizimit hegjeonist dhe dizajnimi neoliberal dhe postmarksian."

Ndërsa Samuel Hantingtoni rikthimin e popujve në përfaqësitë e tyre religjioze e përshkruan kështu: "Te ky proces global, indigjenizimi shfaqet gjerësisht në ringjalljen e fesë, që po ndodh në aq shumë pjesë të botës, e sidomos në rilindjen kulturore në vendet aziatike e islamike, të përfutur në një pjesë të madhe nga dinamizmi i tyre ekonomik e demografik." ■



# Me makinë drejt



**Prof.dr. Naser RAMADANI**

**K**undërshtimeve mijëvjeçare mes besimtarëve dhe mosbesimtarëve, shkenca mëton t'u japë fund. Në fakt, e gjithë historia njerëzore përshkohet nga një konflikt i pakompromis, jo vetëm verbal, mes ithtarëve të besimit në Zot dhe atyre që e mohojnë Atë. Një mes i heshtur i gjithë atyre përplasjeve mund të ketë qenë: se debati i tillë ishte objekt i spekulimeve dypalëshe, se rreth kësaj teme sa ka argumente pro, ka po aq edhe kundër. Pra, thjesht, tema mbeti si sferë e mendjes dhe prandaj mori përmasa aq të gjera polemizuese.

'Shkenca' me të cilin deshi të identifikohet materializmi e quante religjionin 'shprehje e mjerimit real', 'opium i popullit', 'psherëtimë e krijesës së shtypur', 'shpirti i botës pa zemër', 'vetëdije e bastarduar mbi botën', 'sendërtim fantastik i qenies njerëzore', 'lumturia iluzore e popullit'. Religjioni nga ana tjetër e sheh botën ateiste si një kopsht zoologjik, ku ata që janë brenda jetojnë vetëm sa për t'i plotësuar qëllimet utilitariste, hedoniste dhe egocentrike. Shkencës iu pa për të madhe që përpiquej të merrej rreth kësaj problematike me prova empirike. S'mund të kërkohet Zoti me teleskop. Racionaliteti shkencor nuk është ana e vetme e arsytimit të së vërtetës. Spektri i të vërtetës është më i gjerë se fakti shkencor. Ajo që për momentin shkencërisht mund të duket irracionale, nuk do të thotë se e tillë është nga të gjitha anët e pikëvështrimit. Shkenca mund t'i verifikojë ose t'i hedhë poshtë vetëm të dhënat empirike, prandaj pohimet religjioze nuk mund të jenë objekte të kritikës epistemologjike. Shkenca nuk mund as të argumentojë, por as edhe të përgënjeshtrojë religjionin. Pikërisht për këtë, filozofi Kant në "Kritikën e mendjes së kulluar" derivon idenë se te Zoti nuk mund të arrihet përmes mendjes për shkak të antinomive që e përshkojnë atë

gjatë rrugëtimit për gjetjen e realitetit. Iu desh "Kritika e mendjes praktike" për të ardhur te Zoti vetëm përmes moralit. Ligji moral na çon drejt besimit, d.m.th se duhen njohur të gjitha detyrat si urdhra të shenjta dhe jo si detyrime. Ato duhen parë nën komandën e një Qenie Supreme, sepse Ajo është e vetmja Qenie që është e përsosur moralisht dhe me një vullnet të plotfuqishëm. Nga Zoti shpresojmë të fitojmë të mirën supreme dhe Ai është një lloj garancie, pa të cilën ideja e domosdoshme e Mbretërisë së Qëllimeve do të ishte logjikisht e pakonceptueshme. Në këtë botë, njerëzit e mirë zakonisht kalojnë keq dhe nëse nuk është besimi në pavdekshmërinë e shpirtit dhe në ekzistencën e Zotit, i Cili në botën tjetër pas ringjalljes do të na dënojë ose do të na shpërblejë në përputhje me veprimet tona, atëherë morali kurrsesi nuk do të ishte i mundshëm, kurse pa moral nuk do të mund të ekzistonte çfarëdo qoftë bashkësie. Ose siç thoshte Dostojevski: "Po të mos ekzistonte Zoti, gjithçka do të ishte e lejueshme".

Kështu bota e ndarë më dysh është konfrontuar se kush demonstroi sa më shumë argumente.


Pa hyrë në detaje të tjera, të cilat janë tejet të shumta, vlen të theksohet se sado afër të jenë shkenca dhe religjioni, ato nuk kanë nise të përbashkëta kërkimore. Pra të tjera janë rrugët e shkencës e të tjera ato të religjionit. Shkenca nuk i plotëson disa nevojat që i plotëson feja. Shkenca mund t'i plotësojë nevojat materiale, por jo edhe ato shpirtërore.

Duhet të thirret në ndihmë feja për të kërkuar zgjidhjen e enigmave të jetës njerëzore. Pra, reflektimi religjioz vjen në pah atëherë kur s'mund të kalohen kufijtë e shkencës. Shkenca nuk mund të hyjë në ato fusha ku hyn religjioni. Vlerat nuk mund t'i studiojë shkenca.

Megjithatë, shkenca nuk ndalet në tendencën për t'u shkuar gjërave deri në fund, pa marrë parasysh se sa mund të jenë të suksesshme përpjekjet e saj. Shkencëtarët, këto ditë, përfunduan provat për vënien në funksionim të të ashtuquajturës "Makina e Big-Beng-ut", qëllimi i së cilës është eksplorimi i mistereve të materies. Kjo makinë duhet të ishte vënë në funksionim një vit më parë, por për shkak të një defekti që zgjati 1 vit, gjithçka u shty për më vonë. Makinaria jashtëzakonisht e shtrenjtë, me një vlerë prej 10 miliardë dollarësh, ndodhet në CERN, një Institut Studimesh Bërthamore në Zvicër. Fizikanët që punojnë në këtë qendër janë çuditur nga mundësia që mund të përfitonin me vënien në punë të makinerisë, rrezet e protoneve të së cilës më pas duhet të arrijnë një shpejtësi të ngjashme me atë të dritës. Makina u dëmtua rëndë nga një defekt elektrik shtatorin e vitit të kaluar. Pas dëmtimit, të gjithë nisën që të riparohet defektet dhe të ecnin hap pas hapi me kujdes për të mos bërë më gabime dhe për të mos krijuar defekte. Para pak ditësh, në makineri ka nisur rrezatimi në tunelin 27 kilometër të gjatë, që ndodhet nën kufirin franko-zviceran. Rivënia në punë e "Makinës së Zotit"



# Zotit



është konsideruar një sukses i madh, pikërisht te magnetet e fuqishme që më pas dolën jashtë përdorimit. Drejtoi i CERN-it, përgjegjës për përshpejtuesit, tha se janë bërë përmirësime shumë të mëdha në makinë gjatë gjithë kësaj periudhe. Nëse do të realizohet përplasja mes grimcave që kanë një shpejtësi të caktuar, atëherë shkencëtarët shpresojnë që të japin disa shpjegime në lidhje me zanafillën e materies. Aparatura operon në temperaturë nën zero, që ndikon në lëvizjen sa më efikase të grimcave. Për këtë projekt kanë bashkëpunuar për vite me radhë mbi 8000 fizikanë nga e gjithë bota. Vetë organizata drejtohet nga 20 vende evropiane që kanë gjithashtu mbështetje nga vende të tjera, përfshirë observatorët në Japoni, Indi, Rusi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dashtë Zoti që kjo makinë ta arrijë cakun e saj, cakun që synojnë shkencëtarët, të cilët e kanë projektuar atë. Urojmë që kjo makinë të jetë e saktë. Mirëpo ne duam të shtrojmë një problem tjetër që nuk ka të bëjë fare me makinën. Problemi i besimit ose mosbesimit qëndron në një makinë organike brenda njeriut, pra, problemi është te zemra e tij. Besimi është çështje zemre, prandaj çfarë do të thoshim për zemrat e vulosura me dry, për të cilat siç thotë Zoti në Kur'an: edhe po të hapeshin dyert në qiell e t'i shihnin argumentet e Zotit qartazi me sy, prapëseprapë do të pranonin ta quanin veten të çmendur, vetëm e vetëm për të mos besuar. Ky është pra problemi, e jo rezultatet që pritet të sjellë makina. ■

(15. XII-2009)



## Alarmi nga Kopenhaga



**Agim AVDIU**

**N**jeriu është duke e rrezikuar vetveten. Me ose pa vetëdije ai është bërë armik i vetvetes. Anekënd botës njeriu, përgjithësisht, punon kundër vetes, herë duke e hetuar, e herë duke mos e hetuar. Prishja e ambientit jetësor, me të gjitha format e mundshme, është akt i shëmtuar që i bëhet jetës në përgjithësi. Me këtë njeriu përgatit gjendje të mjerueshme për jetën e vet.

Në realitet, shkatërrimi i baraspeshës ekologjike nuk mund të kuptohet pa i shikuar pasojat. Qytetërimi njerëzor është shkaktari kryesor i ndryshimit të mjedisit global. Civilizimi po shton gjithnjë e më shumë gazra të serrës në atmosferë. Tragjedi të shumta natyrore po shkaktohen nga ndryshimet klimatike. Në historinë e planetit, ato ndryshojnë herë pas here nga një periudhë në tjetrën, por kjo ka ndodhur më tepër për shkak të prishjes së baraspeshës ekologjike. Pakkush e pranon se ky është një problem jashtëzakonisht i rëndë.

E tashmja dhe perspektiva mund të shikohen më mirë po të hedhim një vështrim në retrospektivë. Duke kujtuar të kaluarën duhet të ndërtojmë vizionin e së ardhmes.

### Çfarë mund të ndodhë?!

Ngrohja globale, tëhollimi i ozonit stratosferik, zhdukja e llojeve të gjalla

të shtazëve dhe bimëve, shpyllëzimi, përdorimi i tepruar i pesticideve, janë shndërruar në rrezik global. Sa më e hollë të jetë shtresa e ozonit, aq më shumë rrezatim ultravjollcë do të godasë sipërfaqen e tokës. Me rrezatimin e shtuar ultravjollcë, dobësohet sistemi i imunitetit të njeriut dhe shtohen gjasat e kancerit të lëkurës. Temperaturat e larta po shkrijnë akujt e Antarktikut e Grenlandës dhe po i ngrohjin oqeanet. Ngrohja e oqeaneve mund të shkaktojë uragane. Me zhdukjen e pyjeve, si pasojë, shirat pakësohen dhe sjellin më pak lagështirë. Ndotja e ujërave mund të shkaktojë kolerë, tifo, dizenteri dhe diarre nga burime virusore e bakteriologjike. Mungesa e të reshurave të shiut ka mundësi t'i shndërrojë tokat e thata në shkretëtirë.

Të mos harrojmë se para gjashtë mijë vjetësh, bagëtia kulloste nëpër tërë sipërfaqen që sot e quajmë Saharë. Mes viteve 1150 dhe 1136 p.e.s shpërtheu vullkani Hekla. Në Islandë hodhi me miliona tonë pluhur dhe substanca në atmosferë. Ngriçat i prishën të mbjellat, kurse shiu binte pa ndërprerë. Arkeologët skocezë kanë ardhur në përfundim se në atë kohë 90 për qind e popullsisë së Skotlandës dhe Anglisë Veriore u zhdukën. Tre muaj, gjatë vitit 2008 p.e.s, yjet nuk u panë. Rreth vitit 209 p.e.s ndodhi një shpërthim i madh. Dy vjet të mbjellat dështuan për arsye që askush nuk i kuptonte. Historiani kinez Han Shu e përshkruante gjendjen se si 'nga uria e madhe vdiqën gjysma e popullsisë. Njerëzit filluan ta hanin njëri-tjetrin. Viti 1816 u konsiderua vit pa verë.



Dështimet e përgjithshme të të mbjellave shkaktuan trazira të urisë në pothuajse çdo vend të Evropës. Në korrik të këtij viti ra borë. Që nga Irlanda, nga Anglia dhe në Baltik, ra shi pa ndërprerë nga muaji maj deri në tetor. Në pranverën e vitit 1815 erupsione jashtëzakonisht të mëdha të vullkanit Tambora, në ishullin e Sumbavas në Indonezi, mbytën dhjetë mijë njerëz dhe 82 mijë të tjerë vdiqën nga uria dhe prej sëmundjeve që pasuan (Të freskët e kemi Cunamin).

Janë shkurt këto të dhëna që lidhen me pasojat që mund të sjellin dukuritë natyrore. E dukuritë natyrore mund të bëhen të tmerrshme po të injorohen dëmet e mëdha ekologjike që po i shkaktohen tokës.

Çfarë duhet bërë me kodrinat e bërllokut?! Të mos sillemi me mbeturinat sipas stilit: 'larg syve larg mendjes'. Një ditë s'do të kemi vend ku të bëjmë deponi për hedhjen e tyre. Djegia krijon mbeturina të tjera që në njëfarë mënyre janë shumë më të këqija.

Ndryshimet e fundit kanë ndodhur si pasojë e ndërhyrjes së njeriut dhe vetëm njeriu duhet të përpiqet që t'i parandalojë shkatërrimet e mëtejshme.

Shumë shkencëtarë thonë se prirja e ngrohjes është shkaktuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor, si përdorimi i makinave, i karburanteve dhe shpyllëzimet.

Sasia e dyoksidit të karbonit CO<sub>2</sub> dhe e klorofluorokarbonit (CFC) po rritet me shpejtësi, gjë që po shkakton rritjen e temperaturave - ngrohjen globale.

Ndryshimi i temperaturave nuk është ndonjë gjë e rrallë. Ky dhjetëvjeçar


ka shumë të ngjarë të konsiderohet më i nxehti që kur ka filluar regjistrimi i temperaturave në vitin 1850. Për sa i përket vitit 2009, ai mund të renditet ndër më të nxehtit. Ky është raporti i Agjencisë së Motit të Organizatës së OKB-së, i publikuar në ditën e dytë të konferencës për klimën në Kopenhagë. Vetëm Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja kanë përjetuar një mot më të ftohtë se zakonisht, ndërsa korriku i këtij viti ka regjistruar temperaturat më të larta. Në Afrikën Qendrore dhe në Azi, viti që po lëmë konsiderohet më i nxehti. Valë të jashtëzakonshme të të nxehtit kanë pasur edhe India në maj dhe Kina në qershor. Mot të nxehtë ka pasur në përgjithësi e gjithë Azia Jugore. Dhjetëvjeçari që kemi kaluar do të jetë më i nxehti në të gjithë historinë e regjistrimeve të temperaturave, duke kaluar madje edhe vitet '80 dhe '90. Ai ka qenë një dhjetëvjeçar i prekur në mënyrë dramatike nga ndryshime klimatike të jashtëzakonshme. Vera e vitit 2007-2008 ka shkrirë në mënyrë të ndjeshme akujt e Oqeanit Arktik dhe shkencëtarët vunë re se Antarktida po ngrohej shumë më tepër nga sa besohej më parë. Ndërkaq thujse të gjithë akujt në botë kanë pësuar ndryshim nga temperaturat e ulëta. Për sa i përket dhjetëvjeçarit, viti i tij më i nxehtë është 2003. Vite shumë të nxehtë në dhjetëvjeçarë të tjerë janë 2005, 1998, 2007 dhe 2006.

Në Kopenhagë, pjesëmarrësit kanë diskutuar për çështjet teknike, ndërsa një pjesë kanë punuar për pikat e projektit përfundimtar. Në ditët e fundit morën pjesë edhe dhjetë liderët

botërorë, ndër të cilët edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barak Obama. Ai mbështeti përpjekjet për luftën kundër ndryshimeve klimatike, të cilën ai e ka shndërruar në një nga pikat kryesore të agjendës presidenciale, ndryshe nga paraardhësi i tij, Bush, i cili ishte tërësisht indiferent dhe mospjesëmarrës. Megjithatë, negociatorët mendojnë se Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë më tepër, veçanërisht për sa i përket përqindjes së uljes së emetimit të dyoksidit të karbonit, që deri tani është në masën 17%. Konferenca Ndërkombëtare në Kopenhagë për klimën po përpiqet t'u kujtojë njerëzve se ngrohja globale është tashmë një realitet dhe po bën thirrje për të arritur një marrëveshje të qëndrueshme dhe të zbatueshme gjatë ditëve në vazhdim. Problemi i ngrohjes së shpejtë të planetit është në vëmendjen e konferencës. Michel Jarraud, drejtues i Organizatës Meteorologjike Botërore, tha se këtë vit shumica e zonave në botë kanë qenë mbi temperaturat normale.

Synimi i konferencës ishte të gjente një zgjidhje për të shkurtuar emetimin e gazeve që shkaktojnë efektin serë, të nxiste teknologjitë e gjelbra dhe rritjen ekonomike dhe të ndihmonte vendet më pak të zhvilluara që të përshtaten me kushtet e reja. Shkencëtarët thonë se shkurtimi i emetimit të dyoksidit të karbonit me 25 deri 40 për qind është i domosdoshëm për të kontrolluar ngrohjen globale. Bashkimi Evropian, Kina dhe India kanë bërë premtime. Shtetet e Bashkuara po presin një miratim nga kongresi për shkurtimin prej 17 për qind të propozuar nga presidenti Obama.

Të gjitha masat e ndërmarra mendohet të krijojnë kushte më të mira për përmirësimin e ambientit në përgjithësi. Vetëm me një mobilizim të përgjithshëm mund të priten rezultatet e dëshiruara, për një mjedis sa më të përshtatshëm jetësor. ■



Kritikë letrare

# Arkifigura në figurë personale

Leximi i këtillë mundëson përafrimin e arkifigurës në figurë personale me një vetmi gjakuëse. Kështu, përafrimi i figurave harmonizohet gjatë idesë autoriale



Flamur MALOKU

**P**oema "Eskursioni Teologjik i Sokratit" e Lasgush Poradecit, shkruar më 1978, ngre në vete një transmodelim të arkifigurës në figurë personale. Pra, figura e antikitetit, transmodelohet si në gjenezën e figurës, ashtu edhe në planin ideor. Figura e antikitetit i mbarështrrohet esencës së kodit tematik, e kodit figurativ-ideor. Sokrati bëhet në shtresën e poemës Sokrati i tekstit letrar-figurë personale, duke simbolizuar të tashmen. E gjithë kjo kuptohet pasi teksti të lexohet përmes alegorisë, çka kërkon një lexim të tillë. Leximi i këtillë mundëson përafrimin e arkifigurës në figurë personale me një vetmi gjakuëse. Kështu, përafrimi i figurave harmonizohet gjatë idesë autoriale. Mirëpo, ky identifikim vjen e zmadhohet, duke krijuar edhe dhembjen-vetminë. Madje, shumë kritikë këtë poemë e quajnë edhe tekst të vetmisë lasgushiane. Vetmia personale shënjohehet përmes Sokratit, me një vuajtje të rëndë shpirtërore, që lind si rezultat i sistemit të atëhershëm komunist. Ky sistem shprehet përmes figurave tekstore si: kryeprihti, kryepushtetari, etj. Kurse, vuajtja personale shprehet përmes Sokratit, pra, më konkretisht arkifigura pasqyron situatën reale të kohës. Sistemi-rendi ekzistues përmban në vete mashtrimin. Ky mashtrim është krijuar nga njerëzit e pushtetit. Mashtrimi është shumë konotativ në strukturën e poemës. Andaj, Sokrati e kupton mashtrimin dhe e rigjurmon këtë shkëlqje të kodit

moral nga ana e pushtetarëve. Figurat e pushtetarëve, në esencë shënjojnë një botë të mbushur me iluzione, siç shihet edhe në vargjet e mëposhtme, ku Sokrati dialogon me priftin:

*Kur imagjinon ti ferrin;*

*A ka ferr për nënë dhete?*

*Kur imagjinon lugin*

*A ka luginat më të vërtetë?*

*II*

*Nuk ka zeus*

*Ferr luginat t'imagjinuar*

*Po ka popull të paditur*

*Popull qënde sështë zgjuar*

Nga vargjet e fundit, faji i hidhet popullit, sepse këta besojnë në mashtrimin e shitur nga pushtetarët, pra besojnë në idenë e sistemit, sepse padituria e popullit është në kulminacion. Zgjidhimi i vetëdijes kërkohehet nga arkifigura (Sokrati) antike si diçka e domosdoshme, për një rrugëdalje nga ky realitet i rremë shoqëror. Lasgushi kërkon që ky rend të ngrihet në shkallë diskutimi nga vetë populli, pasi vetëm populli mund ta rrëzojë një sistem grabitës-mashtrues. Prandaj, shenjzimi i këtij realiteti është thelbi i idesë së tekstit, ku figura e Sokratit i përshtatet kësaj ideje, andaj figura bëhet shpallje para së gjithash, e brendisë personale përballë një rendi absurd mashtrues. ■



## Poezi

Aziz MUSTAFA



Liria sërish klonohet

Hapa motakësh qesim  
Rrëzohemi apo mbesim vertikal  
Kush drej e di  
Trutë na nxeh ngrohja globale  
Tym qesim  
Shkumojmë përjargemi  
Hedhim shkëlma grushte  
Pak borë dhe një motiv dimri  
Na mungon  
Na mungon vetja  
Rryma, uji, dashuria  
Një simetri dielli  
Sa e gjatë kjo listë mungesash  
Liria sërish klonohet  
Si hija jonë bëhet lavirja  
Për një hap motaku na ik  
Nuk e zëmë që nuk e zëmë  
Në fund në shtëpi kthehemi  
Të thyer  
Se nuk kemi ku vemi

### Perandoria jote e vetmisë

(M.B.)

Mbi tavolinën time  
Shtrij perandorinë tënde të vetmisë  
Erëra fragrance shushurijnë  
Si i bëhet të ftohtit të zemrës  
Kur është ora 11 e jetës  
Pështymën përpjij në vend të kafes  
Duart me ylber m'i lidhë  
Në palcë ndiej mungesën tënde  
Si palën e 13 të brinjëve  
Ndjej at-dheun e përgjysmuar  
Si tkurret si lëkura ime  
Që sonte nuk më zë  
Ku është gjithë ajo dashuri e frymës  
Përziej dritë me vetmi  
Hidh një gur në erë  
Dhe qesh me yjet

Ti po vjen e madhërishe  
Si perandoria jote...

# Muzika shqipe – ‘fole’ e antivlerave kulturore



**Astrit VELIQI**

Sot e dimë muzika, ose më mirë të themi arti muzikor, përfaqëson një sferë mjaft të rëndësishme në prezantimin e vlerave kulturore të ne.

Këto vlera artistike artikulojnë një frymë autentike shumë të pasur nacionale, por, megjithatë, marrë në përgjithësi, ato në shumë raste edhe konstruktohen fiktive, jo burimore e të vjedhura.

Por ajo që në shikim të parë duket interesante në këtë mish- mash kulturor është prezantimi i kësaj sfere në mediat e shkruara, e në veçanti ato elektronike, ku në këto të fundit shfaqen rrymat dhe zhanret më moderne të artit muzikor si rok, arenbi, rep, popullore, të lehta, blues-jazz etj.

## Arti muzikor – rob i kopjimeve

Është e natyrshme të thuhet se ngjyrat muzikore, por edhe zërat, janë nga më të ndryshmet ngase janë individuale. Mirëpo edhe pse muzika dhe karriera muzikore në realitet duket e vështirë, megjithatë suksesi në këtë botë arti, si në aspektin e ‘karrierës’, por edhe në atë që nënkuptohet si sukses material, duket se është brilant.

Kështu që brumi që servojnë artistët këngëtarë të estradës sonë të shpirti i publikut të gjerë është nga më i llojllojshmi: si shfaqje skenike, ritëm muzikor, aksenti vokal, performanca artistike etj.

Edhe pse shfaqjet e tyre skenike në skenë, por edhe në spotet televizive muzikore, si të themi performojnë imazhet më bashkëkohore dhe më profesionale të punës së tyre, në shumë raste duke u bërë ‘rob’ i imitimeve e kopjimeve të ndryshme, cilësia e tyre, sikurse origjinaliteti, konsumohet i rremë dhe fals.

Andaj, duke ecur gjithnjë në këtë qasje kemi parasysh shumë elemente që pa dashur edhe shkojnë në dëm të vlerave muzikore shqipe në veçanti.

Sot, siç e dimë, jetojmë në shekullin e internetit dhe teknologjisë informative – digjitale, ku mundësia për të improvizuar tekste e zëra të ndryshme muzikore është e jashtëzakonshme.

Jemi dëshmitarë të botës sonë, të cilën pothuaj e përjetojmë çdo ditë, ku kemi raste të shohim shumë artistë këngëtarë, të mëdhenj e të vegjël, si për nga nami i tyre që kanë në shoqërinë tonë por edhe për nga ambiciet profesionale që ata paraqesin, ku sharmi por edhe imazhi që ata paraqesin në botën e muzikës herë-herë të bën të mendosh se civilizimi i tejkalon teket e ekstremitetit muzikor e artistik.

Këngëtarët, por edhe artistët tanë, po mbijnë këto kohë si të themi ‘si kërpudhat pas shiut’, por e keqja më e madhe është se niveli i tyre vokal e profesional artistik, në të shumtën e herëve, po prezantohet i dobët dhe jo origjinal.



Joprofesionalizmi i tyre bën që në muzikën tonë shqipe, në të shumtën e rasteve, të kultivohen as më pak e as më shumë se ‘shundi e kiçi’.

Mbi këtë bazë, si dëshmi të artë të botës muzikore kemi ndikimin e shumë faktorëve që për nga natyra edhe imponohen me dy fytyra, si këngëtarët joprofesionalë, këngët e vjedhura, muzika play-back, tal-lava, pirateria e madhe, lakuriqësia ekstreme në skenë, tekstet banale e pa mesazh poetik, shkelja e të drejtës autoriale, e shumë të tjera. Të gjitha këto bëjnë që sfera muzikore të ne, edhe për shumë kohë, të mbetet në një pozitë shumë të shëmtuar, për të mos thënë denigruese karshi qytetarit dhe familjes kosovare.

Këto fakte i bëjnë më të qëndrueshme

edhe shumë zëra që po qarkullojnë tash e sa kohë se vlerat muzikore gjithnjë e ma shumë po përmbysen nga antivlerat kulturore.

Kjo gjë e shëmtuar është duke shoqëruar jo vetëm botën e muzikës por edhe sferat e tjera shpirtërore e kulturore që kanë të bëjnë me librin, filmin, pikturën dhe sferat e tjera kulturore.

Këtë denigrim dhe joprofesionalizëm muzikor janë duke e shtyrë gjithnjë e më shumë edhe mediat tona televizive, që në mungesë të një selektimi profesional të redaksive muzikore i japin rast emetimit të çdo lloji kënge dhe këngëtari joorigjinal e joprofesional.

Megjithatë, edhe artistët tanë këngëtarë nuk e kanë të lehtë të ofrojnë këngë e spote të mirëfillta e profesionale, ngase është e natyrshme që një brumë i shëndoshë artistik, sikurse edhe spoti profesional e origjinal, kërkon angazhim, kohë por edhe investim marramendës.

## Vlerat muzikore – sinonimi ynë në botën e civilizuar

Si do që të jetë, duhet të jemi të vetëdijshëm për një fakt konkret se vlerat muzikore, janë sinonim i mirëfilltë i prezantimit dhe performancës kulturore edhe në botën e civilizuar. Prandaj, në këtë sferë, mendoj se ndihmat dhe stimulimet institucionale të kulturës dhe artit nuk duhet të mungojnë, ngase mjafton një impuls sado i vogël për të ndryshuar diç më shumë në këtë rrugëtim artistik.

Ndërkohë, duke ofruar dhe prezantuar art të mirëfilltë muzikor në botën përëndimore ne, vetvetiu, ndërtojmë një imazh origjinal e nacional artistik.

Por është shumë e rëndësishme të theksohet se me këto vlera artistike të ‘brishta’, ne nuk mund të jemi origjinalë, e as profesionalë, në sytë e qytetarëve, e aq më pak para botës së qytetëruar.

Nuk thuhet kot se shpirti i një artisti është zëri – kënga e tij, andaj zëri dhe jehona e tij, duhet të mbetet botë që shpërthen me ngjyrë të fuqishme artistike e origjinale.

E ardhmja është treguesi më i mirë për të parë pasqyrën e estradës sonë muzikore. ■

# Paradokset e kohës sonë

\* Në ditët e sotme, kemi shtëpi më të mëdha, e familje më të vogla; kemi më shumë komoditet, e më pak kohë.

\* Kemi më shumë diploma, por më pak mendim praktik; kemi më shumë njohuri, e më pak urtësi.

\* Kemi më shumë ekspertë, e më shumë probleme; kemi më shumë ilaçe, por më pak shëndet.

\* Ne shpenzojmë pa u matur, qeshim shumë pak, ngasim shumë shpejt, zemërohemi shpejt, rrimë natën tepër vonë, zgjohemi të stërlodhur, lexojmë shumë pak, shikojmë shumë televizor, e falemi mjaft rrallë.

\* I kemi shumëfishuar pronat tona, por në anën tjetër i kemi pakësuar vlerat tona; ne flasim shumë, duam pak, e gënjejmë mjaft shpesh.

\* Kemi mësuar si ta fitojmë furnizimin, por jo edhe si të jetojmë; i kemi shtuar vite të tëra jetës sonë, por nuk ua shtuam jetën viteve të moshës sonë.

\* Kemi ndërtesa më të larta, por karaktere të vrazhda; kemi autostrada më të gjera, por pikëpamje më të ngushta.

\* Ne shpenzojmë më shumë, por posedojmë më pak; blejmë më shumë, e kënaqemi më pak;

\* Arritëm deri në hënë dhe u kthy-

em, mirëpo shqetësohemi nga kalimi i rrugës për ta takuar një fqinj të ri;

\* Ngadhënjem mbi hapësirën e jashtme, por jo edhe mbi veten tonë; e zbërthjem atomin, por nuk i mposhtëm dot paragjykimet tona.

\* Ne shkruajmë shumë, por mësojmë pak; planifikojmë shumë, e realizojmë pak.

\* Kemi mësuar të shpejtojmë, por jo edhe të presim; kemi të ardhura më të larta, e sjellje më të ulëta.

\* Ne prodhojmë më shumë kompjuterë për të ruajtur më shumë informata e të dhëna dhe për të nxjerrë më shumë kopje, mirëpo kemi më pak komunikim ndërmjet nesh; kemi tepriçë në kuantitet, e pakicë – në kualitet.

\* Këto janë kohërat e ushqimeve të shpejta dhe tretjes së ngadalshme; njerëz të gjatë, e personalitete të shkurtra; fitime të mëdha, e lidhje të cekëta.

\* Kemi mjaft kohë të lirë, por pak argëtim; kemi lloje të shumta të ushqimeve, por të ushqyerit e paktë; kemi të ardhura të larta, e shkurorëzim edhe më të lartë; kemi shtëpi luksoze, e familje të rrënuara.

\* Prandaj, unë propozoj që, duke filluar nga dita e sotme, të mos ruash asgjë për ndonjë rast të veçantë, ngase secila ditë që e jeton paraqet rast të veçantë.

\* Kërkoje njohurinë, lexo më shumë, qëndro pranë ballkonit të përparmë të shtëpisë sate dhe kënaqu me panoramën, duke mos çarë kokën për nevojat që i ke.

\* Kalo më shumë kohë me familjen tënde dhe me shokët e tu, përdori ushqimet, të cilat i preferon dhe vizitoji vendet të cilat i pëlqen.

\* Jeta është një varg çastesh të këndshme, e jo thjesht për të mbijetuar.

\* Përdori gotat e tua të kristalit; mos e kurse parfumin tënd të preferuar dhe përdore atë në çdo kohë kur ndien dëshirën për ta përdorur.

\* Shlyeji nga fjalori yt shprehjet e frazat, si: “në një nga këto ditë” dhe “në një të ardhme”; le ta shkruajmë atë letër për shkrimin e së cilës menduam më parë “në një nga këto ditë”.

\* Le t'i njoftojmë familjet dhe shokët tanë se sa i duam ata; mos e vono asgjë që e nxit qeshjen dhe gëzimin në jetën tënde.

\* Çdo ditë, çdo orë dhe çdo minutë paraqet një gjë të veçantë; e ti nuk e di se cila prej tyre do të jetë e fundit në jetën tënde.

Nga arabishtja:  
**Jahja Hondozi**



Në Kosovë u shënu Dita Botërore kundër HIV/AIDS-it

# Me plan kundër AIDS-it

Ministria Shëndetësisë, në bashkëpunim me Ekipin e Agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ka publikuar Planin Strategjik për HIV/AIDS 2009-2013. Sipas këtij plani, numri i rasteve me HIV/AIDS në Republikën e Kosovës është shumë më i ulët sesa ai në vendet e tjera



**Fatos SHALA**

**Q**ë nga paraqitja e sëmundjes në vitin 1986, në Kosovë janë regjistruar 79 raste me HIV pozitiv. Sipas mjekëve, të infektuarit në Kosovë, përveç sëmundjes, gjatë vitit janë përballur edhe me mungesë permanente të barnave. Mirëpo Kosova ka një shkallë shumë më të ulët të infeksionit nga sëmundja vrastare e HIV/AIDS në krahasim me vendet e rajonit dhe botës. Kjo është thënë me rastin e shënimit të Ditës Botërore të AIDS-it, me ç'rast Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Ekipin e Agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ka publikuar Planin Strategjik për HIV/AIDS 2009-2013. Sipas këtij plani, numri i rasteve me HIV/AIDS në Republikën e Kosovës është shumë më i ulët sesa ai në vendet e tjera.

## Përkushtimi për parandalimin e sëmundjes

Ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi, ka thënë se bashkëpunimi shumë i mirë mes ekspertëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë ka qenë një kontribut i veçantë në finalizimin e dokumentit që paraqet udhërrëfyes të efektshëm për qasje universale në parandalimin, trajtimin dhe kujdesin për sëmundjen e HIV/AIDS-it.

Sipas Gashit, dokumenti do të shërbejë për kontributin e vazhdueshëm të niveleve më të larta shtetërore, për tërheqje dhe mbajtje të fondeve të Qeverisë së Kosovës, si dhe donatorëve sa i përket kësaj sëmundje. Po ashtu, sipas tij, rol të veçantë luan edhe shoqëria civile dhe komuniteti për bashkërenditjen e mbështetjes ndërkombëtare, si dhe për t'u përgjigjur kësaj epidemie vrastare.

“Fatmirësisht në vendin tonë numri i të prekurve me HIV nuk është i madh, por janë shumë faktorë që këtë gjendje mund të ndryshojnë për të keq, për një kohë shumë të shkurtër, andaj është edhe përkushtimi institucional që me kohë të ndërmerren të gjitha masat për parandalimin, si dhe për angazhimin, vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin për rrezikun real dhe për mundësitë reale për parandalimin e HIV/AIDS-it”, - ka thënë Gashi.

Ai ka shtuar më tej se Kosova ka një popullatë të re dhe përkushtimi i ministrisë është që të bëhet krejt çka është e mundur që të mbetet e shëndoshë. Ministria i kushton një kujdes të veçantë respektimit të të drejtave njerëzore dhe evitimit, me çdo kusht, të diskriminimit të cilësdo formë të shoqërisë në Kosovë.

## Mungojnë barnat për HIV/AIDS-in

Illir Tolaj, shef i repartit për HIV/AIDS në Klinikën Infektive në QKUK, me rastin e shënimit të ditës botërore të AIDS-it, ka theksuar se kategoria e pacientëve nga kjo sëmundje, gjatë këtij viti, është përballuar me probleme të shumta.

Ai ka pohuar se, pas shumë muaj mungese, në repart ka barna antiretrovirale të linjës së parë, mirëpo ky repart, sipas tij, akoma ndien mungesën e barnave të linjës së dytë.

“Ne jemi në mungesë të barnave alternative antiretrovirale dhe ato të linjës së dytë. Për këtë shkak dy pacientë, një i rritur dhe një fëmijë, nuk janë duke u trajtuar, përkundër faktit se kjo është më se e domosdoshme. Prindërit e fëmijës dyvjeçar janë duke bërë përpjekje të mëdha që këtë terapi ta sigurojnë nga vendet fqinje” - ka thënë Tolaj.

Ai ka shtuar se duke marrë parasysh gjendjen e rëndë të pacientëve me HIV/AIDS, Ministria e Shëndetësisë duhet ta këtë një qasje më serioze dhe më profesionale në sigurimin e barnave, për pacientët e kësaj kategorie. Sipas Tolajt,

në Kosovë që nga viti 1986 e deri sot janë të regjistruar gjithsej 79 raste me HIV/AIDS.

Tolaj pohon se numri i të infektuarve është e mundur të jetë edhe më i madh, meqë ky lloj infeksioni karakterizohet me një periudhë të gjatë nga momenti i infeksionit e deri te shfaqja e shenjave të sëmundjes, mesatarisht 10-15 vjet. Ai ka thënë se, në klinikë aktualisht gjendet një person duke u trajtuar me HIV/AIDS.

“Ky është pacienti tek i cili është zhvilluar rezistenca në të tre antiretrovirale, që deri para disa muajsh ka qenë duke u trajtuar. Si pasojë e ndërprerjes së terapisë, tek ai është zhvilluar tuberkuloz i sistemit nervor”, - ka deklaruar Tolaj dhe ka shtuar se, përkundër kërkesave të përsëritura për më shumë se gjashtë muaj, ministria ende nuk ka siguruar terapi adekuate ndaj këtij pacienti, terapi e cila edhe mbetet shpëtimi i vetëm për të.

## Pacientët presin terapinë për shpëtim!

Ndryshe, në trajtim me antiretrovirale, sipas Tolajt, janë edhe 8 pacientë, të cilët në klinikë vijnë kohë pas kohe për konsulta dhe për çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre, sikundër edhe 6 të tjerë që janë në mbikëqyrje të repartit dhe janë në pritje të fillimit të trajtimit. “Për të infektuarit duhet siguruar trajtim i vazhdueshëm me antiretrovirale, ndërsa pranimi i tyre në shoqëri duhet të jetë i dinjitetshëm. Kjo është edhe porosia e OBSH-së për këtë vit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të HIV/AIDS-it” - ka deklaruar Tolaj.

## Plani strategjik për një shoqëri evropiane

Gjithashtu, edhe Osnat Lubrani, koordinatore e agjencive të Kombeve të Bashkuara, ka theksuar se plani strategjik për HIV/AIDS-in paraqet një hap më tutje në rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit evropian si një shoqëri e shën-

doshë evropiane. Ndërsa, Doina Bologna, kryesuese e ekipit për AIDS në Kombet e Bashkuara, ka thënë se plani strategjik për HIV-AIDS-in për Kosovën ka qenë një sukses i madh, i cili do të ndihmonte Kosovën për përgjigje më të mirë ndaj HIV-AIDS-it si dhe i ka ftuar të gjithë së

bashku të arrijnë një solidaritet në manifestimin e goditjes së kësaj sëmundjeje.

### Pak raste me HIV/AIDS

Prezantimi i Planit Strategjik të Kosovës për HIV-AIDS-in 2009-2013, flet se deri më tani numri i të infektuarve

në Kosovë, në krahasim me vendet e tjera, ka qenë shumë i ulët. Në bazë të dhënave që ka Kosova, ne bëjmë pjesë në grupin e shteteve me prevalencë të ulët ose me numër të vogël të rasteve me HIV-AIDS", - ka thënë infektologu Izet Sadiku. ■

## Vaksina – imunizim aktiv artificial

Imuniteti është term që përkufizon forcën mbrojtëse biologjike të organizmit për të shmangur një infektion, sëmundje ose ndonjë invazion tjetër biologjik

**Iliriana ALLOQI & Bernard TAHIRBEGOLLI**

**K**oncepti i imunitetit i ka intriguar mendjet njerëzore me mijëra vite. Në shikimin parahistorik të sëmundjes mendohej se ajo shkaktohej nga forca mbinatyrore dhe sëmundja është një lloj i dënimi për "të bëmat e këqija" ose "mendimet imorale".

Termi modern "imunitet" rrjedh nga termi Latin *immunis* që do të thotë shmangie-përrjashtim prej shërbimit ushtarak, pagesa e taksave, ose e shërbimeve të tjera publike.

Përshkrimi i parë klinik i imunitetit, që vjen nga një sëmundje specifike e organizmit, është bërë nga mjeku musliman El Razi në shekullin e IX-të (nëntë) në librin "Libri për linë dhe fruthin", ku autori përshkruan pasqyrën klinike të lisë dhe fruthit dhe tregon se ekspozimi ndaj tyre rezultojnë me uljen e imunitetit. Mirëpo shkenca e imunologjisë filloi të zhvillohet me Luis Paster-in dhe teorinë e grimcave ku tregohet se si bakteret shkaktojnë sëmundje dhe se si gjatë asaj sëmundje trupit njerëzor fiton aftësi për t'u rezistuar sulmeve të tjera të atij infeksioni.

Termi 'vaksinim' është marrë nga gjuha latine. Termi 'vaksinë' u përdor për herë të parë nga Edward Jener-i, në vitin 1796, duke ju referuar preparatit nga lia e lopëve (latin *vac-cin-us*, nga *vacca* lopë) që kur jepej te njerëzit i pajiste ata me një "forcë" mbrojtëse kundër lisë. Në Evropë, imunizimi aktiv filloi me sëmundjen e lisë. Megjithatë imunizimi në

një formë a tjetrën ka ekzistuar qysh para mijëra viteve. Imunizimi më i hershëm mendohet të jetë bërë nga kinezët, para tre mijë viteve në Kinë, ku materiale-copëza nga plagët e shkaktuara nga lia janë tharë dhe më pastaj janë inhuar te njerëzit për të fituar imunitet. Në ditët e sotme termet "vaksinim" dhe "imunizim" përdoren si sinonime të një procedure, përmes së cilës stimulohet ngritja e imunitetit ndaj diçkaje.

Për mbrojtjen complete dhe të qëndrueshme të fëmijës është e nevojshme të jepet një numër i ndryshëm i dozave të vaksinave, në intervale kohore të caktuara dhe në moshë të ndryshme të fëmijës. Për këtë qëllim ekziston kalendari i vaksinimit. Me dhënien e vaksinave, përveç fëmijëve, ne i mbrojmë edhe gjeneratat e ardhshme. Shumë sëmundje tani, në saje të vaksinimit, janë zhdukur dhe kanë mbetur të shënuara vetëm në histori, e ndër to edhe lia me të cilën ka filluar vaksinimi i parë.

### Mënyrat e marrjes së vaksinës

Vaksinat mund të merren përmes gojës, me injektim (intramuskular, intra-

dermal, subkutan), me punktimit, transdermal dhe përmes inhalimit (si sprejë).

### Llojet e vaksinave


Ekzistojnë katër lloje themelore të vaksinave dhe ato janë:

- Vaksina e inaktivizuar që përbëhet nga mikroorganizma të mbytur me kimikalie dhe nuk janë më aktive,
- Vaksinat e gjalla përbëhen nga mikroorganizmat e kultivuar, të cilëve iu është zhdukur mundësia për të shkaktuar sëmundje,
- Toksinet janë komponentë të inaktivizuar toksikë të kompozuar nga mikroorganizmat,
- Vaksina me subnjësi, e komponuar nga disa fragmente të shkaktarit të sëmundjes.

### Si funksionon një vaksinë?

Një vaksinë funksionon në këtë mënyrë: injektohet ose jepet virusi në organizëm, në atë mënyrë që organizmi të krijojë antitropa. Me këtë rast, qelizat reaguese ndaj këtij virusi prodhojnë një seri me qeliza memorizuese, të cilat do të mbajnë "në mend" për një kohë të gjatë strukturën e atij agjentit të jashtëm dhe në rast se bie prapë në kontakt me atë, atëherë do të reagojnë në mënyrë "të matur" e sistematike. Virusit që përmban vaksina nuk është virus normal, por një virus i dobësuar që mund të shkaktojë simptoma që ngjasojnë me sëmundjen, por në një formë të butë. Prandaj nuk është jonormale as e rrezikshme që personat të cilët e marrin vaksinën, të jenë pak të sëmurë në ditët e para pas vaksinimit.





## Efektet anësore të vaksinës

Efekte serioze e të padëshirueshme nga vakcina janë shumë të rralla. Më shpesh, këto efekte anësore o ndërlikime i japin vaksinat e gjalla, sidomos ato virale, por disa herë edhe ato të inaktivizuara. Skuqjet dhe dhembjet në vendin e injektimit të vaksinës janë të zakonshme dhe të pritura. Këtë shenjë e kanë rreth gjysma e të vaksinuarve. Organizmi, krahas përgjigjes ndaj vaksinës, për të krijuar mbrojtje disa herë përgjigjet me dukuri jo normale e të pazakonta edhe kur aplikohet në kushte normale, pra, edhe kur vakcina është mbajtur dhe ruajtur në kushte normale (siç quhet ndryshe “zinxhiri i ftohjes”). Ndonjëherë, shfaqja e këtyre ndërlikimeve është dhe cilësi ose veti e brendshme e vetë vaksinës. Në përgjithësi, ndërlikimet postvaksinale kur bëhen në fëmijë të shëndoshë e në kushte ideale, kanë rrjedhim të mirë e janë të parrezikshme për të rivendosur gjendje sadopak të alternuara, pa nevojën e ndërhyrjes mjekësore. Ndër ndërlikimet postvaksinale që prekin disa organe, dhe që quhen t e

përgjithshme, mund të jenë: ngritja e temperaturës në shifra të larta për disa ditë, dobësi e theksuar, dhimbje trupi a koke, si dhe të vjella. Mund të manifestohen dhe fenomene alergjike nga më të thjeshtat (urtikarie) deri te shoku anafilaktik.

## A mund të bëhet parandalimi i ndërlikimeve?

Gjithsesi. Para se të bëhet vaksinimi duhet të vlerësohet gjendja e përgjithshme e personit që do të vaksinohet. Nëse fëmija është mirë, lejohet vaksinimi. Në të kundërtën, shtyhet ose nuk bëhet për një farë kohe. E rëndësishme për parandalimin është respektimi i të gjitha rregullave të prodhimit të vaksinës, mirëmbajtjes së saj, transportimi e deri në aplikimin e saj.

## Në rast se shfaqen ndërlikime?

Në këtë rast duhet kërkuar ndihma e mjekut specialist. Nëse ndodhin brenda konsultores ose ambulancës, mundësitë për mjekim janë më të shpejta dhe efikase. Në të kundërtën, familjarët duhet të lajmërojnë sa më shpejt mjekun ose personelin mjekësor përkatës. Gjithsesi duhet të dihet se në rastet e dhimbjes lokale ose të përgjithshme duhen dhënë analgjetikë, kryesisht me rrugë orale (në formë shurupi ose tableta) me rekoman-



Duhet të dini se mjeku vendos për të gjitha rastet e shtyrjes së afatit të vaksinimit ose të mosdhënies fare, në disa raste edhe duke u konsultuar më parë me epidemiologun, infektologun dhe alergologun, e në asnjë mënyrë me prindin.

dimin e mjekut për një ose disa ditë. Nëse vendi i vaksinës skuqet, duhen vendosur kompresa të ftohta ose me amoniak. Nuk duhet ngacmuar në asnjë mënyrë, kurse nëse infektohet duhet të shkohet te mjeku. Në format më të rënda, personi mund të shtrohet në spital për mjekim. Po kështu edhe në rastin e konvulsioneve të pjesshme ose të përgjithshme.

Para se ta vaksinoni fëmijën tuaj njoftoni mjekun:

- Për temperaturën e lartë për një kohë të gjatë ose edhe për kohën që duhet bërë vakcina ose rivaksinimi,
- Sëmundjet akute dhe periudhën e inkubacionit të këtyre të fundit,
- Për sëmundjet e rënda kronike,
- Për përdorimin për një kohë gjatë të kortizonikëve, citostatikëve dhe rrezeve radioaktive, të cilat e ulin procesin imunitar,
- Gjendjet alergjike akute, ndonjëherë edhe të kaluara më parë.

Në këto raste jo vetëm që vakcina nuk krijojnë maksimumin e mbrojtjes, por ajo mund të përkeqësojë gjendjen. Është me rëndësi që fëmijët të vaksinohen në kohën e duhur gjatë 18 muajve të parë të jetës, pasi që kjo është periudha kur fëmijët ndodhen në rrezikun më të madh për t'u sëmurë nga shumë sëmundje të rënda, duke mos nënvlerësuar edhe pjesën tjetër të kalendarit të vaksinimit. Ndonjëherë prindërit harrojnë kohën e vaksinimit dhe kështu fëmija ngel pa vaksinuar. Janë duke u bërë përpjekje të mëdha që të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë kartelat e tyre shëndetësore në shtëpitë e shëndetit dhe prej atje të kontrollohet kalendari i vaksinimit dhe t'u përkujtohet me kohë prindërve periudha e vaksinimit. ■





Iljasa SALIHU

# Sporti dhe i dituri

**N**jeriu si banor i përkohshëm i këtij nënqielli, për sendërtimin e personalitetit të shumanshëm dhe begatimin e intelektit të tij, ka qenë e është i prirë dhe i detyruar t'i përdorë të gjitha rrugët, me të vetmin qëllim tejet të pastër, e ky synim mjaft fisnik ka të bëjë me finalizimin e tërë asaj çka quhet shëndet dhe sukses. Shpeshherë, për këto dy dukuri është studiuar dhe folur si për dy koncepte dhe profesione në vete, duke harruar ose dashur të harrohet qëllimisht që të trajtohen në një vijë të përbashkët. Për ta shpjeguar dhe qartësuar më mirë njësimin e këtyre koncepteve, fillimisht ne pyesim: Vallë, a është i mundur fluturimi i shpezëve vetëm me njërin krah? Pa dyshim se jo! Po mirë, a është e mundur që njeriu të jetë kompletuar në dituri, apo profesionist i mirëfilltë në një sferë të caktuar pa u marrë fare me aktivitete sportive? Pa dyshim se jo! A është e mundur që njeriu të jetë sportist i mirëfilltë pa lexuar fare libra? Po është e mundur, si shumë të mundura të tjera në vendin tonë, por sa është e frytshme kjo mundësi!? Më mirë të mos kishim pyetur... Pra, dituria dhe sporti janë plotësuese të njëra-tjetrës, e jo zëvendësuese. Po e imagjinoj një intelektual të trashë fizikisht, i cili mezi merr frymë, por në shpjegimin e gjërave të ndryshme është i mrekullueshëm. Po ashtu, në imagjinatën time po përfytyroj edhe një sportist, i cili ka një trup të mrekullueshëm e vital, por shpjegimi i tij në çdo fushë i përket një niveli mjaft të ulët. Kësi lloj absurditetesh ndodhin kur mençuria dhe sporti nuk bashkëveprojnë njëri me tjetrin!

Formësimi i natyrshëm i njeriut ngërthen në vete bashkimin e këtyre dy fenomeneve, në një ecuri të vetme, ose në një rrugë të përbashkët. Shpeshherë shohim dhe dëgjojmë njerëz të ditur me një bagazh të madh diturie. Por shumë shpejt vërejmë, kuptohet fare pa qenë mjek, se intelektual i në fjalë vuan nga sëmundja e diabetit, ka yndyrë në gjak, është tepër nervoz, stomaku i tij i ngjan grave shtatzëna, intonacioni i zërit tingëllon jo aq i përshtatshëm te

dëgjuesit, gjestet shpjeguese të tij janë mjaft të ngadalshme, fizionomia e jashtme e tij të neverit, si dhe përgjithësisht personit në fjalë i mungon karizmi. Ne ua pranojmë dhe askush nuk ka të drejtë t'ua mohojë punimet e tyre shkencore, mundin e tyre për këtë shoqëri, por ne nuk pajtohemi fare që t'i jepet përparësi ekstreme vetëm zhvillimit të njëres pjesë të trupit, sepse përpos muskujve të cilët gjenden në kokë (e që këto muskuj manifestojnë forcë, forcë e cila është shprehur në dituri), njeriu është i përbërë edhe prej pjesëve të tjera. Me gjithë veçantitë individuale, trupi i të gjitha qenieve njerëzore është i ngjashëm: ai është i ndërtuar prej kokës, trungut dhe katër gjymtyrëve, dy të sipërme (duart) dhe dy të poshtme (këmbët) dhe prej shumë pjesëve dhe një mori qelizave të tjera të brendshme.

Ç'na vyen një diapazon i gjerë i diturisë, kur kemi në vazhdimësi probleme me shëndetin! Po ashtu ç'na vyen një trup i shëndoshë e muskolor, me kokë të zbrazët! Bashkësia e numrave të zbrazët është e madhe, por në të nuk ka asgjë.

Nuk është thonë kot: "koka e shëndoshë në trup të shëndoshë". E pra, si mund të jetë koka e shëndoshë në trup të delfinit, apo të balenës?! Ndoshta te balena, ose delfini ky lloj i ndërtimi përshtatet, sepse është në natyrshmërinë e tyre, por neve ky ndërtim nuk na shkon për shtat. Sigurisht që shumica e këtyre

të diturve që vuajnë nga ky lloj përtacisë (të mos keqkuptohemi, kemi edhe intelektual që në mënyrë të rregullt merren me sport), për mosmarrjen të paktën në mënyrë sporadike me sport, arsyetohen me kohën e tyre mjaft të zënë. Por këtë arsytim, disa shkencëtarë me renome botërore ia hedhin poshtë intelektualëve tanë. Sepse ata, të paktën tre herë në javë merren me sport, kuptohet secili shkencëtar merret me lojin e sportit të cilin e dëshiron! Më kujtohet një profesor i imi në Prishtinë, i cili ishte i përgatitur dhe mjaft i freskët në shumë fusha, e në veçanti ishte (kuptohet ende është) ekspert në lëmin e vet dhe ne studentët, pa një analizë paraprake rreth fshehtësisë së suksesit të tij, duke u mbështetur në dukjen e tij fizike dhe në këndelljen mendore, e kuptuam se profesori në fjalë merrej në mënyrë të rregullt me aktivitete sportive.


Pra, aktivitetet sportive janë domosdoshmëri e përgjithshme e njerëzve, e posaçërisht e dijetarëve, sepse e tashmja dhe e ardhmja progresive varet dukshëm prej tyre. Për efikasitet dhe rezultat të suksesshëm, përveç trurit të shëndoshë, është kusht që të jetë edhe trupi i shëndoshë, sepse nga kjo neglizhencë e pjesshme mund të cenohet shumë lehtë vitaliteti i trurit, e ky shëndet arrihet duke e konsideruar dhe duke e vënë në praktikë sportin, si pjesë të domosdoshme të jetës sonë. ■

## Fotolajm



Mesfushori i Bayern Munchenit, Frank Ribery dhe bashkëlojtari i tij Hamit Altintop sivjet e kanë kryer kushtin e pestë islam, Haxhin. Edhe pse këtë informacion askush nga klubi nuk e ka pohuar, një fotografi ku dy lojtarët shihen në Meke po qarkullon nëpër portale të ndryshme të internetit. Ribery dhe Altintop duken në foto pranë xhamisë ku është e vendosur Qabeja në Meke, ku bëhet edhe rrotullimi rreth Qabesë, ritual i nevojshëm islam. Hamit Altintop është futbollist i lindur në Gjermani, por ka prejardhje turke dhe ka mbrojtur ngjyrat e kombëtares së Turqisë. Ndërkaq, Ribery është me kombësi franceze, i cili më vonë e ka pranuar fenë islame.

# Nisin "ethet" e botërorit "Afrika e Jugut 2010"



**Alban BILALLI**

**P**rej 11 qershorit deri më 11 korrik të vitit të ardhshëm, bota do të jetë e përfshirë nga "ethet" e kampionatit botëror të futbollit "Afrika e Jugut 2010". Organizatorët e këtij evenimenti të madh sportiv, janë duke punuar natë e ditë që kampionati botëror në futboll të fillojë në mënyrën më të mirë dhe të mos ketë asnjë eksces gjatë zhvillimit të turneut. Për këtë turne, Afrika e Jugut ka investuar afro 65 miliardë euro. Stadiumet, infrastruktura rrugore, hotelet i kanë kushtuar më së shumti buxhetit të Afrikës së Jugut. Vetëm për ndërtimin dhe renovimin e stadioneve janë investuar afro 1.3 miliardë euro. Në 10 stadione do të zhvillohen 64 ndeshje në terminet kohore 13:30, 16:00 dhe 20:30.

Në kryeqytetin e Afrikës së Jugut, Johannesburg, do të zhvillohen dy takimet kryesore: ajo e nisjes së kampionatit botëror dhe finalja. Në stadiumin "Soccer City", që është më i madhi në gjithë vendin, me një kapacitet prej 95 mijë ulësesh, do të bëhet hapja dhe mbyllja e kampionatit botëror, loja e parë dhe finalja që është "ajka" e turneut. Stadiumi tjetër që ndodhet në Johannesburg, "Elis Park", ka një kapacitet prej 62 mijë ulësesh. Stadiumi "Nelson Mandela Bei" është ndërtuar në vendlindjen e ish-kryetarit afrikan Nelson Mandela, i cili në vitin 1993 fitoi çmimin Nobel për paqe. Ky stadium ka 48 mijë ulëse dhe ndërtimi i tij ka kushtuar mbi 300 milionë dollarë. Të gjitha stadiumet që janë përzgjedhur për këtë turne, janë stadione me kushtet më moderne.

Të gjithë ata që dëshirojnë të jenë të pranishëm në këto stadione, biletën mund ta blejnë në webfaqen zyrtar të

FIFA-s ([www.fifa.com/2010](http://www.fifa.com/2010)), deri më 22 janar. Bileta më e lirë kushton 14 euro, kurse më e larta 630 euro.

## Shpërblimet

FIFA për këtë eveniment të madh sportive, ka ndarë 420 milionë dollarë për shpërblime. Fituesi i botërorit "Afrika e Jugut 2010", do të fitojë 30 milionë euro. Nënkampioni do të shpërblehet me 24 milionë euro. Për përfaqësueset pjesëmarrëse do të ndahen 32 milionë euro. Për secilën nga 1 milion euro, për t'i hequr shpenzimet rreth përgatitjeve për pjesëmarrje në turne. Po ashtu, FIFA do të paguajë edhe 40 milionë euro, për klubet që kanë futbollistë pjesëmarrës në këtë kampionat. Një futbollist do të paguhet 1600 dollarë në ditë.



## Sipas shortit, grupi G "grupi i vdekjes"

Kampioni i botës në fuqi, Italia, bënë pjesë në grupin F, ku për kundërshtar ka Paraguain, Zelandën e Re dhe Sllovakinë. Pritet që Italia të mos ketë problem për ta kaluar fazën e grupeve, por duhet pasur parasysh se ky është kampionat botëror, ku do të ndeshen përfaqësueset dhe lojtarët më të mirë në futboll. Befasitë mund të jenë të mundshme. Të kujtojmë kampionatin botëror që u mbajt në Korenë e Jugut më 2002, ku Franca, si kampion i vitit 1998, nuk arriti ta kalojë fazën e grupeve.

Kampioni i Evropës, Spanja, bënë pjesë në grupin e fundit, në grupin H, së bashku me Zvicrën, Hondurasin dhe Kilin. Spanja, jo



Grupi A	Grupi B	Grupi C	Grupi D	Grupi E	Grupi F	Grupi G	Grupi H
Afrika e Jugut Meksika Uruguai Franca	Argjentina Nigeria Koreja e J. Greqia	Anglia SHBA Algjeria Sllovenia	Gjermania Australia Serbia Gana	Holanda Danimarka Japonia Kameruni	Italia Paraguai Zelanda e Re Sllovakia	Brazili Koreja e V. Bregui Fildishtë Portugalia	Spanja Zvicra Hondurasi Kili

# Jugut 2010"



vetëm që është favorit në këtë grup, por është favorit që ta fitoj titullin e kampionit botëror "Afrika e Jugut 2010". Ndeshjen e parë Spanja do ta zhvillojë kundër Zvicrës. Për Zvicrën pritet të luajnë edhe shqiptarët me nënshtetësi zvicerane: Valon Behrami, Blerim Xhemajli, Albert Bunjaku etj.

Pretendenti kryesor për ta fituar botërorin, është kampioni i pesëfishtë i botës, Brazili. Por Brazilin e pret një punë e vështirë për ta kaluar grupin, sepse bën pjesë në grupin G, i cilësuar si "grupi i vdekjes". Në këtë grup, pos Brazilit, bëjnë pjesë edhe Koreja e Veriut, Bregu i Fildishtë dhe Portugalia.

Trajneri i Argentinës, Diego Armando Maradona, nuk është lejuar që të marrë pjesë në hedhjen e shortit, pasi ishte dënuar nga FIFA për fyerje të gazetarëve. FIFA e ka dënuar superyllin e Argentinës me dy muaj, deri më 15 janar 2010, që të mos e udhëheqë Kombëtaren argjentinase, sepse ai i kishte fyer rëndë gazetarët.

## Si përplasen skuadrat pas grupeve

Në çdo grup kalojnë dy skuadrat e para që marrin më shumë pikë, kanë golavarazh më të mirë dhe kanë fituar në ndeshjen direkte. Më tej, sipas renditjes së grupeve, në rend alfabetik bëhet edhe përplasja në fazën e 1/16-ve. Skuadra e parë e grupit "A" përplasjet me të dytën e grupit "B" dhe e dyta e grupit "A" me të parën e grupit "B". Po kështu vijojnë përplasjet mes grupeve C-D, E-F dhe G-H. ■



## Nuk luan pa shami në kokë

**S**ura al-Shawk, 19 vjeçare, e lindur në Bagdad, luante basketboll qyshkur ishte fëmijë. Ajo luante basketboll me shoqet në rrugët e pluhurosura të Bagdadit. Krahas mësimëve në shkollë, të cilave ajo u kushtonte një rëndësi të madhe, loja e basketbollit ishte pjesë e pandashme e jetës së saj. Pasi Iraku u përfshi në luftë të përgjakshme, familja e saj u largua nga Bagdadi, për në Zvicër për të gjetur një jetë më të mirë. Familja e saj, muaj më parë, fitoi nënshtetësinë zvicerane.

Sura edhe pse u nda nga shoqet e saj, nuk u nda nga loja e basketbollit. Në Zvicër ajo është lojtare e klubit basketbolistik STV Luzern. Është njëra nga lojtaret më të mira të klubit, me një mesatare prej 12 pikësh për lojë. Veshja e saj dallon nga bashkëlojtaret e tjera. Përveç që këmbët dhe duart e saj janë të mbuluara, ajo mban edhe shami në kokën e saj. Ajo i përmbahet rregullave islame për femrat që merren me sport, sipas të cilave nuk bën që të veshësh pantallona të shkurtra, fanella me mëngë të shkurtra, si edhe koka duhet të jetë e mbuluar etj. Me këtë lloj veshje ajo ndihet më së miri dhe për fat të mirë kjo nuk u ka penguar bashkëlojtareve dhe kundërshtarëve të saj.

Mediumet ishin të parat që shkruan për nëntëmbëdhjetëvjeçaren që luante basketboll me shami në kokë. Menjëherë pas kësaj ka ndërhyrë Federata e Basketbollit të Zvicrës për t'ia ndaluar Suras zhvillimin e ndeshjeve me ekipin e saj STV Luzern, nëse ajo e bart shaminë në kokën e saj. Nëse ajo do të zhvillonte ndeshje, ekipi i saj do t'i humbiste ndeshjet me rezultat zyrtar nga Federata. Ajo nuk ka pranuar të luajë basketboll pa shami dhe pret një vendim në favor të saj nga Gjykata e Lartë e Kantonit të Luzernit. "Shamia është pjesë e identitetit tim. Po ta heq atë do të humb një pjesë të personalitetit tim",

- ka thënë ajo. Ajo është e zemëruar me këtë vendim të Federatës, të cilin e përshkruan si një vendim të padrejtë. Ajo është në kontakt me avokat për t'u përgatitur në mbrojtje të së drejtës së saj për të luajtur basketboll me shami. "Në ditët e fundit, një avokat i njohur zviceran në Gjenevë ka kontaktuar me mua dhe më ka dhënë udhëzime të veçanta në lidhje me hapat që duhet të ndjek", - ka thënë ajo.






Zëdhënësi i FIBA-s (Federata e Basketbollit Ndërkombëtar), Marco Beltra, ka shpjeguar vendimin e FIBA-s, se sportistët duhet të tregojnë "neutralitet absolut politik dhe fetar" në sport. Nëse lejohet shamia, atëherë do të hapen kërkesa të tjera. "Për dallim nga atletika dhe volejboli, basketbolli është një sport ku kontaktet në mes të sportistëve janë shumë të shpeshta dhe mund të ndodh që nga pajisjet e veshjes së shamisë të lëndohen lojtaret" - ka thënë zëdhënësi i FIBA-s, Marco Beltra.

Lidhur me këtë vendim të FIBA-s, Sura ka thënë se është vendim i padrejtë. "Ky vendim ka ardhur shumë vonë. Unë kam qenë duke luajtur me shami për gati një vit e gjysmë. Shumë sportistë kanë tatuazhe me simbole krishtere në trupin e tyre dhe kjo nuk i pengon askujt, kurse shamia po i pengon të tjerët", - është shprehur Sura al-Shawk.

Në përkrahje të Suras ka dalë klubi i saj. Madje trajneri i saj Danijel Brankoviç, ka thënë se ai nuk e kupton vendimin dhe se "shamia nuk paraqet asnjë rrezik për kundërshtarët dhe as nuk e pengon Suren duke luajtur".

Ajo, pos që merret me basketboll, pasi ta përfundojë gjimnazin, ka për qëllim që të studiojë në fakultetin ekonomik dhe që të gjejë një punë, ku i lejohet të punoj me shami në kokë, sepse ajo shaminë nuk e heq nga koka e saj për asgjë në këtë dynja. ■

**Alban BILALLI**

AUTOR: AGIM GASHI	MOSBARAZIMI	USHQIMI KRYESOR I KINEZEVE	E DOBËT	SMALTIMI	LLOJ FRUTI MALOR	IRIDI	PASURI	AMPERI	BABA (kratin.)		KACAVARJE	KACAVARJE	PESHQIR	AJZENHAUER					
DEBATET, RRAGATAT										PJESË NDËRTESE KËSTI									
SHKEL E SHKO								GADISHULLI MË I MADH NË BOTE INSTITUCION											
GJEL DETI						METALIKE OFFICE DEPOT													
STREHMORE					QË BËN NAZE NORVEGJIA									MALLKIMI I KISHËS					
LINDET SËRISH									ANTONIM (shkurt)				AUSTRIA BREGODETAS						
		EDI MARFI MJET I THJESHTE NJESHIMI									EMNAK I DIANËS								
ZINKU		INDIA FAJDEXHI												EMËR M. ARAB					
INDIANA UNIVERSITY KOKOMO				KAMERAMANI, FAGARUSHA										REPUBLIKA		ASTATI TE QESHURAT TALLËSE			
BURIMET															MENDIM IRI PËRKULJET				
	NËNA, MAMAJA JO NATYRALE														BOTË, NJEREZI				
BUJK										PJESA E DITES KUR FLEMË									
AKTORJA FRANCEZE, ZHOZE MARI										ZEMËRIMI				KRYE- PROKURORJA SHQIPTARE NË FOTO					
SULM					TË QENËT I PAPTITUR	LLOJ LUTJEJE	VONË (ang.)	LLOJ LËNDE PLASËSE	OKSIGJENI	GJYMTYRË TRUPI HUMAN FACT, INTERNAT.									
TOP, KALA NË SHAH				LYHET ME BALTË LLOJ AGRUMJE									AZOTI LLOJ PJEJE E NGROHTË						
Y.R.			KËNGËTAR ANGLEZ MUZIKË HAITIANE						THIRRJA KËNGËTARJA, KONÇI										
RADIUSI		FITIMI I SËRISHËM									RAST FËMUE, PJELLË								
GRUP GJAKU		POROSIA EDA AZARI								NGATËRRESE VASIL RUCI									
NDYU, PËRBALTI							PËRPIQEM, MUNDOHEM AMPERI												
THIRRJA E MYEZINIT PARA NAMAZIT						SINJAL I VEÇANTË						MINUS							